

Tiranë, më 08/7/2026

## **KËRKESË PËR PROVA**

**Kërkues:** I pandehuri, Z. Ilir Rexhep Metaj.

**Me objekt:** Paraqitja e kërkesave/pretendimeve/parashtrimeve të mia shtesë, për faktet (që synoj të provoj), për rrethanat dhe për çështjen, sipas neneve 151 e vijues, 356 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

**Drejtuar:** Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

**(Kryetarit të trupit Gjykses, Z. Erion Bani)**

### **E nderuar Gjykatë !**

Sipas kërkesës/orientimit tuaj, në seancën e datës 18/6/2026 dhe në vijim të kërkesave verbale, të parashtruara prej meje dhe avokatit tim, në seancën e datës 24/6/2026;

Meqënëse në seancën e datës 09/7/2026 dhe në vijim kam caktuar mbrojtës/avokat të ri, për mbrojtjen time në gjykim, mbrojtësi im i ri (pa e shtyrë këtë seancë) do të japë parashtrime/pretendime/kërkesa vijuese (në kuptim të nenit 57 të Kodit të Procedurës Penale), që kanë lidhje mjaftueshëm me parashtrimet /pretendimet/kërkesat e mia dhe avokatit tim, në seancën e datës 24/6/2026 dhe do të japë parashtrime/pretendime/

kërkesa të tjera shtesë, brenda kuptimit të arsyeshëm të neneve 151 dhe vijues, 356 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale:

## **Legjislacioni kombëtar, standardet gjyqësore kombëtare, standardet gjyqësore ndërkombëtare dhe ligji i zbatueshëm**

**1).** Kushtetuta parashikon (ndër të tjera) sa vijon:

*Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të (Neni 5);*

*Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike. Burimet financiare të partive, si dhe shpenzimet e tyre bëhen kurdoherë publike (Neni 9);*

*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si...bindjet politike...; Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. (Neni 18);*

*Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (Neni 32/2); ...të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor;*

*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (Neni 42);*

*Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara ... (Neni 116);*

*Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji; ...Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (Neni 122);*

*Pra parimisht dhe sipas këtyre dispozitave kushtetuese pretendoj se ligjshmëria e marrjes së provave është një aspekt i procesit të drejtë/gjykimit të drejtë dhe të rregullt ligjor (Referuar nenit 6 të KEDNJ);*

*Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhjesh... (Neni 64/1).*

*Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj. (Neni 70)*

*Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve. (Neni 75);*

*Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët (Neni 76);*

*Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. (Neni 78);*

*Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet...(Neni 81/1);*

*Presidenti i Republikës shpall ligjin e miratuar brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Ligji hyn në fuqi me kalimin e jo më pak se 15 ditëve nga botimi i tij në Fletoren Zyrtare (Neni 84);*

*Sipas ligjit ne fuqi nr. 8580/2000 “Për partitë politike” parashikohet se “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e financimit të partive, sipas rregullave të këtij ligji...ç) monitoron , mbikëqyr dhe auditon financimin e partive politike, nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre; d) vendos sanksione kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji. (Neni 15/1,2)*

*Sipas ligjit nr.9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” përcaktohen parimisht rregulla të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo deputet, kur ai merr pjesë ne ato ligje , që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara ; Për qëllimet e këtij ligji: *vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës , gjatë të cilit vendoset përmbajtja**

*përfundimtare e aktit; vendimmarrje për një akt do të vlerësohen , edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; ose një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij, në vendimmarrjen për këtë akt, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.*

## **KEDNJ parashikon ndër të tjera se:**

### **NENI 6 - E drejta për një gjykim të drejtë:**

*1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë për një dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj. Vendimi do të shpallet publikisht, por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga të gjitha ose një pjesë e gjykimit në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve e kërkojnë, ose në masën që gjykata e konsideron rreptësisht të nevojshme në rrethana të veçanta kur publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale do të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet fajtor sipas ligjit.*

*3. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

*b) të ketë kohë dhe lehtësira të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;*

*d) të ekzaminojë ose të ketë të ekzaminuar dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe ekzaminimin e*

**dëshmitarëve në favor të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij;**

**NENI 8** - “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

**NENI 14** - Ndalohet diskriminimi: **Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim për çdo arsye siç janë..., mendimi politik...ose statusi tjetër.**

...Marrja e provave në mënyrë të ligjshme dhe në mënyrë të drejtë, përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ. **Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar, nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse palës së interesuar, i është dhënë mundësia, për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre** (Shih vendimet nr. 57/2012, nr. 26/2025, pg. 20 të Gjykatës Kushtetuese);

Standartet Kushtetuese parashikojnë, se llojet e provave dhe mënyrat e marrjes së tyre, rregullohen posaçërisht, nga ligji procedural penal (Shih nenet 149, 150, 151 i Kodit të Procedurës Penale);

Mbi bazën e standardeve kushtetuese të mësipërme Gjykata duhet të analizojë (në rastin konkret), nëse provat e pretenduara, nga

palët e interesuara, janë mbledhur/marrë, në mënyrë të paligjshme(?) dhe nëse provat përkatëse janë përdorur, për deklarimin fajtor? (Shih qasjen, sipas vendimit nr. 26/2025, pg.23, 24 të Gjykatës Kushtetuese).

...Pretendimi “për marrje provash në mënyrë të paligjshme”, konsiderohet e lidhur me parimet, që u referohen provave. Pra, vlerësimi i provave, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese, në një çështje konkrete është si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor; verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave, i nënshtrohet eventualisht edhe kontrollit të Gjykatës Kushtetuese, pasi ky aspekt i gjykimit, ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor.

(Shih vendimin nr.42/2010 të Gjykatës Kushtetuese/Mbledhja e Gjyqtareve/ Moskalim)

...Parimi bazë kushtetues, që lidh provat me procesin e rregullt, është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit **askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme**. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ, në drejtim të respektimit të së drejtës për t’u mbrojtur. Në çështjen “Bykov kundër Rusisë”, vendimi datë 10 mars 2009, § 90, GJEDNJ ka theksuar se “...për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar, nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti, **nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre...**” (Shih vendimin nr.106/2013 të Gjykatës Kushtetuese/Mbledhja e Gjyqtarëve/Moskalim, pg.9);

Bazuar në nenet...të Kodit Procedurës Penale dhe në Konventën Europiane "Për ndihmë të ndërsjelltë në fushën penale", **ndihmë e ndërsjelltë juridike do të konsiderohet kryerja e ekspertimit, nën autoritetin dhe përgjegjësinë e një eksperti të një vendi të huaj, të caktuar prej autoriteteve gjyqësore shqiptare dhe përcjellja e mendimit të tij, këtyre autoriteteve, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë;**

**...Ekspertit të huaj i caktohet detyra e kryerjes së një ekspertimi dhe që ky ekspert i huaj, ta kryejë atë, në ndihmë të autoriteteve shqiptare, nën autoritetin dhe përgjegjësinë e tij...**(Shih qasjen sipas vendimit nr.103/2011 të Gjykatës Kushtetuese/Mbledhja e Gjyqtareve/Moskalim).

*...Në kontekstin procedural **përgjimi** është mjet i kërkimit të provës, i cili i shërben prokurorit për të plotësuar provat e tjera mbi të cilat është ngritur akuza. (Shih vendimin nr.130/2015 të Gjykatës Kushtetuese/Kolegji/Moskalim, pg.9,10).*

*...përgjimet janë indicie, që të çojnë tek prova, prandaj duhet të shoqërohen me prova të tjera, me qëllim që të arrihet në konkluzionin e duhur (Shih vendimin nr.111/2011 të Gjykatës Kushtetuese/Kolegji/Moskalim);*

*Se garancitë e nenit 6 të KEDNJ gjejnë zbatim edhe në fazën e hetimeve paraprake. **Këto parime** janë në përputhje edhe me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të pranuarra përgjithësisht, të cilat qëndrojnë në themel të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe logjika e të cilave lidhet veçanërisht me mbrojtjen e të akuzuarit.*

*Ato, gjithashtu, kontribuojnë në parandalimin e keqadministrimit të drejtësisë dhe përmbushjen e qëllimeve të nenit 6 të KEDNJ, veçanërisht, barazia e armëve midis autoriteteve hetimore (ose*

proceduere) dhe të akuzuarit. I akuzuari, në fazën e hetimeve paraprake, shpesh, e gjen veten, në një pozicion të pambrojtur, efekti i të cilit shtohet nga fakti, se legjislacioni i procedurës penale tenton të bëhet shumë kompleks, veçanërisht për sa i përket rregullave të mbledhjes dhe përdorimit të provave.

**Në të shumtën e rasteve, kjo pozitë e dobët e të akuzuarit, mund të kompensohet, në mënyrën e duhur, përmes asistencës së një mbrojtësi, detyra e të cilit është, përveç të tjerash, të sigurojë respektimin e të drejtës së të akuzuarin, për të mos inkriminuar veten.**

**Kjo e drejtë presupozon, që prokuroria, në një çështje penale, të mos përdorë prova, të marra në kundërshtim me rregullat procedurale.**

***Këto parime kërkojnë veçanërisht, në rastet e veprave penale që parashikojnë dënime të rënda, pasi janë pikërisht këto raste, ku respekti i të drejtës, për një proces të rregullt ligjor, duhet të sigurohet në shkallën më të lartë të mundur, nga shoqëritë demokratike.*** (Shih vendimin e GJEDNJ, në çështjen “Salduz kundër Turqisë”, vendimi datë 27 nëntor 2008; Shih vendimin nr. 44/2012, pg. 5 të Gjykatës Kushtetuese/ Mbledhja e Gjyqtarëve/Moskalim)

*...Marrja e provave, në mënyrë të ligjshme, përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës, për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ.*

***Për të përcaktuar, nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes, është respektuar dhe duhet verifikuar, në veçanti, nëse kërkuesit, i është dhënë mundësia, për të vënë, në dyshim autenticitetin e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre.*** (Shih vendimin nr.47/2011 të Gjykatës Kushtetuese; Vendimin nr.44/2012,

pg.5,15 të Gjykatës Kushtetuese/Mbledhja e Gjyqtarëve/ Moskalim);

*...se u takon gjykatave vendase të vendosin, nëse është e nevojshme t'i pranojnë provat për shqyrtim, në gjykim. Gjykata vendase është e lirë të vendosi, me kusht që të respektohen dispozitat e KEDNJ (Shih vendimet e GJEDNJ për çështjet vijuese: "Huseyn etj. k. Azerbajxhanit", vendimi datë 26.07.2011, § 196; "Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Ruisë", vendimi datë 25.10.2013, §§ 718-721; "Poletani dhe Azirovik k. ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", vendimi datë 12.05.2016, § 95).*

**Po kështu, sipas GJEDNJ refuzimi për të shqyrtuar provat e kërkuara nga mbrojtja ndërkohë që lejohet marrja, në pyetje e dëshmitarëve dhe shqyrtimi i provave të prokurorisë, mund të krijojë një problematikë, në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve.** (Shih vendimet e GJEDNJ për çështjet vijuese: "Borisova k. Bullgarisë", vendimi datë 21.12.2006, §§ 47-48; "Topić kundër Kroacisë", datë 10.10.2013, § 48) **Sa më lart** janë cituar në vendimin e Gjykata Kushtetuese/ Kolegji/Moskalim, nr. 177/2024, pg.19, 20, 24);

***...për papërdorshmërinë e provave...ka rëndësi të analizohet nëse:***

***(i) është respektuar apo jo parimi i ligjshmërisë në kryerjen e veprimeve procedurale paraprake nga ana e organeve të caktuara me ligj për kryerjen e këtyre veprimeve; si dhe (ii) nëse gjykata ka respektuar apo jo parashikimet e nenit 221/a dhe 222/1 të Kodit të Procedurës Penale;***

***...Papërdorshmëria (si sanksion që i vishet provës për shkak të rëndësisë së veçantë që ka), mund të ndodhë vetëm në ato raste kur kjo e fundit merret në shkelje të parashikimeve ligjore...(Shih***

vendimin penal të Gjykatës së Lartë nr.8/25 datë 14.06.2017/ e pandehur Majlinda Andrea etj., pg.151, 175).

*...duhet theksuar edhe jurisprudenca e GJEDNJ, e cila (për çështjet “Caka kundër Shqipërisë”, aplikimi nr.44023/02, § 100, 8 dhjetor 2009; “Berhani kundër Shqipërisë”; “Khamidov kundër Rusisë”, aplikimi nr. 72118/01) ka theksuar vazhdimisht se **pranueshmëria e provave** rregullohet kryesisht me rregullat e së drejtës së brendshme dhe se, si rregull, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, të vërtetojnë faktet dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme.;*

*Vlerësimi i GJEDNJ-së konsiston në dy drejtime kryesore:*

*Në radhë të parë, vlerësohet, nëse të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, i janë krijuar të gjitha mundësitë dhe lehtësitë e nevojshme, për t’u njohur me provat dhe për t’i kundërshtuar ato, gjatë procesit penal, në lidhje me vërtetësinë dhe bazueshmërinë e përmbajtjes së kësaj prove, por edhe të çdo prove tjetër të verifikuar, në këtë proces penal;*

*Në radhë të dytë, **është e nevojshme të verifikohet ajo, që doktrina e quan “cilësia e provës”, që nënkupton, se prova i nënshtrohet një verifikimi thelbësor, në lidhje me mënyrën e marrjes së saj, nëse ajo është marrë, në situata të tilla që ndikojnë në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e saj** (Shih vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2022- 1688 (345) datë 20.12.2022 /i pandehur Alfred Bushi, pg.58).*

*Nga transkriptimi i përgjimit ambiental rezulton, se në gjykim i pandehuri...i është drejtuar shtetasit...me “...”. Kjo fjali është transkriptuar e veçuar nga biseda e zhvilluar mes dy personave, duke bërë që konteksti i bisedës të jetë tërësisht i paqartë dhe i pakuptueshëm për Gjykatën. Interpretimi që i bën organi i akuzës kësaj pjese të bisedës së përgjuar është i pabazuar dhe nuk*

përputhet me asnjë të dhënë tjetër të përftuar në gjykim, duke bërë që të mos vlerësohet si njoftim i saktë në favor të të provuarit të akuzës, por në kushtet e dyshimit, të çmohet në favor të pandehurit, në kuptimin e mungesës së mundësisë provuese të fajësisë; ...Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson, se asnjë nga pretendimet e ngritura në rekurs nga prokuroria nuk i referohet shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit ka analizuar çështjen në raport me provat, rrethanat e kryerjes së veprës penale, ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionet e Gjykatës së Lartë ( Sipas vendimit nr. 232, datë 15.12.2016), duke argumentuar, përse akuza ndaj të pandehurit nuk mbështetet në ligj e në prova, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, nuk evidentohen shkelje apo zbatim i gabuar i ligjit penal material e procedural; nuk konstatohen shkelje, me pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit; apo shkelje të tilla procedurale, që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit objekt rekursi.

Në këto kushte, Kolegji vlerëson se rekursi i paraqitur nga prokuroria, kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale dhe për rrjedhojë , nuk mund të pranohet (Shih vendimin penal të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2023-1802 datë 07.11.2023/i pandehur Emiljan Lami, pg. 10.3, 11-21);

*...se vërtetë përgjimi përfaqëson një mjet të kërkimit të provës, nëpërmjet të cilit synohet të mësohet se çfarë ka ndodhur apo dhe po përgatitet/tentohet të ndodhë, por rezultati (pra njoftimi që ai jep për veprën penale), përbën provë tipike (pra, provë të rregulluar me ligj). Në çështjen konkrete, mbi analizën e mësipërme të*

rezultateve të përgjimit telefonik celular,...bisedat nuk janë aspak të paqarta për të lënë vend për një interpretim të ndryshme; ...rezultatet/njoftimet që përgjimi jep për veprën penale përbën provë tipike (të rregulluar me ligj), në kuptimin , që neni 149 i Kodit të Procedurës Penale i jep “provës”, në procesin penal; ...Sigurisht që kërkohet një analizë e kujdesshme e provës, në drejtim të besueshmërisë së burimit; Kodi i Procedurës Penale nuk jep një hierarki të llojeve të provave në procesin penal. Pra, provat nuk kanë një vlerë të paracaktuar, në varësi të llojit të tyre apo të palës që i paraqet. Në këtë kuptim sistemi ynë procedural penal parashikon në themel të tij parimin e barazisë së armëve ndërmjet palëve. **Elementi i rëndësishëm në procesin e çmuarjes së provave, nuk është lloji apo sasia, por rëndësia provuese e tyre;**

... Duhet theksuar që, nëse ekzistenca e faktit nuk mund të nxirret me siguri vetëm nga një indicje, ligji nuk vendos kufizime, për vërtetimin e fakteve nga një provë e vetme; ...se rezultatet e përgjimit dhe më tej transkriptimet, janë provë, por ato duhet të çmohen, në tërësi, me prova të tjera dhe të analizohen me kujdes...; se indicjet që të mund të vlejné, për të vërtetuar ekzistencën e një fakti, duhet të plotësojnë tre kushte:

të jenë të rëndësishme (që do të thotë të jenë të vlefshme në ofrimin e një të dhëne faktike, të japin një fakt që ka rëndësi për objektin e të provuarit);

të jenë të sakta (që do të thotë të mos jenë evazive e të tilla që nuk ofrojnë diçka që duket e qartë);

në përputhje me njëra tjetrën (që do të thotë, që të merren parasysh, duhet që indicjet të jenë, jo në kundërshtim me njëra-tjetrën).

**Pra njësimi i vlerës provuese të provës direkte, me atë indirekte, do të mund të bëhet vetëm nëqoftëse ato janë, pa të meta dhe nëqoftëse, nuk ka dyshim, për përputhje mes tyre.** Se kur ekziston një dyshim për akuzën, sipas parimit të

njohur in dubio pro reo, ky dyshim duhet të çmohet, nga gjykata, në favor të të pandehurit... (Shih vendimin penal nr.00-2024-1823 (281) datë 14.11.2024/i pandehur Sali Hasa etj. te Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë, pg.25.10, 25.11, 25.13, 33, 34, 35, 41, 65, 67, 68)

Kuptimi i normativizmit apo ligjësimit në vlerësimin e provës, nënkupton një kriter metodik që në mënyrë të saktë e kryen vetëm debati gjyqësor e kontradiktoriteti në gjykim si dhe rregullat formale në marrjen e përdorimit të plotë të një të dhëne, e aftë të arsyetojë vendimin gjyqësor.

Vlen të nënvizojmë këtu normat e përcaktuara nga nenet 151 të Kodit të Procedurës Penale (mbi ndalimin e përdorimit të provave të marra në mënyrë të paligjshme), parimet e vlerësimit të lirë të provave e mbi të cilat gjyqtarët, duhet të bazojnë arsyetimin e vendimit, sipas nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale (pra, veç ato që janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor).

Vlerësimi i provës, nga gjyqtari, bëhet mbi bazën e arsyetimit dhe vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (Shih nenin 142/1 të Kushtetutës).

Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar, si element esencial të vendimit (në nenin 383/1/“ç” të Kodit të Procedurës Penale), të provave mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme, provat e kundërta. Kriteret e përgjithshme në vlerësimin e provës janë kriteret metodike kërkojnë domosdoshmërisht respektimin e rregullave formale të mënyrës si janë marrë. Në vlerësimin e provave, ligji ynë procedural, në mënyrë të veçantë ka sanksionuar disa kriteret:...(v) neni 193/7 i Kodit të Procedurës Penale, vendimet e formës së prerë, mund të merren me qëllim të provës lidhur me ekzistencën e faktit (Shih vendimin njësues penal nr.2162 datë 06/11/2024 të Gjykatës së Lartë, pg. 110, 111)

Mosinformimi i individit, kur mbikqyrja (nëpërmjet përgjimit) ka përfunduar, nuk përputhet me KEDNJ. Një ankim efikas është pjesë përbërëse e çdo sistemi mbikqyrjeje. (Shih vendimin e GJEDNJ për çështjen “Gerhard Klass etj. kundër Republikës Federale të Gjermanisë”, aplikimi nr. 5029/71, vendimi datë 06 shtator 1978)

**Vendimi i GJEDNJ për çështjen “Abu Bakah Jalloh kundër ALLEMAGNE”, aplikimi nr. 54810/00, vendimi datë 11 juillet 2006);** GJEDNJ vuri në dukje ndër të tjera se shtetet nuk mund të justifikojnë shkeljet e të drejtave të njeriut me nevojën për të luftuar krimin.

**Ndikimi:** Kjo çështje nxori në pah rëndësinë e respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut gjatë hetimeve penale.

**Vendimi i GJEDNJ për çështjen “Allan kundër The United Kingdom”, aplikimi nr. 48539/99, vendimi datë 5 November 2002, final më datë 05/02/2003;** GJEDNJ konstatoi, se regjistrimet e fshehta përbënin ndërhyrje në të drejtën për privatësi sipas Nenit 8 dhe se përdorimi i tyre, pa mundësi për kontradiktoritet, shkelte Nenin 6 te KEDNJ. GJEDNJ vuri në dukje, se ***mungesa e mundësisë për të sfiduar besueshmërinë e regjistrimeve e bënte provën të papërdorshme, duke cënuar drejtësinë e procesit.***

**Ndikimi:** Ky rast theksoi rëndësinë e respektimit të parimit të kontradiktoritetit kur përdoren prova të marra përmes metodave të fshehta.

Verifikimi, nëse kanë qenë të drejta procedimet penale në tërësi përfshin mënyrën në të cilën janë marrë provat (Shih qasjet sipas vendimeve të GJEDNJ për çështjet: “Khan k. Mbretërisë së Bashkuar”, aplikimi nr.35394/97, § 34; P.G. dhe “J.H. k. Mbretërisë së Bashkuar” aplikimi nr.44787/98, § 76; “Heglas k. Republikës Çeke”, aplikimi nr.5935/02, §§ 89-92, vendim i datës 1 mars 2007; “Allan k. Mbretërisë së Bashkuar”, aplikimi nr. 48539/99, § 42, vendimi datë 5 November 2002);

Në përcaktimin, nëse procedimet në tërësi ishin të drejta, duhet t'i kushtohet rëndësi faktit, nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet të shqyrtohet, **nëse ankuesit i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe përdorimin e tyre.** Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë cilësia e provave, duke përfshirë faktin nëse rrethanat në të cilat janë marrë provat hedhin dyshime mbi bazueshmërinë apo saktësinë e tyre (Shih, mutatis mutandis, vendimet e GJEDNJ, për çështjet e sipërcituara: Khan §§ 35, 37; Allan, § 43); **Sa më lart**, janë cituar, në vendimin e GJEDNJ për çështjen “Mulosmani kundër Shqipërisë”, aplikimi nr. 29864/03, vendim i datës 8 tetor 2013, pg. 124, 125.

Qasja e GJEDNJ, për papërdorshmërinë e provave, mund të krahasohet me sisteme të tjera ndërkombëtare. Kështu Gjykata Ndërkombëtare Penale (ICC), përcakton në Statutin e Romës (Neni 69/7) qasjen se “...**provat e marra me anë të një shkeljeje të këtij Statuti ose të të drejtave të njohura ndërkombëtarisht të njeriut, nuk janë të lejueshme nëse: Shkelja hedh dyshime të konsiderueshme, mbi besueshmërinë e provës; ose Pranimi i provës do të dëmtonte rëndë integritetin e procedurave**”.

GJEDNJ ka publikuar disa dokumente udhëzuese (të disponueshme në faqen e saj zyrtare [www.echr.coe.int](http://www.echr.coe.int)), që ofrojnë qartësi mbi papërdorshmërinë e provave. Një dokument kyç është “Udhëzuesi Praktik” mbi Kriteret e Pranueshmërisë (Practical Guide on Admissibility Criteria) të GJEDNJ të përgatitur nga Regjistri i Gjykatës. Ky udhëzues nuk trajton drejtpërdrejt “pranueshmërinë e provave”, në procedurat penale kombëtare, por trajton kriteret e pranueshmërisë së kërkesave individuale, që paraqiten para GJEDNJ-së sipas neneve 34 dhe 35 të KEDNJ. Në kuadër të nenit 6 të KEDNJ (që parashikon të drejtën për një proces të drejtë), GJEDNJ kontrollon, nëse pranimi i provave, e ka bërë procesin në tërësi të padrejtë.

**Provat e marra në shkelje të ndalimeve procedurale penale, janë gjithmonë të papranueshme** dhe nga ky këndvështrim vlerësohet “drejtësia e përgjithshme e procesit penal”.

Ky udhëzim mund të shkarkohet nga faqja vijuese e GJEDNJ-së: “Practical Guide on Admissibility Criteria”; Udhëzuesi Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë (Practical Guide on Admissibility Criteria) i GJEDNJ-së, nuk ka një datë të vetme “miratimi”, si një akt ligjor (sepse ai është përgatitur nga Regjistri i Gjykatës (Registry of the Court) dhe nuk e lidh GJEDNJ zyrtarisht. Ky udhëzues është një dokument orientues praktik. Versioni i parë u publikua rreth vitit 2009–2011. Versioni i përditësuar, që lidhet me periudhën 2021 është ai i vitit 2021 (me përditësime, gjatë atij viti). Versioni aktual (më i fundit) është përditësuar më 28 shkurt 2026, nën titullin “Practical Guide on Admissibility Criteria, Updated on 28 February 2026”, me 126 faqe.

Pra, ky udhëzues (që zakonisht referohet, si udhëzuesi i vitit 2021) është botuar/përditësuar, gjatë vitit 2021, por ai vazhdon të përditësohet rregullisht.

Ky udhëzues praktik i vitit 2021 i përditësuar, deri në 28 shkurt 2026 përcakton kriteret, për vlerësimin e provave në procedurat penale. Sipas këtij dokumenti, provat mund të konsiderohen të papërdorshme nëse: Janë marrë në shkelje të të drejtave të garantuara nga KEDNJ? A çënojnë parimin e kontradiktorialitetit ose barazinë e armëve? A kanë një ndikim të padrejtë, në drejtësinë e procesit?

Raporti Vjetor 2023 i GJEDNJ diskuton çështje, ku papërdorshmëria e provave ka qenë qëndrore, duke theksuar nevojën për procedura transparente dhe respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut, gjatë mbledhjes dhe përdorimit të provave.

*Gjykata Kushtetuese është autoriteti i vetëm i ngarkuar (nëpërmjet vendimeve përfundimtare dhe të detyrueshme për të gjithë) të garantojë respektimin e Kushtetutës dhe të bëjë interpretimin përfundimtar të saj.*

*Në parim, vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese kanë autoritetin absolut të gjësë së gjykuar dhe prodhojnë efekte “erga omnes”, pra, për të gjithë.*

*Çështja që trajton të drejtat perkatëse, konsiderohet se janë zgjidhur, nga Gjykata Kushtetuese, njëherë e përgjithmonë, në mënyrë definitive dhe (sipas parimit “res judicata”) ajo nuk mund të rishikohet përsëri, në të ardhmen.*

**Zbatimi i detyrueshëm** i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i garantuar në Kushtetutë e cila (në nenet 132 e 145 të saj) sanksionon shprehimisht, këtë koncept kushtetues.

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit (Vendimi nr.5/2001 i Gjykatës Kushtetuese);

...Vendimmarrjet e kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese ose vendimet e Mbledhjes së Gjyqtarëve, të dhëna në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës, nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli, as prej vetë asaj, pasi ato kanë natyrë përfundimtare, pra, res judicata; (Shih vendimin nr. 321/2024/Gj.K/Kolegji, pg. 12).

Vendimet e GJEDNJ kanë vlerën e tyre në dy aspekte: i pari lidhet me natyrën detyruese, që rrjedh nga nenet 1 e 46 të Konventës dhe i dyti, me mënyrën e zbatimit të tyre në sistemin e brendshëm. Nëse ka vakum legjislativ, atëherë zbatohen drejtpërdrejt vendimet e GJEDNJ, sepse KEDNJ është miratuar me ligj, në vitin 1996 (pra, **KEDNJ është bërë pjesë përbërëse e legjislacionit tonë të brendshëm, sipas nenit 122 të Kushtetutës**; Vendimet e GJEDNJ i referohen KEDNJ, pra, zbatohen vendimet e GJEDNJ. (Shih vendimet nr.20/2011, nr.45/2013, nr.14/2021 të Gjykatës Kushtetuese; Shih ligjin nr. 8137/1996, neni 5)

**Detyrimet e marra përsipër nga shteti shqiptar, në kuadrin e KEDNJ janë të zbatueshme, nga të gjitha organet shtetërore dhe gjykatat e të gjitha niveleve** (Shih vendimin nr. 14/2021 të Gjykatës Kushtetuese). Pra, sipas nenit 5 të ligjit nr. 8137/1996 është parashikuar “...Duke iu referuar nenit 46 të kësaj Konvente njihet në kushtet e reciprocitetit juridiksioni i GJEDNJ, për interpretimin dhe zbatimin e KEDNJ, si dhe të Protokolleve Shtesë nr.1, nr.4 dhe nr.7 , për rastet kur shkelja e të drejtave të garantuara, në këto dokumente, ka ndodhur, pasi ato kanë hyrë në fuqi, për Republikën e Shqipërisë...”.

**Pra, pretendoj se ligji nr. 8137/1996, përcakton në rezervën e tij, se interpretimi i KEDNJ ka përparësi.**

Gjykata merr parasysh dhe jurisprudencën e GJEDNJ, e cila i ka dhënë jetë standardeve të KEDNJ, nëpërmjet zbatimit të tyre, në

çështjet konkrete. (Shih vendimin nr. 9/2010, pg. 80 i Gjykatës Kushtetuese)

KEDNJ dhe vetë jurisprudenca e GJEDNJ kanë përparësi dhe efekt të drejtpërdrejtë pasi konsiderohet se ato përbëjnë parimet e përgjithshme, për të drejtën. **KEDNJ përbën një pjesë integrale të sistemit ligjor shqiptar, ku ajo ka përparësi ndaj parashikimeve statutores, që janë në kundërshtim me të dhe është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë.** (Shih vendimin e GJEDNJ, datë 6 dhjetor 2022, për çështjen “Spasov vs. Rumanisë”; Shih nenin 17/2 të Kushtetutës; Shih vendimet nr. 20/2011 dhe nr. 45/2013 të Gjykatës Kushtetuese)

Detyrimet që lindin ndaj një Palë të Lartë Kontraktuese, sipas Nenit 46 të KEDNJ, diktojnë jo vetëm detyrimin për të ndërmarrë masa individuale me efekt inter-partes, por gjithashtu për të ndërmarrë masa të përgjithshme që kanë efekt erga omnes (pra kundrejt të gjithëve). Në këtë aspekt, vendimet përmbajnë në tekstet e tyre parime të përgjithshme të cilat zbatohen in concreto për të gjitha palët dhe shtetet anëtare kërkojnë të ndërmarrin një qasje pro-aktive dhe të përshtatin legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme në përputhje me to.

Si rrjedhojë, megjithëse vendimet e GJEDNJ nuk kanë në mënyrë strictu sensu, efekt erga omnes (pra kundrejt të gjithëve), shtetet nuk mund gjithsesi t'i shpërfillin parimet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ.

Thënë shkurt, **gjykatat vendase shqiptare, duhet të respektojnë, jo vetëm vendimet e GJEDNJ në lidhje me Shqipërinë, por edhe vendimet e tjera të GJEDNJ të lidhura me shtetet e tjera anëtare. KEDNJ, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike, renditet menjëherë pas Kushtetutës.**

Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm, në të drejtën e brendshme dhe bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore (përfshirë këtu dhe gjykatat e çdo niveli si dhe organet që zbatojnë vendimet e tyre).

Garancitë e KEDNJ ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të individit, të shprehura nga Kushtetuta.

Se teksti i KEDNJ dhe jurisprudenca e GJEDNJ shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese.

Ky pozicion i KEDNJ vjen si pasojë e angazhimeve të shtetit shqiptar, për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë, me detyrimet që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ, për palët që marrin pjesë në gjykim, sepse sipas nenit 41 të KEDNJ, palët kontraktuese (me ratifikimin e KEDNJ), janë të detyruara të garantojnë përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën.

Veç kësaj, praktika e kësaj GJEDNJ paraqet rëndësi, për vlerat orientuese të jurisprudencës të saj edhe për gjykatat shqiptare. Pra, ky problem ka mbetur për t'u vlerësuar rast pas rasti nga gjykatat që gjykojnë në shkallë të parë dhe nga ato që gjykojnë në shkallë të dytë, pa harruar se objekt i këtij vlerësimi (sipas GJEDNJ), duhet të jetë tërësia e procesit, së bashku me fazën e hetimeve dhe me shkallën e apelit, me procesin eventual para Gjykatës Kushtetuese... (Shih vendimin e GJEDNJ për çështjen "Ruiz Mateos kundër Spanjës", vendimi datë 23.06.1993; shih footnote 11) = **sa më lart** arsyetohet në vendimin nr.6/2006 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata Kushtetuese (me vendimin e saj përfundimtar nr.45/2013, pg.11) arsyetoi se "...gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë

drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 e 46 të KEDNJ, pasi respektimi i KEDNJ dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i Gjykatës Kushtetuese, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë, për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. Roli i një gjykate të lartë është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave”.

Vendimet për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ndonëse nuk kanë efekte jashtë kufijve objektivë të çështjes në gjykim, ndihmojnë për një funksionim harmonik të së drejtës dhe marrin vlera të veçanta përsa i përket koherencës dhe vazhdueshmërisë së orientimeve jurisprudenciale...” (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.31/2005)

Kolegji vlerëson me rëndësi koherencën në praktikën gjyqësore, si mjet që garanton **sigurinë juridike** ...; Praktika e njëjtë gjyqësore e merr një rëndësi të veçantë në zgjidhjen e çështjeve të interpretimit të ligjit ... (Shih vendimin civil të Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-931 datë 16.06.2021/me palë Agurim Rrodhe, pg.14);

GJEDNJ konstatoi ekzistencën e një trajtimi të ndryshëm, midis...GJEDNJ thekson, se lista që përmban neni 14 i KEDNJ ka një karakter tregues dhe jo kufizues (Shih “Engel dhe të tjerë kundër Holandës”, 8 qershor 1976, § 72; “Rasmussen kundër Danimarkës”, 28 nëntor 1984, § 34); Problemi që shtrohet në rastin konkret, nuk buron nga thjesht divergjencia jurisprudenciale (të cilat janë një pasojë e brendshme e çdo sistemi gjyqësor, që mbështetet në një grup gjykatash themelore), por nga një dështim i Gjykatës së Lartë, në rolin e saj si rregulluese e këtyre konflikteve.

GJEDNJ konstaton se ky trajtim i ndryshëm, nuk mbështetet në asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Prandaj, ka patur shkelje të nenit 14 të KEDNJ/ndalimi i diskriminimit. **(Shih sa më lart** vendimin e GJEDNJ për çështjen “Beian kundër Rumanisë nr.1 aplikimi nr.30658/05, vendimi datë 06/12/2007, pg.60-65).

...diversiteti i qasjeve nxjerr në dritë një pasiguri juridike, lidhur me bazën ligjore të zbatueshme në situata të tilla dhe ngriti pyetje në lidhje me parashikueshmërinë dhe koherencën e mbrojtjes, që ofron e drejta e brendshme...(Shih qasjen sipas vendimit të GJEDNJ për çështjen “Mehmet Kandemir kundër Turqisë”, aplikimi nr.30906/19, vendimi datë 3 shkurt 2026, definitiv datë 15/6/2026, pg. 86)

GJEDNJ përsërit, se kur vendime të tilla dukshëm kontradiktore ndërhyjnë me të drejtën për...dhe kur nuk jepet asnjë shpjegim i arsyeshëm, për një divergjencë të tillë, ndërhyrje të tilla, nuk mund të konsiderohen të ligjshme..., sepse ato çojnë në jurisprudencë jokonsistente, që mungon saktësia e nevojshme për të mundësuar individët të parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre. (Shih “Aliyeva etj. kundër Azerbajxhanit”, nr. 66249/16 etj., datë 21 shtator 2021, § 134).

Në dritën e rrethanave të mësipërme, GJEDNJ konsideron, se interpretimi i Gjykatës (i legjislacionit vendas përkatës) dhe zbatimi i tij (në rastin e tanishëm), nuk ishin të parashikueshëm, në rrethanat e çështjes.

GJEDNJ nuk arrin të shohë se si kerkuesi/aplikues mund të kishte parashikuar se legjislacioni (në lidhje me...dhe duke pasur parasysh gjithashtu jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit në lidhje me kushtet që duhej të përmbusheshin për të qenë i zbatueshëm legjislacioni për...);

GjEDNJ konstaton, se ndërhyrja e kontestuar, nuk ishte në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe (për rrjedhojë) shkelte KEDNJ (Shih “Frizen kundër Ruisë”, nr.58254/00, § 35, datë 24 mars 2005; “Adzhigovich kundër Ruisë”, nr. 23202/05, datë 8 tetor 2009, § 34; “Cazacu kundër Moldavisë”, nr. 40117/02, §§ 46, 47, datë 23 tetor 2007, sepse mënyra, se si gjykata më e lartë kombëtare interpretoi dhe zbatoi ligjin vendas përkatës, nuk ishte e parashikueshme për kërkuesin/aplikuesin (**Shih, sa më lart, qasjen sipas** vendimit e GJEDNJ, për çështjen “Komuniteti Hebre i Selanikut kundër Greqisë”, aplikimi nr.13959/20, vendimi datë 6 maj 2025, pg. 66 -79).

... **Parimi “barazia në të drejta”**, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme, në çështje të ngjashme, nga gjykatat e zakonshme....

Veprimtaria gjyqësore konsiston në zbatimin e dispozitës ligjore (e hartuar përgjithësisht në terma të përgjithshëm dhe abstraktë) në një çështje specifike konkrete. Megjithatë, jo gjithmonë është e mundur për gjyqtarin të identifikojë normën (rregullin juridik) e zbatueshme në rastin në shqyrtim dhe një kërkim i tillë kryhet prej tij duke përdorur një seri kriteresh interpretativë. Interpretimi i ligjit ka si qëllim, së pari, ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore, por kur ajo kryhet me qëllim zëvendësimit e asaj që shfaqet si boshllëk i rendit juridik (mungesa e një dispozite të shprehur nga e cila të nxirret norma që duhet zbatuar në rastin konkret) ajo kthehet në një veprimtari që i ngjan asaj të krijimit të normave të reja juridike.

Gjykata vlerëson t'i referohet konceptit të së “drejtës së gjallë”, e kuptuar përgjithësisht në sensin e ekzistencës së një “jurisprudence konstante”, “të konsoliduar” mbi një dispozitë të caktuar ligjore (duke pasur pra parasysh mënyrën se si ajo “jeton” në realitetin konkret). Përdorimi i formulës së “të drejtës së gjallë” e ndihmon Gjykatën të përcaktojë raportet me gjyqtarët e

zakonshëm në terrenin e interpretimit të së drejtës (e njohur si detyrë që u takon posaçërisht këtyre të fundit ), duke marrë në lidhje me këtë një qëndrim vetëkufizues (self restraint) në kuptimin që, nëse një e drejtë e tillë e gjallë ekziston, Gjykata e mban parasysht dhe (me disa përjashtime) nuk ndalet të bëjë një interpretim të ndryshëm, edhe atje ku i duket asaj më bindëse.

Kompetenca e Gjykatës ndalet përpara interpretimit konstant jurisprudencial pasi, edhe në autonominë e saj të plotë të gjykimit Gjykata nuk mund të mos ketë parasysht një interpretim të tillë që i njeh normës legislative vlerën e saj efektive në jetën juridike, duke qenë se normat janë jo ato që propozohen në mënyrë abstrakte por ato që zbatohen në punën e përditshme të gjyqtarit, që synon t'i bëjë konkrete dhe efikase. (Shih vendimin nr.350, datë 13-21 nëntor 1997, të Gjykatës Kushtetuese Italiane; Shih vendimin nr.6/2012 të Gjykatës tonë Kushtetuese, pg. 8, 9)

Nëse vendimet kontradiktore të gjykatave të larta janë në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ, GJEDNJ zbaton testin i cili përcakton, së pari, nëse ekzistojnë dallime të qenësishme në praktikën gjyqësore; Së dyti, nëse ligji vendas parashikon mjete për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve; Së treti, nëse mjete të tilla janë zbatuar; Dhe, së katërti, nëse janë të përshtatshme, cili do të ishte efekti i tyre (Shih “Laërence Borg kundër Maltës”, aplikimi nr. 37537/13, datë 12 janar 2016, § 108);

Kodi i Procedurës Penale parashikon (ndër të tjera) sa vijon:

*Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit. (Neni 1)*

Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale...; Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit. (Neni 2)

Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. (Neni 4/1)

Faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij. (Neni 8/a)

Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm... (Neni 24)

Policia gjyqësore, edhe me iniciativën e vet, duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. (Neni 30/1).

Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. (Neni 149)

Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedural. (Neni 150)

Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos menjëherë duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme. **Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren.**

Papërdorshmëria e provave **ngrihet edhe kryesisht, në çdo gjendje** dhe shkallë të procedimit. (Neni 151).

Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur...duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundshme, që detyra e re t'i besohet një eksperti tjetër; ...Në raste të veçanta, kur ekspertimi nuk mund të kryhet nga lista e ekspertëve të regjistruar pranë gjykatës, organi procedues, pasi merr paraprakisht mendimin e palëve, cakton ekspertë të tjerë, vendas ose **të huaj**, jashtë kësaj liste. (Neni 179/1,3)

Eksperti mund të autorizohet të marrë pjesë edhe në pyetjen e palëve dhe marrjen e provave. Kur eksperti kërkon të dhëna nga i pandehuri, ... (Neni 184)

Komunikimet e përgjuara regjistrohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal. Në procesverbal transkribohet përmbajtja e komunikimeve të përgjuara.

Procesverbalet dhe regjistrimet i dorëzohen menjëherë prokurorit dhe brenda pesë ditëve nga mbarimi i veprimeve ato depozitohen

në sekretari bashkë me aktet që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe zgjatur përgjimin. Kur nga depozitimi mund të dëmtohen hetimet, gjykata autorizon prokurorin që ta shtyjë depozitimin deri në përfundimin e hetimeve paraprake. Mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve lajmërohen menjëherë për depozitimin në sekretari dhe për të drejtën që kanë për të shqyrtuar aktet e për të dëgjuar regjistrimet.

Gjykata, pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësit, vendos për heqjen e regjistrimeve dhe të procesverbaleve, përdorimi i të cilave ndalohet. (Shih nenin 223/2,3,4,5 të Kodit të Procedurës Penale me tekstin në fuqi në vitin 2009)

Procesverbalet dhe regjistrimet ruhen pranë prokurorisë që ka urdhëruar përgjimin derisa vendimi të marrë formë të prerë me përjashtim të atyre që ndalohet përdorimi.

Por kur ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, të interesuarit mund të kërkojnë asgjësimin e tij. Mbi këtë kërkesë vendos gjykata që ka bërë vleftësimin e përgjimit. Asgjësimi bëhet nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal. (Shih nenin 224/1 të Kodit të Procedurës Penale me tekstin në fuqi në vitin 2009)

**Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren ... kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni.** Gjykata urdhëron asgjësimin e dokumentacionit të përgjimeve që ndalohet të përdoren, me përjashtim të rasteve kur përbëjnë provë materiale. (Shih nenin 226/1,3 të Kodit të Procedurës Penale me tekstin në fuqi në vitin 2009 dhe aktualisht)

Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale.

*Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. (Neni 277)*

*Edhe pas referimit të veprës penale policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e treguara në nenin 30, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit. Ajo procedon sidomos: ...b) për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit. (Neni 294)*

***Gjatë shqyrtimit gjyqësor palët mund të bëjnë pretendime lidhur me marrjen e provave. (Neni 357/2)***

*Procesverbalet dhe aktet që janë lexuar, si dhe dokumentet e paraqitura nga palët e të pranuara nga gjykata, futen bashkë me procesverbalin e seancës, në fashikullin e gjykatës. (Neni 371 te Kodi i Procedurës Penale)*

*Letërporositë e gjykatave dhe prokurorive, të drejtuara autoriteteve të huaja për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t'i nisur ato....Ministria i komunikon autoritetit procedues që ka bërë kërkesën datën e marrjes së saj dhe nisjen e letërporosisë ose urdhrin për të mos i dhënë rrugë letërporosisë; ... **Në rastet e ngutshme, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt, duke informuar Ministrin e Drejtësisë....**(Neni 509/1,3,4)*

**Ligji nr.9157/2003** “Për përgjimin e komunikimeve elektronike” (ndryshuar me ligjet nr. 9885/2008, nr. 10172/2009, nr. 116/2012, nr. 69/2017) parashikonte ndër të tjera (më datë 22/6/2009 kur pretendohet se është konstatuar kjo sms/ mesazh):

Ky ligj synon të rrisë efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari. (Neni 2)

“Subjekt përgjimi” janë personat e dyshuar si autorë krimesh të rënda (Neni 3/8); Parimet bazë për përgjimin e komunikimeve elektronike janë respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojshmëria dhe proporcionaliteti, sekreti dhe objektiviteti në kryerjen e tij (Neni 4); **Rezultatet e përgjimit, të marra në bazë të këtij ligji, nuk kanë vlerën e provës, në një proces penal, me përjashtim të atyre të marra sipas Kodit të Procedurës Penale** (Neni 5). Pra, pretendoj, se edhe ky ligj referon në zbatimin e Kodit të Procedurës Penale.

Parimisht dhe referuar praktikës gjyqësore (Shih vendimet penale nr. 430 datë 16.07.2003, nr. 536 datë 23.07.2005, nr. 108 datë 18.05.2016, nr. 36, datë 27.02.2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) pretendoj, se “...me shprehjen ‘veprime hetimore’ duhet të kuptohen të gjitha ato veprime që janë ose mund të përbëjnë objekt prove, sipas përcaktimeve që përmban Kodi i Procedurës Penale, në lidhje me mjetet e provës dhe mjetet e kërkimit të provës; se papërdorshmëria është një sanksion procedural që (si rregull), vepron mbi përmbajtjen e provës (duke goditur ato akte, që kanë vlerë provuese), që mund të ngrihet edhe kryesisht, në çdo shkallë dhe fazë të procedimit gjyqësor dhe parashikohet në mënyrë të përgjithshme në nenin 151/3 të Kodit të Procedurës Penale.

Papërdorshmëria e një prove nënkupton përjashtim juridik të saj, nga dosja dhe nga bazueshmëria e vendimmarrjes së gjykatës. Në analizë të neni 150 të Kodit të Procedurës Penale), faktet nga i cili varet zbatimi i normave procedurale (ku përfshihet edhe sanksioni

*i papërdorshmërisë) janë objekt prove. Për të provuar faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale, barra e provës bie mbi palën që e ngre si pretendim. (Sa me lart, cituar në vendimin penal nr.1013 datë 24.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë)*

Parimisht, teoria **e arsyeshme/doktrina** e së drejtës procedurale penale dhe referuar kësaj praktike gjyqësore të konsoliduar dhe koherente pretendoj, se *dëshmia e një shtetasi përbën në thelb veprim hetimor procedural që kryhet (gjatë hetimit penal dhe gjatë gjykimit të themelit, referuar neneve 153 e vijues, 360 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, referuar dispozitave të tjera të sipërcituara procedurale penale) nga gjykata ose prokurori/oficeri i policisë gjyqësore;...Dallimi i mjeteve të kërimit të provës me llojet (mjetet) e provës, qëndron në faktin se këto të fundit (pra, llojet/mjetet e provës) karakterizohen nga aftësia, për t'i ofruar gjykatës rezultate provash (të cilat janë drejtpërsëdrejti të përdorshme, gjatë procesit të vendimmarrjes së gjykatës). Aftësia (fuqia) provuese e llojeve të provës, krijohet në momentin e formimit dhe të përfundimit të llojit të provës.*

Dispozitat e sipërcituara kushtetuese, dispozitat e sipërcituara të KEDNJ, ligjet e sipërcituara, jurisprudenca e sipërcituar kombëtare, jurisprudenca e sipërcituar ndërkombëtare dhe parimet/teoria e sipërcituar e së drejtës procedurale penale, janë relevante mjaftueshëm për çështjen objekt gjykimi prandaj kërkoj nga Gjykata të kihet parasysh/vlerësim;

**2).** Referuar këtyre dispozitave kushtetuese, konventore e ligjore, referuar parimeve/teorisë procedurale, referuar jurisprudencës së GJEDNJ, jurisprudencës kushtetuese, jurisprudencës së Gjykatës së Lartë dhe nga interpretimi i tyre sistematik dhe i

arsyeshëm pretendoj dhe provohet qartazi, se sms/mesazhi vijues eventual i datës 22/6/2009: “Nesër në darkë duhet të takohemi patjetër. Më duhen 200 mijë patjetër. Mos harro”, konstatuar eventualisht (më datë 28/6/2009), tek karta celulare me numër 0682009693 apo tek aparati celular (ku ishte instaluar kjo kartë), në përdorim të dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj, sikur kjo sms/mesazh i është dërguar/transmetuar (pretenduar nga prokurori), nga karta celulare, në posedimin tim, është parimisht mjet kërkimi prove marrë dhe administruar nga policia gjyqësore. Por deri tani provohet, se nuk ka procesverbal transkriptimi, për të gjithë përmbajtjen e komunikimeve të përgjuara të datës 22/6/2009 të kartës celulare me numër 0682009693, në përdorim të dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj.

Nuk provohet se në cilën ditë janë depozituar në sekretarinë kompetente procesverbali dhe regjistrimet e përgjimit/ve eventuale (bashkë me aktet e tjera, që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe/ose zgjatur përgjimin), për këtë kartë celulare, në përdorim të dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj.

**Provohet se unë nuk jam njoftuar/lajmëruar (për shkaqe të pavarura, nga vullneti im), nga prokuroria, për depozitimin në sekretarinë kompetente, në vitin 2009 dhe vijim të materialeve që kanë lidhje me këtë përgjim, në procedimin përkatës penal (për llogari të të cilit është kryer eventualisht përgjimi/regjistrimi përkatës) dhe unë nuk jam njoftuar (për shkaqe të pavarura nga vullneti im), në vitin 2009 e vijim për të drejtën/garancinë time, që kisha për të shqyrtuar aktet e përgjimit dhe për të dëgjuar regjistrimet (pra nuk kam patur akses tek zbardhjet e regjistrimeve të këtij përgjimi). Sipas këtyre dispozitave procedurale, unë (nëse do isha lajmëruar nga prokurori/oficeri i policisë gjyqësore) kisha**

**eventualisht të drejtën/garancinë time, për t'ju drejtuar prokurorit dhe/ose gjykatës, me kërkesat e mia, për të mbrojtur interesat/të drejtat e mia përkatëse procedurale, që në vitin 2009. (Shih ndër të tjera nenet 223/2-5, 224/1 të Kodit të Procedurës Penale)**

**Unë, asnjëherë nuk kam hequr dorë shprehimisht nga e drejta/garancia ime për kundërshtimin e këtij mjetei kërkimi prove (lidhur me këtë sms/mesazh), nuk kam hequr dorë për kundërshtimin e vlefshmërisë të çdo lloj prove, që bazohen në këtë përgjim (sepse nuk kam patur dijeni dhe nuk jam njoftuar nga prokurori, në kohën e duhur, në vitin 2009 e vijim).**

Në asnjë rast, në asnjë moment kohor, nuk kam pranuar (në asnjë lloj forme/mënyre procedurale), pasojat e çdo akti procedural (që lidhet me përgjimin, me transkriptimin e komunikimit, me procedurat e tjera lidhur me këtë përgjim) dhe nuk kam pranuar (në asnjë lloj forme/mënyre procedurale) asnjë lloj prove të marrë, bazuar në këtë përgjim.

**Pra (duke mos u njohur unë me këtë sms, nga prokurori, që ka kryer përgjimin e komunikimit në procedimin përkatës të vitit 2009), unë megjithëse kisha dukshëm/qartazi interes (për kundërshtimin eventual) nuk e kam patur (në asnjë lloj forme/mënyre procedurale) mundësinë time objektive (pikërisht për faktin, se nuk jam njoftuar nga organi prokurori), për të ushtruar të drejtën/garancinë time për kundërshtimin e këtij mjetei kërkimi prove, në atë procedim, për llogari të të cilit u krye përgjimi i këtij komunikimi/mesazhi.**

**2/1).** Dëshmitari Z.Kastriot Ismailaj dhe unë nuk kemi ndërmarrë/kryer (as nuk provohet në çdo formë/mënyrë tjetër procedurale) ndonjë veprim konkret eventual, me qëllimet, sipas kësaj sms eventuale/hipotetike.

**Unë nuk jam pyetur (nga prokurori dhe/ose gjykata), në asnjë lloj procedimi penal, ku ka qenë i pandehur ky dëshmitar dhe as në procedimin penal për llogari të të cilit është kryer ky përgjim.**

Shkelja e neneve 223/2-5, 224/1 të Kodit të Procedurës Penale, nuk është kompensuar proceduralisht nga prokuroria, në vitin 2009 e vijim, në ndonjë procedim tjetër penal (veç procedimit penal objekt gjykimi), me respektimin prej prokurorit (në dobinë time) të së drejtës time për t'u njohur/e drejta e aksesit, me materialet e çështjes dhe për zbatimin e mjaftueshëm/shterues/ezaures të parimit të kontradiktoritetit/barazia e armëve.

**Dokumentimi ligjor (i këtij mjeti kërkimi prove dhe çdo lloj prove të marre dhe/ose administruar nga prokuroria, në bazë të këtij përgjimi) duket qartazi dhe mjaftueshëm, se paraqet parregullsi procedurale të asaj natyre të cilat vënë në dyshim vlefshmërinë/besueshmërinë/vërtetësinë dhe sigurinë procedurale të këtij përgjimi dhe të çdo lloj prove të marrë nga prokuroria (në bazë/referuar të këtij përgjimi).**

**2/2).** Theksohet kjo parregullsi procedurale, prej meje, sepse nuk ka siguri e besueshmëri procedurale, që sms/mesazhi përkatës të jetë dërguar nga unë (me vullnetin tim dhe me ndërgjegjen time), nga karta ime përkatëse celulare dhe kjo sms/mesazh nuk mbështetet mjaftueshëm (sipas neneve 149, 152/1 të Kodit të Procedurës Penale) në çdo lloj prove tjetër direkte apo indirekte.

Gjithashtu, nuk provohet se dëshmitari Z. Kastriot Ismailaj të ketë reaguuar/vepruar (në çdo formë e mënyrë), për këtë sms/mesazh eventual, prej datës 22/6/2009 e vijim.

Cënimi i së drejtave/garancive të mia procedurale penale, kushtetuese e konventore (për akses/njohje me përgjimin, për mbrojtjen time efektive/efikase dhe praktike procedurale në procedimin përkatës të vitit 2009 dhe për respektimin e parimit të kondradiktoritet, në atë procedim, në vitin 2009 e vijim), nga prokurori (që ka administruar këtë përgjim dhe që ka administruar provat e marra eventualisht, sipas këtij përgjimi), nuk ndoqi një qëllim të ligjshëm, nuk ishte e nevojshme dhe/ose e domosdoshme në një shoqëri demokratike (pra, nuk ishte në përpjesëtim me qëllimin, që kërkonte të arrinte prokurori) dhe nuk ishte e nevojshme dhe/ose e domosdoshme, për asnjë lloj interesi kushtetues e ligjor të zbatueshëm në fuqi, në vitin 2009 e vijim.

Nëse prokurori kërkon/përpiqet të vlerësojë/çmojë vetë, se çfarë mund të jetë relevante, për interesat/të drejtat e mia procedurale, për interesat e drejtësisë së procedimit/procesit, pa respektuar të drejtat/garancitë e mëtejshme procedurale penale, kushtetuese e konventore (lidhur me të drejtat e mia të mbrojtjes) pretendoj, se nuk është në pajtim me kërkesat e nenit 6/1 të KEDNJ. (Shih qasjen, sipas vendimit të GJEDNJ për çështjen “Matanović kundër Krocisë”, aplikimi nr. 2742/12, vendimi datë 04/4/2017).

**2/3).** Për këto rrethana/fakte, shkaqe/arsye (dhe duke patur parasysh procedurën e mangët/dyshimtë të ndjekur prokurori, në vitin 2009, për provat e marra, sipas këtij përgjimi) pretendoj, se ishte qartësisht e dukshme, që unë nuk kam qenë në gjendje procedurale objektive (në asnjë lloj forme/mënyre procedurale, pikërisht për faktin se nuk jam njoftuar nga prokurori) të formoja (në fazën përkatëse procedurale, prej vitit 2009 e vijim) një

argument/pretendim specifik, në lidhje me relevancën e këtij përgjimi, me provat e marra sipas/referuar këtij përgjimi dhe për rrjedhojë të kërkoja eventualisht nga Prokurori dhe/ose gjykata kompetente, që të shqyrtonin kërkesën time eventuale, nën dritën e së drejtës/garancisë time, për të përgatitur mbrojtjen time në mënyrë të efektshme/praktike/efikase.

**2/4).** Këto pretendime/parashtrime/kërkesa janë thelbësore dhe të rëndësishme sepse (nëse do të respektoheshin nga prokurori garancitë/standardet e mia të sipërcituara procedurale në procedimin përkatës të vitit 2009 dhe unë do të ushtroja të drejtat e mia të sipërcituara) atëherë ky përgjim komunikimi nuk duhej të merrej/administrohej, proceduralisht nga prokurori në procedimin objekt gjykimi sepse edhe prokurori nuk ka bërë analizë/argumentim të mjaftueshëm, ezaurues/të përmbledhur për shkaqet/arsyet e administrimit të këtij mesazhi nga procedimi përkatës i një prokurorie tjetër, në procedimin penal objekt gjykimi.

**Për rrjedhojë unë pretendoj, se unë u privova padrejtësisht, qëllimisht dhe proceduralisht nga një procedurë, nëpërmjet së cilës mundej, që provat, në zotërim të prokurorisë (në procedimin përkatës të vitit 2009) të mos përdreshin aktualisht dhe/ose të përjashtoheshin nga ajo dosje e vitit 2009, sipas ligjit procedural penal të zbatueshëm.**

Pretendoj, se mbi mua (nëse do të respektoheshin nga prokurori garancitë e sipërcituara procedurale, në procedimin përkatës të vitit 2009 dhe unë do të ushtroja të drejtat e mia të sipërcituara), nuk do kishte asnjë lloj dyshimi të arsyeshëm, që prej vitit 2009 e vijim, as për ndonjë lloj kundërvajtje administrative, as për ndonjë vepër penale dhe as lidhur, me faktet objekt akuze, në procedimin objekt i këtij gjykimi. (Shih qasjen, sipas vendimit të

GJEDNJ për çështjen “Matanović kundër Krocisë”, aplikimi nr. 2742/12, vendimi datë 04/4/2017).

Respektimi i parimit të ligjshmërisë (në lidhje me momentin e vlerësimit të kërkesës time, për papërdorshmërinë) kërkon dhe dhënien e arsyeve të argumentuara e të mjaftueshme, se pse gjykata e konsideron të përdorshëm dhe/ose të besueshme këtë sms/mesazh, administruar sipas përgjimit.

Vlera (si mjet kërkimi prove) e këtij sms/mesazhi merret/përdoret parimisht nga gjykata, në shqyrtimin gjyqësor, vetëm atëherë kur shqyrtohet, verifikohet dhe vlerësohet prej gjykatës dhe në fund pranohet si e tillë.

E ritheksoj, se parimisht kjo sms/mesazh, marrë nga policia gjyqësore/prokurori në vitin 2009, në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale nuk mund të përdoret, në përputhje me përmbushjen e parimit të respektimit të normave procedurale (Nenet 2, 149, 151/3 të Kodit të Procedurës Penale).

Papërdorshmëria ngrihet prej meje. Çmuarja e provave është parimisht përcaktimi i vërtetësisë, besueshmërisë, sigurisë së saj procedurale dhe fuqisë provuese të tyre.

GJEDNJ e çmon mënyrën në të cilën trajtohen, vlerësohen e përdoren provat, si një çështje të rëndësishme, në marrjen e vendimit, nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo. (Shih vendimin e GJEDNJ për çështjen “Van Mechelen etj. kundër Vendeve të Ulëta”)

**2/5).** Edhe pse ky mjet kërkimi prove është marrë në kuadër të një procedimi tjetër penal, natyra e saj mbetet ajo e një përgjimi të komunikimeve, i rregulluar nga nenet 221–226 të Kodit të Procedurës Penale.

Përgjimi procedural i komunikimeve përcakton parimisht veprimet ligjore të cilat duhet të ndërmerren në përputhje me

Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale, ndaj një personi të dyshuar, me qëllim që të paraqiten provat e nevojshme për të vërtetuar nëse një vepër penale është kryer apo do të kryhet.

Kushtetuta garanton lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës ose të çdo mjeti tjetër komunikimi, por edhe lejon kufizimin me ligj të të drejtave dhe lirive, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Këto kufizime nuk i kalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ. Neni 221 i Kodit të Procedurës Penale përshkruan kufijtë e lejimit të përgjimit procedural të komunikimeve. Edhe pse nuk jep një përkufizim të përgjithshëm për përgjimin procedural ai përcakton kriteret e detajuara, të cilat janë të nevojshme për të lejuar përgjimin e komunikimeve. (Shih vendimin penal nr. 00-2022-1608 (329), datë 09.12.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pg.28)

**Në rastin konkret prova, që Prokurori kërkon të administrojë (e siguruar fillimisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë) është e papërdorshme, pasi është marrë në kundërshtim me garancitë kushtetuese, në fuqi në vitin 2009, kohë në të cilën unë ushtroja funksionin e deputetit të Kuvendit dhe gëzoja imunitetin kushtetues të parashikuar nga neni 73 i Kushtetutës.**

Parashikimet kushtetuese në fuqi (përpara ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 88/2012), neni 73/2 i Kushtetutës parashikonte, se *ndaj një deputeti nuk mund të fillonte ndjekja penale pa autorizimin paraprak të Kuvendit*. Vetëm pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve kushtetuese, imuniteti i deputetit u kufizua, duke u reduktuar në mbrojtjen nga heqja e lirisë.

Për rrjedhojë, në mungesë të autorizimit paraprak të Kuvendit (për fillimin e ndjekjes penale ndaj meje), Prokurori nuk ishte i legjitimuar të ndërmernte veprime procedurale, që përbënin pjesë

të ndjekjes penale, përfshirë edhe përgjimin e komunikimeve të mia.

Si pasojë, pretendoj se kjo sms/mesazh është marrë në kundërshtim me një garanci kushtetuese të detyrueshme dhe për rrjedhojë, nuk mund të përdoret, si provë në procedimin penal objekt gjykimi.

Pra, për sa kohë që prokurori nuk kishte kërkuar dhe marrë autorizimin e domosdoshëm për ndjekjen time penale eventuale, çdo akt ose provë e marrë referuar, këtij sms/mesazhi është e papërdorshme.

**2/6).** Në të njëjtin përfundim ka arritur edhe jurisprudenca e GJEDNJ e cila ka theksuar vazhdimisht, sa vijon: *se, megjithëse KEDNJ nuk përmban një rregull të përgjithshëm mbi pranueshmërinë e provave, përdorimi i provave të siguruara në kundërshtim me të drejtat themelore, nuk mund të vlerësohet në mënyrë të izoluar, por duhet të shqyrtohet në funksion të drejtësisë së procesit në tërësi, sipas nenit 6 të KEDNJ.*

*Në këtë kuadër, GJEDNJ ka vënë theksin jo vetëm mbi ligjshmërinë e mënyrës së marrjes të provës, por edhe mbi ekzistencën e garancive procedurale efektive që mundësojnë kontrollin gjyqësor të saj; se përdorimi i provave të siguruara në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ, nuk cenonte, në rrethanat konkrete, nenin 6 të KEDNJ, pasi të pandehurit kishin pasur mundësi efektive të kundërshtonin ligjshmërinë dhe vlerën provuese të tyre, ndërsa gjykatat vendase kishin ushtruar një kontroll të plotë mbi pranueshmërinë e këtyre provave. Për rrjedhojë, drejtësia e procesit ishte ruajtur pavarësisht paligjshmërisë së ndërhyrjes në të drejtën për jetën private; se përgjimet sekrete (që autorizohen ose realizohen pa garancitë e nevojshme ligjore) bien në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ; se legjislacioni dhe praktika gjyqësore duhet të sigurojë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit në*

autorizimin e përgjimeve sekrete; se, në raste të tilla, gjykatat kombëtare duhet të kryejnë një kontroll veçanërisht rigoroz mbi përdorimin e këtyre provave në procesin penal, duke garantuar një mundësi reale dhe efektive për mbrojtjen që të kundërshtojë ligjshmërinë dhe përdorimin e tyre.

GJEDNJ kërkon vlerësimin e drejtësisë së procesit në tërësi, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes me të cilën është siguruar prova, mundësinë reale të mbrojtjes për ta kundërshtuar atë, si dhe rëndësinë dhe besueshmërinë e saj; se kur provat janë siguruar përmes shkeljeve të rënda të të drejtave themelore, përdorimi i tyre në proces penal mund të cenojë vetë thelbin e procesit të rregullt ligjor, pavarësisht peshës së tyre provuese ose interesit publik në ndjekjen penale, **duke e bërë kështu të domosdoshëm një kontroll shumë të rreptë mbi drejtësinë e procedurës në tërësi**; ...kur një provë sigurohet nëpërmjet shkeljeve veçanërisht të rënda të të drejtave themelore, përdorimi i saj çënon vetë integritetin e procesit të rregullt ligjor, duke treguar se sa më e rëndë të jetë shkelja ...(Shih vendimet e GJEDNJ për çështjet vijuese: “Schenk v Sëitserland” aplikimi nr. 10862/84, 12 Korrik 1988, pg.45-49; “Khan v United Kingdom” aplikimi nr. 35394/97, 12 Maj 2000, pg.34-40; “Matanović v Croatia”, aplikimi nr. 2742/12, 4 Prill 2017, pg.146-157; “Dragojević v Croatia”, aplikimi nr.68955/11, 15 Janar 2015, pg. 79-101, 128-135; “Jalloh v Germany [GC]”, aplikimi nr.54810/00, 11 Korrik 2006, pg.94-107; “Gäfgen v Germany [GC]”, aplikimi nr.22978/05, 1 Qershor 2010, pg. 163–173).

**2/7).** Për këto shkaqe/arsye, fakte e rrethana dhe referuar kontekstit faktik, kushtetues, konventor e ligjor procedural penal të sipërcituar, që evidentohet në rastin konkret; referuar jurisprudencës të sipërcituar relevante të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencës të sipërcituar relevante të GJEDNJ, referuar

vendimeve unifikuese relevante dhe jurisprudencës të sipërcituar relevante të Gjykatës së Lartë; sipas parimit të sigurisë juridike (e lidhur me parashikueshmërinë dhe pritshmërinë time legjitime, për zbatimin, nga Prokuroria dhe Gjykata, të praktikës së konsoliduar gjyqësore relevante shqiptare dhe jurisprudencës relevante të GJEDNJ (lidhur me interpretimin dhe zbatimin e institutit procedural penal “papërdorshmëria e provës”) pretendoj/**kërkoj** në këtë fazë nga gjykata (sipas kuptimit të arsyeshëm të neneve 32/2 dhe 42 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNJ, neneve 1, 149, 151/3, 223/2-5, 224/1 dhe 226/1,3 të Kodit të Procedurës Penale):

**(i). Të mos përdoren** nga gjykata kundër meje (si mjet kërkimi prove) rezultatet e përgjimit të komunikimit eventual të kartës celulare me numër 0682009693, në përdorim/posedim të dëshmitarit Z.Kastriot Ismailaj lidhur me sms/mesazhin e sipërcituar eventual të datës 22/6/2009, të ardhur eventualisht, në kartën e këtij dëshmitari dhe mosmarrjen e tyre në vlerësim/shqyrtimin e çështjes në themel (sepse nuk ka fuqi/vlerë provuese procedurale në këtë gjykim). Kërkoj të procedohet me deklarimin e kësaj prove të papërdorshme, për aq kohë sa prokurori/oficeri i policisë gjyqësore ka marrë pjesë në prodhimin/krijimin e saj. Gjithashtu, gjykata të mos përdorë asnjë sms/mesazh tjetër të ardhur kësaj karte, në këtë datë.

**(ii).** Provat e marra prej këtij mjeti procedural kërkimi prove të përjashtohen/të mos përdoren kundër meje nga gjykata.

**(iii).** Papërdorshmëria e provave të marra prej këtij mjeti kërkimi prove, të **ngrihet edhe kryesisht**, nga gjykata, në çdo gjendje/fazë të procesit gjyqësor.

**(iv).** Meqënëse ky mesazh/sms nuk përbën provë materiale kërkoj që Gjykata **të urdhërojë asgjësimin** (me çdo formë dhe mënyrë procedurale të arsyeshme) të dokumentacionit/akteve të përgjimeve që lidhen/bazohen/referohen me këtë sms/mesazh. Procesverbali përkatës i asgjësimit të futet/përfshihet (bashkë me procesverbalin e seancave gjyqësore) në fashikullin e gjykatës. (Shih nenet 226/3 dhe 371 të Kodit të Procedurës Penale).

**(v).** Nëse kjo sms/mesazh lejohet nga gjykata të përdoret/trajtohet si mjet kërkimi prove, kunder meje pretendoj se çënohet e drejta ime për një gjykim të drejtë, sipas neneve 32/2 dhe 42 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNJ, neneve 1 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Pretendoj gjithashtu se, hedh dyshime të konsiderueshme mbi besueshmërinë e këtij mjeti kërkimi prove ose pranimi i saj do të dëmtonte rëndë, dukshëm, qartazi integritetin e procedurave duke zëvendësuar qartazi (për qëllime politike e diskriminuese, me narrativa politike, mediatike të njëanshme /qëllimshme) parimet proceduriale të ligjshmërisë, interesit të drejtësisë dhe objektivitetit.

**(vi).** Nëse kërkesa ime e sipërcituar me objekt “të mos përdoret si mjet kërkimi prove kjo sms” rrëzohet nga gjykata, atëherë të konsiderohet se kërkoj (Shih kuptimin e arsyeshëm të neneve 178 e vijues, 363, 366 të Kodit të Procedurës Penale) kryerje **ekspertimi elektronik** për të sqaruar mospërputhjet e sipërcituara sepse kërkohen njohuri të posaçme në këto fusha të shkencës dhe ky ekspertim është i nevojshëm dhe i dosmosdoshëm, në raport me pretendimet dhe kërkesat e mia (lidhur me këtë përgjim dhe me çdo lloj prove, që bazohet tek ky përgjim), referuar kërkimeve eventuale të prokurorit dhe është në interes të parimit të objektivitetit të procesit gjyqësor, objektit të

të provuarit në tërësi dhe për zbatimin e mjaftueshem të parimit të hetimit të plotë e të gjithanshëm gjyqësor të çështjes.

Ky ekspertim është i nevojshëm e i dosmosdoshëm për kuptimin teknik/elektronik të autenticitetit/vërtetësisë, saktësisë, besueshmërisë, sigurisë në fushën e depozitimit elektronik/transferimit/dërgimit elektronik të sms/mesazhit në vitin 2009 ndërmjet/midis dy kartave celulare.

Ky ekspertim është i nevojshëm dhe i dosmosdoshëm për verifikimin e mundësisë/probabilitetit të ndërhyrjes së paligjshme në çdo formë dhe mënyrë, në kartat celulare, për t'u konsideruar sikur sms/mesazhi/informacioni elektronik, teknologjik digjital/kompjuterik/elektronik i transmetuar nga dhënësi i një karte celulare, tek marrësi i një karte tjetër celulare figuron/pasqyrohet/duket sikur është identik/origjinal/i vërtetë /i besueshëm.

**Pra, pretendoj, që regjistrimi i sms/mesazhit/informacionit përketes i transmetuar në kartën celulare të dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj nuk është origjinal/identik, i vërtetë, i besueshëm, i saktë, i sigurtë** sepse është realizuar/depozituar /transferuar/derguar në formë/mënyrë të paligjshme nëpërmjet ndërhyrjes së paligjshme, me keqbesim, për qëllime kriminale të çdo lloji, **është montazh** duke përdorur (për këtë lloj ndërhyrjesh elektronike) programe/pajisje/mjete teknologjike digjitale/kompjuterike/elektronike të çdo lloji forme e mënyre, pa vullnetin/ndërgjegjen e dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj dhe pa vullnetin/ndërgjegjen time.

Verifikimi i këtij pretendimi kërkon njohuri të posaçme teknike e shkencore të fushës informatike/elektronike/teknologjisë digjitale/kompjuterike, njohuri të cilat nuk i përkasin parimisht sferës juridike dhe njohurive të zakonshme dhe ekskluzive të një gjyqtari.

Kryerja e këtyre veprimeve procedurale lidhet edhe me disponimin e përdorimin kompleks të programeve informatike/elektronike dhe pajisjeve teknologjike/elektronike/dixhitale dhe/ose kompjuterike të posaçme.

Përveç kësaj, veprime/verifikime të tilla kërkojnë njohuri të posaçme dhe kërkoj të realizohen nga shtetas të **huaj**, të cilët kanë njohuri/përvojë/aftesi të posaçme, profil të spikatur profesional, shkencor e teknik (në degën e informatikës ligjore, elektronikës ligjore, transmetimeve/teknologjisë elektronike ligjore, që njëkohësisht disponojnë edhe programet dhe pajisjet/mjetet e duhura elektronike, teknologjike digjitale dhe kompjuterike (për natyrën e qëllimet e këtij ekspertimi), sipas nenit 509 të Kodit të Procedurës Penale.

Pra , meqenese kërkoj që eksperti të jetë shtetas i huaj (përveç referimit në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale) pretendoj se duhet vepruar në përputhje/kuptim me nenet 5, 32, 42, 116, 122 të Kushtetutës, me ligjin nr.10193/2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” dhe ligjin nr.8498/1999 “Për ratifikimin e Konventës Europiane ‘Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale’ ”.

Neni 179/3 i Kodit të Procedurës Penale e lejon që eksperti i përzgjedhur të jetë shqiptar ose i huaj (pra, nuk parashikon ndonjë ndalim apo kusht shtesë në këtë aspekt).

Detyrimi për t’iu referuar Konventave Europiane është vetëm për ekspertët, që janë shtetas të atyre vendeve, që janë palë në këtë Konventë.

Konventa e sipercituar, në titullin VII të saj rregullon ndër të tjera edhe thirrjen e ekspertëve të huaj nga/dhe në shtete palë të kësaj Konvente. Duke pranuar si ekspertë shtetas të huaj , si dhe duke u ngarkuar atij/atyre detyra dhe të marrë mendimin/konkluzionin e tyre në rrugë zyrtare (referuar detyrimeve ligjore të parashikuara në nenet 178 e vijues të Kodit të Procedurës

Penale dhe në Konventën Europiane “Për Ndihmë Juridike në Fushën Penale”, të bëjnë betimin dhe të marrin përgjegjësinë (përpara organit kompetent të shtetit të tyre), gjë që do të shërbente si garanci, që ekspertimi do të ishte i saktë.

Pretendoj se eksperti përketes nuk përjashtohet realisht dhe proceduralisht nga përgjegjësia penale, që mund të mbajë, sipas Kodit Penal.

Gjithashtu, ky shtetas i huaj duhet të mos ketë papajtueshmëri me detyrën e ekspertit.

Mjetet/aparatet/programet elektronike, kompjuterike që do të shërbejnë për kryerje ekspertimi teknik, teknologjiko-digjital/kompjuterik/elektronik duhet të jenë origjinale (jo të shkarkuara ng interneti), të jenë sipas standardeve shkencore e ligjore dhe sipas Konventave të aderuara/miratuara në fuqi.

Pra kërkohet që edhe këto aparatura/pajisje/programme teknologjike digjitale/kompjuterike/elektronike (para se të instalohen/vendosen/programohen/përdoren për kryerje ekspertimi të kenë kaluar filtrin e saktësisë dhe vërtetësisë sipas institucionit kompetent publik në shtetin ku do të kryhet ekspertimi.

Kryerja e këtij ekspertimi është e nevojshme dhe e dosmosdoshme në raport me pretendimet dhe kërkesat e mia (lidhur me këtë përgjim dhe me çdo lloj prove, që bazohet tek ky përgjim), referuar kërtimeve të prokurorit dhe është në interes të parimit të objektivitetit të procesit gjyqësor, objektit të të provuarit në tërësi dhe për zbatimin e mjaftueshëm të parimit të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm gjyqësor të çështjes.

Vetëm në këtë mënyrë/formë procedurale konsiderohet se të dhënat/faktet/rrethanat e përfituara nga ky lloj ekspertimi do të konsiderohet të marra, të verifikuara dhe të administruara, në mënyrë të ligjshme dhe nga burime prove, sipas neneve 149, 178 e vijues, 363, 366, 509 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (si një nga aspektet e të drejtës/standardit për një proces të rregullt

ligjor, në kuptim të neneve 32 e 42 të Kushtetutës). Edhe në këtë rast pretendoj se konkluzionet e ekspertimit (si provë indirekte) duhet të plotësojnë standardet procedurale të saktësisë, besueshmërisë, sigurisë, integritetit dhe vërtetësisë.

**(vii).** Gjithashtu, (nëse kërkesa ime e sipërcituar, me objekt “të mos përdoret, si mjet kërkimi prove, kjo sms” rrëzohet nga gjykata, atëherë kam të drejtën dhe **do t’ju paraqes** (Shih kuptimin e arsyeshëm të neneve 151/2,3, 357/2 dhe 359 të Kodit të Procedurës Penale) në fazën përkatëse procedurale të shqyrtimit gjyqësor të provave të prokurorit, **pretendime/ kundërshtimet/parashtrimet/kërkesat** e mia ndaj rezultateve dhe bazueshmërisë, besueshmërisë/integritetit, vlefshmërisë/vërtetësisë, saktësisë dhe sigurisë procedurale të burimit të këtij përgjimi dhe ndaj mjeteve/pajisjeve përkatëse të çdo lloji, të përdorura dhe/ose të instaluara për këtë përgjim.

Pra, unë kam pretendime edhe për keqpërdorimin e çdo lloji pajisje/mjeti programi elektronik, teknologjik, informatik të aplikuar dhe/ose të instaluara për të transferuar, realizuar/depozituar/dërguar (nëpërmjet ndërhyrjes së paligjshme) sms/mesazhin përkatës; Kam pretendime për ndërhyrjen e paligjshme në këto pajisje/mjete/aparate/programe të përdorura; Do t’ju paraqes pretendimet/kundërshtimet e mia ndaj/kundër mënyrës së kryerjes të përgjimit; Do t’ju paraqes pretendimet/kundërshtimet e mia ndaj/kundër rrethanave në të cilat është përgjuar dhe janë marrë provat, sipas këtij mjeti kërkimi prove; Do t’ju paraqes pretendimet/kundërshtimet e mia kundër mënyrës të gjetjes/zbulimit, fiksimit, kqyrjes, dokumentimit, metodave të gjetjes/zbulimit dhe metodave të sigurimit dhe ruajtjes së saj (në pikëpamje të ruajtjes fizike dhe integritetit të saj), referuar natyrës së veçantë të saj, shkakun/arsyet, se pse nuk është asgjesuar ky mesazh prej vitit 2009 e vijim?

Ose pse eshte ruajtur ky mesazh prej vitit 2009 e vijim? Do t'ju paraqes pretendimet/kundërshtimet e mia ndaj/kundër mënyrës të mbajtjes, ruajtjes dhe pasqyrimet/fiksimit në procesverbalin e transkriptimit të rezultateve të përgjimit të kartës celulare me numër 0682009693 apo tek aparati celular (ku ishte instaluar kjo kartë) në përdorim të dëshmitarit Kastriot Ismailaj dhe do t'ju paraqes pretendimet/ kundërshtimet e mia për çdo lloj prove eventuale të marrë nga prokurori (referuar/bazuar këtij mjete përgjimi).

**2/8).** Përveç sa më sipër pretendoj se organi përkatës procedues i vitit 2009, nuk ka sqaruar/nuk ka paraqitur arsye relevante dhe të mjaftueshme në vitin 2009, se cila ka qenë indicja apo intuita e tyre procedurale e zbatueshme, që i ka shtyrë ata të mos e zgjerojnë në vitin 2009 e në vijim, hetimin, objektin e të provuarit procedural, qëllimin e veprimtarisë së tyre procedurale, në atë procedim.

Ndërsa prokurori (në çështjen objekt gjykimi) nuk ka argumentuar mjaftueshëm dhe nuk ka paraqitur deri tani, arsye relevante dhe të mjaftueshme procedurale, se cila është baza e plotë faktike, referuar të cilave u krijua bindja e tij/tyre procedurale se *“kjo sms është e bazuar, e besueshme, autentike/ e vërtetë, e saktë, e qartë, e kuptueshme, për qëllime kriminale”*. Prokurori (në çështjen objekt gjykimi) nuk ka evidentuar/pasqyruar faktet/rrethanat dhe procedurat relevante që mundësojnë ushtrimin procedural të mjaftueshëm (prej gjykatës) të një shqyrtimi gjyqësor efektiv, lidhur me pretendimin/kërkesën time të sipërcituar, me objekt *“të mos përdoret si mjet kërkimi prove kjo sms”*.

**2/9).** Provohet **se kjo sms/mesazh ka dukshëm paqartësi, përmbajtja e saj është e pakuptueshme** (sepse lë vend

dukshem/qartazi për interpretime të ndryshme, të paarsyeshme, jo objektive dhe arbitrare), nuk ka bisedime, apo komunikime. Biseda/komunikimi/sms/mesazhi eventual i përgjuar nuk është i/e plotë.

Provohet se kjo sms/mesazh ka dyshime dhe paqartësi për domethënien e përgjithëshme eventuale të bisedës, për vijimësinë e bisedës eventuale, për kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve dhe të kuptimit/kontekstit të përdorur.

Edhe për këto shkaqe pretendoj se vlera provuese e përgjimit të kësaj sms/mesazhi është zbehur/zhvlerësuar duke e bërë të pasigurt faktin penal, që prokurori synon të provojë.

Kjo sms/mesazh nuk ka asnjë lloj elementi konfirmues (që duhet të vijë parimisht nga prova të tjera), që të çojnë (nga vlerësimi i tyre në tërësi), në dhënien parimisht të një vendimi, tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Për të konkluduar në fajësinë e të pandehurit kërkohet parimisht një konfirmim i dyfishtë:

**i).** konfirmimi i parë është *specifik dhe lidhet vetëm me këtë lloj prove*, e cila duke qenë e prejardhur nga një mjet për kërkimin e provës, në mënyrë që të vlerësohet si provë rezultati, si të gjitha provat e tjera kërkohet që të jetë bindëse (për atë ç'ka provon) ose kur përmbajtja është e dyshimtë, e paqartë, duhet të konfirmohet me prova të tjera;

**ii).** konfirmimi i dytë, është *i përgjithshëm dhe buron nga neni 152/1 i Kodit të Procedurës Penale*, të cilit i nënshtrohen të gjitha llojet e provave, sipas të cilit asnjë provë, nuk ka vlerë të paracaktuar dhe çdo provë duhet t'i nënshtrohet debatit gjyqësor, çka do të thotë se gjykata mund të japë një vendim fajësie, vetëm kur ekzistojnë të paktën prova, të cilat e bëjnë vendimmarrjen, tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Referuar këtyre parimeve, shkaqeve/arsyeve pretendoj se rezultati i bisedës/komunikimit eventual të përgjuar (në kushtet

kur nga përmbajtja e kësaj sms/mesazhi ka dukshëm paqartësi përmbajtja e saj është e pakuptueshme dhe nuk provohet asnjë lloj fakti i paligjshëm) pretendoj se kjo sms/mesazh nuk ka **vlerë/fuqi provuese procedurale**, nuk mund të shërbejë, si mjet kërkimi prove tej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk jep provueshmëri të plotë (për të provuar çdo lloj akuze) dhe nuk mund të japë sigurinë procedurale te fajësisë.

**Ky vlerësim është në përputhje me nenin 152/2 të Kodit të Procedurës Penale, e cila kërkon pluralitet indiciesh, duke formuar në vlerësim një provë, me kusht, që indicjet të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.**

Kjo sms/mesazh nuk ka lidhje në çdo aspekt/këndvështrim procedural të arsyeshëm me pranueshmërinë, besueshmërinë, sigurinë, saktësinë procedurale dhe me plotësinë e çdo lloj prove tjetër të marrë/bazuar/referuar, sipas rregullave procedurale, nga burime procedurale (Shih kuptimin e arsyeshëm të nenit 149/1 të Kodit të Procedurës Penale) dhe që referojnë/bazohen në këtë përgjim;

Se kjo sms/mesazh nuk vlen për të vërtetuar ekzistencën e asnjë lloj fakti, objekt akuze, sepse nuk është e rëndësishme (që do të thotë, se nuk është e vlefshme, në ofrimin e qartë të një të dhëne faktike, nuk është mbështetur logjikisht në prova të tjera të çdo lloji) dhe nuk provon shprehjen e vullnetit tim subjektiv dhe objektiv.

Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale kërkon parimisht (për verifikimin e vërtetësisë së sms/mesazhit dhe përgjimit përkatës) prezencën edhe të provave të tjera konfirmuese.

**Interpretimi që i bën prokurori këtij mesazhi/sms është i pabazuar dhe nuk përputhet me asnjë të dhënë/provë tjetër të përftuar në hetim, prej vitit 2009 e vijim, prandaj duhet konsideruar nga gjykata, se nuk përbën, si njoftim i saktë, në**

**favor të të provuarit të akuzës (sipas neneve 149/1, 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale);**

Se ky mesazh/sms nuk jep asnjë fakt/rrethanë, që ka rëndësi për objektin e të provuarit;

Se ky mesazh/sms nuk është i qartë dhe/ose e saktë dhe/ose i besueshëm dhe/ose i vërtetë dhe/ose i sigurtë dhe /ose i vlefshëm (që do të thotë se është e dhënë evazive dhe nuk ofron diçka të qartë e te kuptueshme).

**2/10).** Në aspektin substancial pretendoj se nuk e pranoj ekzistencën e faktit dhe nuk kam dërguar më datë 22/6/2009 e vijim, me kartën time celulare, asnjë lloj sms/mesazhi me përmbajtjen e saj, objekt akuze, në drejtim të kartës celulare në posedim të dëshmitarit, Z.Kastriot Ismailaj.

Ky mesazh/sms nuk është konstatuar në asnjë lloj forme e mënyrë të vlefshme/besueshme/të vërtetë, të sigurtë dhe sipas rregullave të arsyeshme procedural në kartën time celulare.

**Nuk provohet nga ana objektive (me asnjë lloj prove dhe/ose mjet kërkimi prove, të kërkuar, marrë dhe administruar, sipas kuptimit të neneve 149, 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale), se kjo sms/mesazh është dërguar prej meje apo që të lidhet/mbështetet në mënyrë të sigurtë, objektive, të besueshme dhe të vërtetë procedurale penale, dërgimi i kësaj sms/mesazh prej kartës time celulare, drejtuar kartës celulare në posedim të dëshmitarit, Z. Kastriot Ismailaj.**

**(i)** Ndërsa në aspektin procedural pretendoj/kërkoj/parashtroj se barrën e proves e ka prokurori, në këtë gjykim:

- që **të provojë** para gjykates se aktet e regjistrimit/aplikimit në ish-kompanine celulare “AMC” janë në emrin tim, me atësinë

time, me datëlindjen time, me nënshkrimin tim, për kartën përkatëse celulare (Shih faqet 32-34 të kërkesës për gjykim);

- që **të provojë** para gjykatës se aktet e regjistrimit/aplikimit në ish-kompaninë celulare “Eagle Mobile” janë në emrin tim, me atësinë time, me datëlindjen time, me nënshkrimin tim dhe për kartën përkatëse celulare (Shih faqet 32-34 të kërkesës për gjykim).

Pra, pretendoj se prokurori duhet të paraqesë në gjykatë informacionin e mjaftueshëm nga këto kompani celulare, lidhur me kopje të legalizuar të akteve të regjistrimit/aplikimit prej meje, me atësinë time, me datëlindjen time, për pajisjen/përdorimin tim të kartës celulare përkatëse.

**(ii).** Prokurori ka barrën e provës, që të provojë procedurën e ndjekur në vitin 2009 (sipas neneve 149, 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale dhe të çdo ligji tjetër të zbatueshem në fuqi) për gjetjen/zbulimin/fiksimin, marrjen dhe administrimin e kësaj sms/mesazhi në kartën celulare që posedonte dëshmitari, Z. Kastriot Ismailaj.

**(iii).** Prokurori ka barrën e provës, që **të provojë** në çdo formë mënyre të arsyeshme procedurale, të sigurtë, të vërtetë, të besueshme dhe të vlefshme, në çdo pikëpamje procedurale, se unë e kam dërguar (nëpërmjet kartës time celulare) me ndërgjegje/me vullnetin tim për qëllime kriminale eventuale këtë sms/mesazh në kartën celulare të dëshmitarit Kastriot Ismailaj. Pra, pretendoj se fakti i dërguar sipas kësaj sms/mesazhi në kartën celulare të dëshmitarit Kastriot Ismailaj, nuk përmban biseda, nuk ka pohime (as nga unë, as nga dëshmitari Kastriot Ismailaj).

Kjo sms/mesazh edhe për këto shkaqe/arsye **nuk ka fuqi provuese procedurale në këtë gjykim.**

Në të kundërt, pretendoj se çdo dyshim është në favorin tim procedural, sipas nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale.

Nuk provohet (në mënyrë/formë të sigurtë, të besueshme, të vërtetë, objektive, të saktë procedurale penale), që kjo sms të jetë dërguar, prej meje (me ndërgjegjen time dhe me vullnetin tim) nga karta ime celulare dhe në veçanti për ato qëllime, fakte e rrethana që pretendon/hamendëson prokurori.

**iv). Pretendoj se çdo provë që i referohet këtij përgjimi, kësaj sms/mesazhi, nuk është kërkuar, marrë, administruar, sipas standardeve/kërkesave/garancive, që parashikojnë nenet 149, 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.**

Prokurori ka vlerësuar/interpretuar në mënyrë arbitrare dhe të paarsyeshme faktet lidhur me këtë mesazh/sms sepse pretendohet (nga prokurori) ta lidhin padrejtësisht, krejt spekulative këtë mesazh/sms, me fakte e rrethana sikur mesazhi /sms përkatës, ka lidhje me marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA, kur provohet qartazi (edhe sipas provave të administruara deri tani nga vetë Prokurori), se **DIA është krijuar/regjistruar, si entitet juridik, pas 14 muajsh, duke filluar prej datës 22/6/2009 (dita kur pretendohet konstatimi i këtij mesazhi/sms në kartën celulare të poseduar prej dëshmitarit Kastriot Ismailaj ).**

Provohet qartazi se më datë 22/6/2009 unë isha vetëm deputet në opozitë dhe prezumohet se unë nuk kisha funksione në administratën shtetërore/publike, qendrore për të ndikuar, në çdo formë/mënyrë dhe eventualisht në kryerjen ose moskryerjen e një veprimi, që lidhet me detyrën a funksionin, për të ndikuar eventualisht në kryerjen ose moskryerjen e një veprimi kundër/

në dobi të çdo shtetasi, personi fizik, personi juridik privat /publik.

Këto fakte përbëjnë prezumime faktike dhe prokurori nuk vërteton, deri tani, të kundërtën e këtyre prezumimeve.

Çdo lloj prezumimi tjetër që pretendon prokurori, deri tani, është prezumim arbitrar, i paarsyeshëm, nuk përputhet me rrethanat/faktet e çështjes dhe nuk përputhet me thelbin e neneve 260 dhe 25 te Kodit Penal.

Ky mesazh/sms nuk është në përputhje me prova të tjera dhe nuk mbështetet me asnjë lloj prove tjetër. Pra, nuk mund të bëhet njësimi i vlerës provuese të këtij mesazhi/sms me provat e marra (sipas këtij përgjimi apo që bazohen në këtë përgjim) sepse ky mesazh është i paqartë, me të meta procedurale (referuar faktit se nuk janë respektuar garancitë/standardet procedurale dhe nuk janë respektuar të drejtat e mia të sipërcituara të mbrojtjes, njohjes/aksesit dhe parimi i kondradiktoritetit) dhe ky mesazh ka dyshime sepse nuk përputhet/lidhet/mbështetet me asnjë lloj prove tjetër.

E përsëris se unë nuk kam dërguar asnjë mesazh telefonik (nga karta ime celulare) në drejtim të kartës celulare, që posedonte dëshmitari Kastriot Ismailaj, për t'i marrë atij apo për të pranuar prej tij, ndonje lloj përfitimi të paligjshëm.

Përderisa akuza i referohet këtij lloj mesazhi të paqartë e dyshues pretendoj se çdo dyshim duhet të çmohet nga gjykata në favorin tim procedural. (Shih nenin 4/1 të Kodit të Procedurës Penale)

**2/11).** I theksoj këto kërkesa dhe pretendime lidhur me këtë sms/mesazh në mënyrë që:

**(i).** Gjykata të ketë një bazë të plotë faktike e procedurale, për të kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, në lidhje me

përcaktimin e kushteve e kërkesave/standardeve/garancive të domosdoshme/nevojshme ligjore procedurale penale për shqyrtimin dhe cilësimin prej saj të papërdorshmërisë të këtij përgjimi; Që gjykata të ketë të evidentuar të gjitha rrethanat/ faktet e mjaftueshme relevante të kërkuara, të pretenduara dhe të parashtruara prej meje që i mundësojnë asaj/gjykatës ushtrimin e një shqyrtimi gjyqësor procedural penal efektiv/efikas dhe për arsyetimin e vendimit gjyqësor të ndërmjetëm dhe/ose përfundimtar.

**(ii).** Gjykata të ketë një bazë të plotë faktike dhe procedurale për interpretimin e arsyeshem (jo arbitrar) të rrethanave, shkaqeve /arsyeve, për interpretimin e ligjit të zbatueshem në fuqi më datë 22/6/2009 (kur pretendohet se është konstatuar mesazhi/ sms) sipas thelbit/kuptimit të dispozitave kushtetuese, konventore e ligjeve të sipërcituara (në lidhje me këtë përgjim/sms dhe për çdo lloj prove të marrë dhe administruar nga prokurori, referuar këtij përgjimi/sms).

**(iii).** I theksoj këto kërkesa, pretendime e parashtrime lidhur me këtë sms/mesazh në mënyrë që Gjykata të çmojë veç e veç fuqinë provuese të secilës provë, fuqinë provuese të këtij përgjimi, në harmoni me njëra-tjetrën dhe/ose me prova të tjera (pra, duke bërë/kryer Gjykata “cross-examination” të të gjitha provave të administruara në fazën përkatëse), me qëllim në arritjen e konkluzionit të drejtë, si gjatë procesit (me vendime të ndërmjetme të argumentuara mjaftueshëm), ashtu edhe me vendim përfundimtar (të argumentuar mjaftueshëm), sipas standardit të Kushtetutës, jurisprudencës kushtetuese relevante, standardeve të KEDNJ, jurisprudencës relevante të GJEDNJ dhe sipas standardit procedural penal (referuar Kodit të Procedurës Penale dhe vendimeve unifikuese penale relevante, praktikës

gjiqësore relevante të Gjykatës së Lartë) “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” (Shih qasjen sipas vendimit përfundimtar nr. 26/2025, pg.32-35 të Gjykatës Kushtetuese; Shih qasjen sipas vendimit penal nr. 00-2024-1823 (281) datë 14.11.2024/i pandehur Sali Hasa etj. të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pg. 34, 35, 65, 67, 68).

**3).** Në bazë të një interpretimi sistematik të neneve 151/1, 153 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (që ka lidhje parimisht me dëshminë), në raport me natyrën e sanksionit (papërdorshmëria) të parashikuar nga neni 151/3 të këtij Kodi dhe fakti **se intervista/pyetjet/deklarimet e shtetasve dhe/ose ndaj shtetasve Znj. Vojsava Ismailaj dhe Z. Elvis Mataj nuk ishte dhënë para prokurorit (por para gazetarëve përkatës);** Meqënëse është provuar, në mënyrë shkresore se intervista e Znj. Vojsava Ismailaj është dhënë në bazë premtimesh për t’i siguruar asaj azil jashtë vendit (siç e provon akti datë 27/9/2015 e Kryetarit të Komisionit të Sigurisë Kombëtare në Kuvendin e Shqipërisë, Z. Spartak Braho, drejtuar të gjithë institucioneve publike të sigurisë kombëtare në vend; Meqënëse kjo intervistë është dhënë nga Znj.Vojsava Ismailaj pas refuzimit tim, ndaj mesazhit të saj datë 05/01/2016 në celularin tim (për të cilën kam njoftuar me shkresë Prokurorin e Përgjithshëm); Po kështu, dëshmitari Z. Kastriot Ismailaj (bashkëshorti i Znj.Vojsava Ismailaj), i pyetur për këtë procedim penal i ka rrëzuar të gjitha pretendimet e bashkëshortes së tij në këtë intervistë; Edhe dëshmitari Z. Elvis Mataj i ka mohuar (kur është pyetur nga policia gjyqësore më datë 02/12/2015) faktet e referuara, intervistës së tij eventuale para gazetarit përkatës;

**Për këto shkaqe/arsye, fakte e rrethana pretendoj/kërkoj nga gjykata (sipas kuptimit të arsyeshëm të neneve 32/2 dhe 42 të Kushtetutës dhe dispozitave të sipërcituara procedurale penale):**

**3/1). Të shprehet me vendim të ndërmjetëm, që intervistat e shtetasve Znj. Vojsava Ismailaj dhe Z. Elvis Mataj (dhënë nga secili prej tyre para gazetarëve) të mos përdoren nga gjykata kundër meje në këtë gjykim, as si provë, as si mjet kërkimi prove.**

Nëse intervista/pyetjet/deklarimet e shtetasve Znj. Vojsava Ismailaj dhe Z. Elvis Mataj (dhënë para gazetarëve përkatës), përdoret nga gjykata si provë kundër meje pretendoj se çënohet e drejta ime për një gjykim të drejtë sipas nenet 32/2 dhe 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ; Hedh dyshime të konsiderueshme mbi besueshmërinë e deklarimeve tyre; **Ose** pranimi i tyre do të dëmtonte rëndë integritetin e procedurave;

**3/2).** Pyetjen nga gjykata të shtetasve Znj. Vojsava Ismailaj dhe Z. Elvis Mataj (sipas neneve 360 e vijues të këtij Kodi), me cilësinë e dëshmitarit.

**4).** Sqaroj edhe një herë, se i ndjeri Dritan Prifti ka dhënë dëshmi në një procedim tjetër penal, në periudhën përkatëse kohore.

Po kështu, i ndjeri Dritan Prifti ka dhënë këtë dëshmi, pak ditë pasi Kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, në Kuvendin e Shqipërisë Z. Spartak Braho denoncoi të ndjerin Dritan Prifti dhe deputetin Tom Doshi, për përfshirjen e tyre në një skenar të destabilitetit politik (duke keqpërdorur Znj. Vojsava Ismailaj, pas takimit tyre në Hotel “Sheraton”, Tiranë).

Po kështu, me e-mailin e datës 16/4/2014 (drejtuar Z. Hauser - avokat i Z. Kastriot Ismailaj, në Vjenë/Austri ), i ndjeri Dritan

Prifti përmendet nga dëshmitari Z. Elvis Mataj, me emër (si ish-Ministër i Ekonomisë), që “...i ishte premtuar ryshfet, nga dëshmitari Kastriot Ismailaj, për marrëveshjen CEZ-DIA “.

Këto rrethana rrëzojnë krejt “paditurinë” e të ndjerit Dritan Prifti për marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA.

Pyetja ime eventuale, në atë procedim penal (ku i ndjeri, Dritan Prifti ka dhënë dëshmi), nuk ishte e pa parashikueshme dhe unë nuk jam pyetur në atë procedim penal për shkaqe të pavarura nga vullneti im.

Meqënëse i ndjeri Dritan Prifti nuk ka qenë gjallë, as gjatë procedimit penal objekt gjykimi (pra, ai nuk ka dhënë dëshmi lidhur me çështjen objekt hetimi e gjykimi) dhe unë nuk kam patur mundësi objektive, për ta pyetur të ndjerin Dritan Prifti dhe për të debatuar gjatë gjykimit (sipas parimit të kondradiktoritetit) pikërisht për faktin, se nuk jam njoftuar nga prokurori, unë nuk jap pëlqimin për përdorimin e dëshmisë së tij në këtë gjykim.

Për këto shkaqe/arsye, fakte e rrethana **kërkoj** nga gjykata të shprehet me vendim të ndërmjetëm (sipas kuptimit të arsyeshem të neneve 151/3 e 193 të Kodit të Procedurës Penale), që dëshmia e të ndjerit Dritan Prifti, në procedimin përkatës penal, **të mos përdoret** nga gjykata kunder meje, në çështjen objekt gjykimi, as si provë, as si mjet kërkimi prove.

Nëse dëshmia/deklarimet e të ndjerit Dritan Prifti përdoret nga gjykata si provë kundër meje pretendoj se çënohet e drejta ime për një gjykim të drejtë, sipas nenet 32/2, 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Pretendoj, se hedh dyshime të konsiderueshme mbi besueshmërinë e këtij deklarami **ose** pranimi i saj do të dëmtonte rëndë integritetin e procedurave.

**5).** Sqaroj edhe një here se shtetasi Jozef Hejsek ka dhënë dëshmi në Arbitrazhin tregtar të Vjenës/Austri (lidhur me marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA).

**Arbitrazhi tregtar i Vjenës/Austri nuk konsiderohet as Gjykatë, as organ procedues penal dhe unë, nuk kam qenë i pranishëm në Arbitrazhin e Vjenës (për t'u mbrojtur, në lidhje me deklaratat e këtij shtetasi).**

**Unë nuk jap pëlqimin, që dëshmia e tij indirekte (dhe e pasigurtë), në këtë Arbitrazh të përdoret në këtë gjykim penal.**

**Por ky shtetas është pyetur, nën betim më datën 20/12/2011, nga prokurori Ndini Tavani, në një procedim tjetër penal, në Shqipëri. Gjatë pyetjes së tij, ai ka dhënë deklaratime (para prokurorit) krejt të ndryshme për procedurat dhe garancitë, që çuan në marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA.**

Në këto deklaratime (para prokurorit) ai nuk përmend as emrin tim, as Ministrinë e Jashtme dhe as të ndjerin Qazim Tepshi (ish-ambasadori shqiptar në Republikën Çeke). Në këtë dëshmi Z. Hejsek ka theksuar se “*garancia për lidhjen e kontratës midis CEZ-DIA, ishte DIA e Uashingtonit*”.

Për këto shkaqe/arsye, fakte e rrethana **kërkoj** nga gjykata të shprehet me vendim të ndërmjetëm (sipas kuptimit të arsyeshem të neneve 151/3 e 193 të Kodit të Procedurës Penale), që dëshmia e shtetasit Z. Jozef Hejsek (dhënë prej tij në Arbitrazhin Tregtar të Vjenës/Austri, lidhur me marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA) **të mos përdoret** nga gjykata, kundër meje, në çështjen objekt gjykimi, as si provë, as si mjet kërkimi prove.

Nëse dëshmia e shtetasit Jozef Hejsek, në Arbitrazh, përdoret nga gjykata si provë kunder meje, pretendoj se cënohet e drejta ime

për një gjykim të drejtë, sipas nenet 32/2, 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Pretendoj, se hedh dyshime të konsiderueshme mbi besueshmërinë e këtij deklarami **ose** pranimi i saj do të dëmtonte rëndë integritetin e procedurave.

**6).** Sipas jurisprudencës relevante të GJEDNJ dhe parimisht përcaktohet se: *“...Një tribunal karakterizohet në kuptimin thelbësor të shprehjes nga funksioni i tij gjyqësor, me të cilin duhet kuptuar të vendosurit mbi çështjet brenda kompetencave të tij, bazuar në rregullimet ligjore dhe sipas procedurave të zhvilluara në mënyrë të përcaktuar. Ai duhet gjithashtu të kënaqë një numër kërkesash të mëtejshme si: pavarësia, veçanërisht prej ekzekutivit; paanshmëria; qëndrueshmëria në detyrë e anëtarëve të tij; garancitë e ofruara nga procedura e tij, disa prej të cilave shfaqen edhe në vetë tekstin e nenit 6/1 të KEDNJ”.* (Shih vendimin e GJEDNJ për çështjen “Belilos v. Zvicrës”, datë 29.04.1988).

**Cituar** ky vendim i GJEDNJ në vendimin nr.31/2011 të Gjykatës Kushtetuese....*fuqia për të dhënë një vendim detyrues (që nuk mund të ndryshohet nga një autoritet jogjyqësor) është pjesë përbërëse e vetë nocionit të “gjykatës” dhe mund të shihet edhe si komponent i “pavarësisë”, që kërkohet nga Neni 6/1 të KEDNJ”.* (Shih vendimin e GJEDNJ për çështjen “Findlay kunder The United Kingdom”, Application nr. 22107/93, 25 February 1997, pg.77).

Duke patur parasysh këtë jurisprudencë relevante provohet deri në këtë fazë se nuk është verifikuar/sqaruar nga Prokurori nëse Arbitrazhi Tregtar i Vjenës/Austri e plotëson institutin kushtetues, konventor e procedural “gjykatë” (të identifikuar parimisht, si organi kompetent publik, për të zgjidhur çështjen/mosmarrveshje konkrete).

Provohet deri në këtë fazë se Vendimi i Arbitrazhit tregtar të Vjenës/Austri (lidhur me marrvëshjen CEZ-DIA) nuk plotëson karakteristikat e vendimit gjyqësor civil dhe/ose penal përfundimtar të formës së prerë.

Për këto shkaqe/arsye, fakte dhe rrethana dhe sipas kësaj jurisprudence relevante **kërkoj** nga gjykata (sipas kuptimit të arsyeshëm të nenit 193/7 të Kodit të Procedurës Penale), që vendimi i Arbitrazhit Tregtar të Vjenës të përdoret në këtë gjykim vetëm për evidentimin e kronologjisë kohore të rrethanave të faktit penal objekt akuze.

Por ky vendim Arbitrazhi **të mos përdoret** direkt apo indirekt, për qëllime të asnjë lloj prove (lidhur me ekzistencën e fakteve penale, objekt akuze).

Nëse ky vendim Arbitrazhi përdoret nga gjykata, si provë kundër meje në çështjen objekt gjykimi pretendoj se çënohet e drejta ime për një gjykim të drejtë, sipas neneve 32/2 e 42 të Kushtetutes dhe nenit 6 të KEDNJ.

Pretendoj se pranimi i saj si prove do të dëmtonte rëndë integritetin e procedurave.

**7).** Kërkoj që vendimi gjyqësor penal përfundimtar i dënimit të dëshmitarit Z. Kastriot Ismailaj (përveçse përmban të dhëna/fakte e rrethana, që kanë lidhje me objektin e akuzës, ndaj meje) të kërkohet, të merret dhe të administrohet nga Gjykata (sipas kuptimit të arsyeshëm të nenit 193/7 të Kodit të Procedurës Penale) për qëllime të provës, lidhur me ekzistencën e faktit (për marrvëshjen e lidhur midis CEZ-DIA, objekt hetimi penal), duke e vlerësuar këtë vendim gjyqësor, në unitet me provat e tjera që do të administrohen.

**8).** Duke patur parasysh mesazhin e datës 22/6/2009 pretenduar nga prokurori sikur “...është konstatuar tek karta

celulare me numër 0682009693 apo tek aparati celular, ku ishte instaluar kjo kartë, në përdorim të dëshmitarit Kastriot Ismailaj”; Meqënëse është në interes të parimit të objektivitetit të procesit, objektit të të provuarit, në zbatim të parimit të hetimit të plotë e të gjithanshëm gjyqësor të çështjes dhe në interes të drejtësisë së procesit **kërkoj** nga Gjykata që:

**8/1).** Të kërkohet, të merret dhe të administrohet prej saj, si provë, **çdo vendim** përfundimtar/jopërfundimtar i Prokurorit, **çdo vendim** gjyqësor i veçantë penal ose çdo vendim gjyqësor përfundimtar penal, që ka disponuar përkatësisht në fashikullin penal nr.978 të vitit 2008 të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe në fashikullin penal nr.6381 të vitit 2014 të po kësaj Prokurorie.

**8/2).** Të kërkohet, të merret dhe të administrohen prej saj fizikisht **fashikulli** penal nr.978 të vitit 2008 të Prokurorisë pranë Gjykatës të Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (dhe/ose dosja gjyqësore përkatëse themeli, që përfshin këtë fashikull të prokurorit).

**8/3).** Të kërkohet, të merret dhe të administrohen prej saj fizikisht, **fashikulli** penal nr.6381 të vitit 2014, të po kësaj Prokurorie (dhe/ose dosja gjyqësore përkatëse themeli, që përfshin këtë fashikull të prokurorit).

Pra, në këto fashikuj të prokurorit ose në këto dy dosje gjyqësore themeli (që administrojnë këto fashikuj të prokurorit) të administrohen edhe deklarimet e dëshmitarëve, që kanë deklaruar fakte e rrethana, lidhur me marrëveshjen e lidhur midis CEZ-DIA; Por këta dëshmitarë janë pyetur edhe në procedimin penal kundër meje, për këtë marrëveshje;

Prandaj pretendoj se administrimi i këtyre fashikujve të prokurorit ose dosjet gjyqësore kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi.

Në këto dy fashikuj të prokurorit ose në këto dy dosje gjyqësore themeli (që administrojnë këto fashikuj të prokurorit) të administrohet edhe kjo sms/mesazh, procesverbalet përkatëse eventuale të përgjimit, të regjistrimet e përgjimit eventual, aktet eventuale, që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe/ose zgjatur përgjimin.

Pra, **kërkoj të administrohet e gjithë praktika procedurale** e ndjekur (sipas akteve dhe rrjedhës kronologjike procedurale/administrative penale) nga prokurori/oficeri i policisë gjyqësore, për marrjen dhe administrimin e këtij sms/mesazhi, nga dita e konstatimit të këtij mesazhi (datë 22/6/2009) e deri në përfundim të hetimit/procedimit penal përkatës, me vendim përfundimtar përkatës të prokurorit ose me vendim të veçantë/përfundimtar përkatës gjyqësor penal në ato procedime penale/gjykime penale themeli ose të veçanta penale.

**8/4).** Sipas gjendjes akteve/rrethanave eventuale (që do të rezultojë nga administrimi prej gjykatës i akteve/veprimeve/vendimeve të sipërcituara), të konsiderohet se po kërkoj në këtë fazë nga gjykata, marrjen e provave të tjera (lidhur me këtë sms/mesazh dhe përgjimin e tyre eventual) prova të cilat, nuk janë kërkuar paraprakisht, prej meje dhe për të cilat nuk kam patur mundësi objektive procedurale të njihesha dhe/ose t'i kërkoja (sepse nuk kam dijeni, për ekzistencën e tyre; Shih nenin 356/3 të Kodit të Procedurës Penale).

**9).** Sipas aktit, datë 30/01/2017 nënshkruar prej “McKeon Group” provohet se personi që kishte nënshkruar për ish-partinë

LSI, nuk ishte i autorizuar, për nënshkrimin e marrëveshjes të lidhur midis ish-partia LSI me “McKeon Group”.

Pas kësaj rrethane, marrëveshja përkatëse (e lidhur midis ish-partia LSI me “McKeon Group”) u ndërpre, pas denoncimit tim (pasi unë u njoha me nënshkrimin e paautorizuar nga Z. Iraklis Fidetzis).

I theksoj këto fakte/rrethana sepse depozitimi i akteve, pranë entit “FARA” në SHBA, nuk është argument i mjaftueshëm për saktësi dhe për siguri ligjore, siç është vërtetuar ligjërisht dhe me prova shkresore.

**10).** Të kërkohet dhe të administrohet nga Gjykata si provë ekstrakti historik i personit juridik privat tregtar “Plus Communication” me nr. NIPT-i K91811014B, sepse provon faktin, që ky person juridik privat tregtar (përveç dëshmitarit Samir Mane) ka edhe rreth 160 aksionerë të tjerë. Pra edhe mosdiskriminimi eventual i këtij operatori, në tregun e telefonisë celulare (bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe në ligjin në fuqi nr.9918/2008 “Për komunikimet elektronike...”) ka patur interes publik.

**11).** Të kërkohet (në Kryeministri dhe/ose në Ministrinë e Jashtme dhe/ose në Ministrinë përgjegjëse për fushat e ekonomisë, tregtisë, financave shqiptare dhe kërkim me letërporosi në CEZ Pragë/Republika Çeke) dhe **të administrohet nga Gjykata si provë, informacioni, nëse i ndjeri Qazim Tepshi (ish-ambasador në Republikën e Çekisë) ka qenë i emëruar nga ndonjë autoritet publik qëndror me detyrën këshilltar tregtar prane CEZ, me seli në Pragë/Republika e Çekisë? Nëse po, cili autoritet publik/zyrtar e ka emëruar? Kur është emëruar? Afati i ushtrimit të kësaj detyre prej tij? Ky informacion/fakt/e dhënë ka lidhje me deklaratimet e**

dëshmitarit Z. Jozef Hejsek në Arbitrazhin e Vjenës dhe pretendohet (se përbën provë), nga prokurori.

**11/1).** Personit juridik tregtar CEZ, me seli në Pragë/ Republika e Çekisë, t'i kërkohet informacioni vijues: Nëse ky person juridik administron akte zyrtare, sipas të cilave konfirmohet emërimi i Z. Qazim Tepshi me detyrën këshilltar tregtar, atashuar pranë saj? Nëse po, të dërgohet kopje e legalizuar rregullisht e çdo lloj akti që ajo administron lidhur me atashimin pranë saj të Z. Qazim Tepshi.

**11/2).** Kjo letërporosi “për marrjen e provës” (lidhur me kërkesat e mia dhe/ose kërkesat eventuale të prokurorit dhe/ose kërkesat e Gjykatës) të niset urgjent/direkt, në Republikën e Çekisë sipas kërkesave të nenit 509/4 të Kodit të Procedurës Penale (dhe njëkohësisht të caktohet çdo përkthyes i licensuar i gjuhës zyrtare çeke, i licensuar/ regjistruar nga Ministria e Drejtësisë duke u betuar para gjykatës).

Ndërsa përgjigja, nga pala çeke, t'i kërkohet të formulohet prej tyre (nëse vlerësohet e arsyeshme), në dy gjuhë (çeke dhe anglisht, por me përmbajtje të njëjtë) dhe ky kthim përgjigje të administrohet, sipas rradhës së provave, që unë do të pretendoj në fazën përkatëse procedurale (Shih nenin 359 të Kodit të Procedurës Penale).

**12).** Parimisht dhe gjatë hetimeve paraprake provat merren nga prokurori, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod (Neni 151 i Kodit të Procedurës Penale); Sipas ligjit nr.110/2018 “Për Noterinë” (Shih nenet e tij 62/1, gërma “ll”, 63/1, gërma “gj”) dhe sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, nuk parashikohet kompetenca lëndore e noterit për marrjen dhe administrimin e

deklarimeve, nga shtetas të ndryshëm për fakte/rrethana që do të paraqiten/vlejnë për çështje penale.

Duket qartazi, se deklarata noteriale nr.1846 Rp. datë 22/5/2024 (redaktuar nga notere Joana Smakaj, me seli në Tiranë, lidhur me marrjen e deklaramëve të të pandehurave Ema Çoku e Fatime Kryemadhi) nuk është në kompetencën lëndore të noterit.

Titulli i aktit është “deklaratë noteriale”, ndërsa përmbajtja e aktit i referohet nenit 79 të Kodit Civil.

Meqënëse prokurori ka administruar pyetjen gjatë hetimit paraprak të të pandehurave Ema Çoku e Fatime Kryemadhi; fakti se unë kam kërkuar pyetjen në gjykim të këtyre dy të pandehurave dhe për keto shkaqe kërkoj nga gjykata:

**(i).** Të shprehet me vendim të ndërmjetëm (sipas kuptimit të arsyeshëm të nenit 151/3, 277 e 294 të Kodit të Procedurës Penale), që deklarata noteriale nr.1846 Rp. datë 22/5/2024 (redaktuar nga notere Joana Smakaj) **të mos përdoret** nga gjykata kundër meje në çështjen objekt gjykimi, as si provë, as si mjet kërkimi prove (sepse deklaramet noteriale të këtyre dy të pandehurave është marrë në shkelje të neneve 62 e 63 ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”).

**(ii).** Kjo deklaratë noteriale nuk ka fuqi provuese, në këtë gjykim penal.

**(iii).** Të njoftohet nga gjykata edhe kjo notere, për vendimin e ndërmjetëm eventual të kësaj gjykate (lidhur me këtë deklaratë noteriale), në funksion të parandalimit të përdorimit të saj në të ardhmen për çdo lloj shkak (duke filluar nga dita e marrjes në dijeni prej saj të këtij vendimi të ndërmjetëm gjyqësor).

**13).** Sipas orientimit të Gjykatës, në seancen e datës 24/6/2026 kam grupuar listën e dëshmitarëve (që unë kërkoj të pyeten), sipas episodeve përkatëse:

**Lista e dëshmitarëve vijues, që unë kërkoj të pyeten, për episodin “CEZ-DIA”:**

**Lista e dëshmitarëve vijues, që unë kërkoj të pyeten, për episodin e lobimeve:**

**Lista e dëshmitarëve, që unë kërkoj të pyeten për episodet e pretenduara si “PLUS, AKEP, VODAFONE dhe UNIFI”:**

**Lista e dëshmitarëve vijues, që unë kërkoj të pyeten për episodin e ligjit “Për minierat”:**

**Lista e dëshmitarëve vijues, që unë kërkoj të pyeten, për episodin e shitjes së vilës në Qerret:**

**Lista e dëshmitarëve vijues, që unë kërkoj të pyeten për pretendimet, lidhur me akuzat për fshehje pasurie dhe pastrim parash:**

**12/1).** Sipas gjendjes të dëshmimeve në gjykim do kërkoj nga gjykata kryerjen e ballafaqimit midis dëshmitarëve (referuar neneve 356/3, 169 e vijues të Kodit të Procedurës Penale).

**13).** Kërkoj nga gjykata që çdo akt procedural, çdo provë shkresore dhe/ose dokument apo çdo mjet kërkimi prove që janë paraqitur prej prokurorit dhe provat që do të merren eventualisht nga gjykata (mbi kërkesën time) **të diskutohen/ debatohen veç e veç, si nga prokurori, edhe prej meje (sepse unë kam pretendime/kërkesa/parashtrime për secilën provë të paraqitur prej prokurorit.**

**Pra kërkoj, që këto akte të prokurorit, të mos diskutohen në tërësi.**

Pas këtij veprimi, kërkoj që procesverbalet dhe aktet, që do të diskutohen/debatohen dhe/ose do të lexohen dhe dokumentet e paraqitura nga prokurori (dhe të pranuarat eventualisht nga gjykata) dhe provat që do të paraqiten eventualisht sipas kërkesës time, të futen/përfshihen (bashkë me procesverbalin e seancave gjyqësore), në fashikullin e gjykatës. (Shih nenet 357/2 e 371 të Kodit të Procedurës Penale).

**14).** Kërkoj të administrohen, si provë deklarimet e mia, sepse kërkoj të pyetem në gjykim.

**15).** Lista e provave që kërkoj unë të administrohen, janë parashtruar me shkrim, prej meje, në aktin tim datë 23/6/2026, me titull “Kërkesë për prova”, dorëzuar verbalisht në seancën e datës 24/6/2026 dhe dorëzuar (njëkohësisht me shkrim) në këtë gjykatë, më datë 01/7/2026.

**Përveç aktit tim datë 23/6/2026 dhe aktit objekt parashtrimi datë 08/7/2026 nuk kam listë tjetër provash e kërkesash.**

**16).** Çdo provë, çdo mjet kërkimi prove, çdo fakt dhe çdo rrethanë, për secilën akuzë objekt gjykimi, të administruara në fashikullin e prokurorit pretendoj se është interpretuar në mënyrë/formë arbitrare dhe të paarsyeshme nga prokurori.

Provat, çdo mjet kërkimi prove, çdo fakt dhe çdo rrethanë për secilën akuzë objekt gjykimi nuk është interpretuar nga prokurori, sipas kuptimit dhe thelbit (që parashikojnë parimisht dispozitat procedurale e materiale penale; që parashikon jurisprudenca kushtetuese relevante, jurisprudenca relevante e GJEDNJ, vendimet unifikuese penale relevante dhe jurisprudenca relevante e konsoliduar e deritanishme e Gjykatës së Lartë), për dëshminë (Shih nenet 153 e vijues të Kodit të Procedurës Penale), për dokumentat (Shih nenet 193 e vijues të këtij Kodi), për përgjimin (Shih nenet 221 e vijues të këtij Kodi), për ekspertimin (Shih nenet 178 e vijues të këtij Kodi), për letërporosinë (Shih nenet 509 e vijues të këtij Kodi), për deklarimet e bashkëtepandehurve);

Prokurori nuk ka kryer analizën e hollësishme të mjaftueshme, ezauruese, parimore e konkrete të çdo dispozite ligjore materiale penale, objekt akuze;

**17).** Referuar vendimeve unifikuese nr. 2/2003 , nr. 4/2011 , nr. 6/2011 , nr. 3/2015 te Gjykares se Larte dhe ne parim parashikohet , se *në përcaktimin e kushteve të marrëveshjes , për kryerjen e veprës penale në bashkëpunim , ana subjektive në kryerjen e veprës penale në bashkëpunim konsiston në dy elemente : ndërgjegjja e vullneti i personit , për të kryer veprën*

penale dhe vullneti për të bashkëpunuar me persona të tjerë , për kryerjen e saj ( shih vendimin unifikues nr. 4/2011 i Gjykatës së Lartë ) .

Përcaktimi i ekzistencës së veprimit apo mosveprimit kriminal ( në kuptim të anës objektive të veprës penale) , duhet të jetë rrjedhojë e analizës së kuadrit ligjor që disiplinon detyrat e funksionarit privat dhe vlerësimit të veprimeve të ndërmarra apo të moskryera prej tij , në raport me këto detyrime ligjore .

Që disa persona të jenë në gjendje të kryejnë veprën penale , në bashkëpunim të thjeshtë ( siç akuzohem , une në kete ceshtje ) , duhet ( ne parim ) , që grupi të krijohet , por edhe që sapo të krijohet të dalë nga faza fillestare e krijimit të tij , duke ndarë detyrat dhe rolet me qëllim arritjen e pasjen e kapacitetit , për kryerjen e planit kriminal të parashikuar ose ( edhe pse nuk ka , nje lloj ndarje rolesh ne kuptimin klasik mes te pandehurve ) , ka ndarje punësh mes tyre , për realizimin e qëllimit të përbashkët .

Për të arritur në gjendje aftësie , kërkohet ( ne parim ) një farë kohe e caktuar ( ose marrveshje e atëçastëshme ) , për të krijuar qëndrueshmërinë e vazhdueshmërinë dhe gjatë kësaj kohe parapërgatitore ose aty për aty .

Vec kesaj , është e domosdoshme , që të ekzistojë gjithmonë një ndarje minimale detyrash , në kuptimin që duhet gjithmonë të ketë një ekzekutor dhe një ose disa persona të tjerë , që të veprojnë , si shtytës apo ndihmës ose të kete vetem bashkeekzekutor .

Por sipas ketyre parimeve provohet ( me provat e prokurorit dhe me provat qe kerkoj une te administrohen ne gjykim ) , se nuk asnjë provë apo fakt/indicje , qe te provoje ( tej cdo dyshimi te arsyeshem ) kryerjen prej meje personalisht apo ne bashkepunim , direkt apo indirekt te vepres penale , sipas nenit 260 te Kodit Penal .

**18). Pretendime per akuzen sipas neneve 260 e 25 te Kodit Penal , elementet e saj :**

**Elementët e veprës penale**

**Ana objektive**

**Subjekti aktiv:** eshte funksionar i lartë shtetëror ose i zgjedhur vendor (deputet, kryetar bashkie etj.). Subjekt i veçantë ( pra, cilësia funksionale është thelbësore ) .

**Veprimi:** Kërkimi , marrja (direkt/indirekt), pranimi i ofertës/premtimit të përfitimit të parregullt (favor etj.).

**Objekti:** Veprim ose mosveprim i lidhur me detyrën/funksionin;

**Pasoja:** Nuk kërkohet dëm konkret; vepra është formale (e plotësuar me marrjen e përfitimit me qëllim). Lidhja me detyrën është kyçe.

**Ana subjektive**

**Dashje direkte ose e ngjashme:** Dijenia për përfitimin e parregullt dhe qëllim për ta lidhur me veprimin zyrtar.

**Qëllimi** : Të ndikosh ose të shpërblehesh për veprim/mosveprim zyrtar. Qëllimi specifik është thelbësor dhe dallon nga dhuratat e zakonshme.

**Motivi**: Zakonisht fitim personal ose për të tjerë; nuk është element thelbësor .

**Shkaku**: Abuzimi me pozitën publike për interes privat .

**18/1). Krahasime, analogji dhe jurisprudencë ndërkombëtare , nga sisteme gjyqësore me integritet te larte (deri më dt. 08/7/2026 )**

**GJEDNJ** : Në raste si Beltsios v. Greece ( Aplikimi nr. [57333/14](#) ) , vendimi dt. 28 November 2023 ) , Kanellopoulos v. Greece ( aplikimi nr. 11325/06 , vendimi dt. 21 Shkurt 2008 ) , **GJEDNJ kërkon prova të forta , duke ruajtur prezumimin e pafajësisë.**

**Rreziqet praktike** : Rreziqet reale përfshijnë politizimin dhe ndikimin në stabilitetin politik. Interpretimi duhet të balancojë mbrojtjen e interesit publik , me të drejtat individuale.

**18/2).** Teoria , doktrina dhe praktika gjyqësore ne Shqiperi : *Për qëllimet juridike të identifikimit të natyrës faktike dhe ligjore të konceptit të mitës apo përfitimit të padrejtë apo të parregullt, koncept i parashikuar në nenin 260 të Kodit Penal ( si element thelbësor i anës objektive të veprës penale të korrupsionit )* **Gjykata vleron , se duhet të plotësohet edhe elementi i paligjshmërisë kriminale në përvetësimin e tij, që do të thotë me qëllimin për të dhënë një shërbim të tillë (subjekti pasiv i korrupsionit ) .**

Se koncepti i mitës, rryshfetit dhe përfitimit të parregullt apo të padrejtë nuk mund të ketë karakter objektiv dhe se relativizohet kualifikimi i tij , si të tillë rast pas rasti, duke patur parasysht dobinë e përvetësuar nga subjekti pasiv i veprave penale të korrupsionit.

Kjo do të thotë se gjykata rast pas rasti duhet të vlerësojnë nëse ka qenë utilitare mita, rryshfeti, përfitimi i padrejtë apo i parregullt në raport me subjektin pasiv të veprës penale të korrupsionit.

Nëse subjekti pasiv i korrupsionit provohet se ka fituar dobi materiale apo jomateriale nga ky përfitim atëhere shkaku kryesor se pse kanë hyrë në këtë marrëdhënie kriminale subjekti aktiv dhe subjekti pasiv i veprës penale të korrupsionit do të konsiderohet se plotëson kriteret ligjore për t'u konsideruar juridikisht mitë, rryshfet apo përfitim i padrejtë dhe i parregullt.

Në vlerësimin e Gjykatës ky konkluzion dhe kjo analizë rrjedh nga vetë qëllimi bazë i penalizimit të çdo forme të korrupsionit që shfaqet përgjatë ushtrimit të funksionit publik, pasi parësisht përmes nenit 260 ... te Kodit penal mbrohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e ushtrimit të pushtetit publik, duke dashur sakaq që shkak për ushtrimin e pushtetit publik të jenë kurdoherë kriteret objektive ligjore dhe jo ato subjektive të funksionarit të këtij pushteti. Në këtë mënyrë figurat e veprave penale të korrupsionit të parashikuara në Kodin Penal kanë synuar të penalizojnë çdo ves vullneti të funksionarit publik që lind nga përfitimi personal prej ushtrimit të pushtetit dhe se për rrjedhojë pretendoj se çdo identifikim rast pas rasti i shkakut që ka vesuar vullnetin e ushtruesit të pushtetit publik, duke e formësuar atë pavarësisht , nga motivet e përfitimit personal të padrejtë, do të duhet të konsiderohet se përbën mitë, rryshfet apo përfitim i parregullt dhe

*i padrejtë. Parashikimi ( sipas nenit 260 ) “...për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij...” , nënkupton ekzistencën e një lidhje të domosdoshme dhe integrale të dobisë materiale apo jo materiale të marrë nga subjekti pasiv i korrupsionit si shkak determinant i formësimit të vullnetit të vesuar kriminalisht të tij/saj për të ushtruar pushtetin publik që aktet juridike normative apo individuale i kanë besuar.*

*Ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë specifike dispozitën e nenit 260 të Kodit Penal , për të penalizuar parimisht sjelljen devijante të funksionarëve publikë, në rastet kur veprimet e tyre synojnë cdo përfitim të parregullt , në kuadër të ushtrimit të funksionit publik.*

*Se koncepti i shpërdorimit të autoritetit duhet kuptuar si abuzimi i kryer nga një zyrtar publik, si subjekt i posaçëm i veshur me funksione publike, i cili shfrytëzon pozitën e tij të epërsisë ndaj viktimës ; Nga ana tjetër kjo do të thotë , se dobia materiale apo jomateriale që kërkon të marrë subjekti aktiv i korrupsionit ( përmes ofrimit apo dhënies së mitës, rryshfetit, përfitimit të parregullt apo të padrejtë ) duhet të lidhet drejtpërdrejtë ose indirekt , me një mënyrë të caktuar se si kërkohet nga funksionari publik të ushtrohet pushteti i tij publik i dhënë nga aktet juridike normative apo individuale.*

*Ky kushtëzim ligjor “ ..për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij..” duhet fokusuar parimisht tek elementet penal të fajit në mënyrën se si formësohet vullneti i funksionarëve shtetërorë kur e performojnë ushtrimin e pushtetit publik të besuar.*

*Për t’u konsideruar të tilla, duhet të plotësohet edhe elementi i paligjshmërisë kriminale në përvetësimin e tyre, duke nënkuptuar*

se këto marrëdhënie duhet të jenë ofruar ose përfituar nga subjekti aktiv apo pasiv i veprës penale të korrupsionit me faj ( domethënë me qëllimin për të përfituar një shërbim publik (nga subjekti aktiv i korrupsionit) ose për të dhënë një shërbim të tillë (nga subjekti pasiv i korrupsionit).

Figurat e veprës penale të korrupsionit e plotësojnë parimisht kushtin organik dhe objektiv të ekzistencës së lidhjes integrale të kryerjes apo moskryerjes së veprimit që lidhet me detyrën a funksionin e tij kur funksionari publik kryen funksione ekzekutive dhe/ose veprimtari administrative .

Mjafton që në formësimin e këtij vullneti të funksionarit publik në një mënyrë të caktuar të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm, sipas nenit 4 të K.Pr.Penale, se ka faktorë determinant të fajit penal.

Kjo do të thotë se funksionari publik titullar apo epror do të mbajë përgjegjësi penale për veprën e korrupsionit pasiv edhe kur, duke përdorur tagrat e tij të dhëna nga ligji, akti nënligjor, kontrata publike, apo akti individual administrativ, ushtron pushtetin në atë mënyrë që të ndihmojë, nxisë, diktojë, përgatisë apo edhe rakordojë organet e tjera brenda hierarkisë së atij institucioni apo të varura jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ai.

Kumti i veprave penale të korrupsionit pasiv, në elementin e lidhjes me detyrën funksionale të funksionarit, nuk qendron tek respektimi ( në kuptimin e së drejtës administrative apo te drejtës kushtetuese ) të kompetencave të njohura me ligj, akt nënligjor normativ, kontratë të së drejtës publike apo edhe akt administrativ individual.

Përkundrazi, kumti i veprave penale të korrupsionit pasiv ( përsa i përket lidhjes organike dhe të domosdoshme me ushtrimin e funksionit ) , përfshin çdo sjellje me keqbesim kriminal të funksionarit publik, që përdor në çdo formë kriminale autoritetin e besuar atij nga ligji, akti nënligjor normativ, kontrata publike apo akti administrativ individual për të orientuar, përgatitur apo formësuar një vendimmarrje të caktuar zyrtare, edhe kur kjo vendimmarrje , sipas legjislacionit respektiv merret nga një organ apo njësi tjetër administrative e lidhur me veprimtarinë publike të tij. Në çdo rast do të duhet që ky vullnet , me keqbesim kriminal , **të jetë krijuar nga dashja e drejtpërdrejtë** e përfitimit të parregullt , të padrejtë, mitës apo rryshfetit , prej funksionarit publik.

Nga ana tjetër, figurat e veprës penale të korrupsionit pasiv kanë fushëveprim edhe atëherë kur veprimtaria administrative / publike reale apo formale e një organi brenda një institucioni ushtrohet me keqbesim kriminal si fazë paraprake e shqyrtimit të asaj çështje në organin tjetër të të njëjtit institucion, të një institucioni varësie apo të një institucioni tjetër të lidhur nga legjislacioni respektiv si bashkëvendimmarrës apo bashkëveprues në një procedure të caktuar ligjore.

Edhe kjo fazë paraprake e procesit administrativ/publik përbën ushtrim të pushtetit publik dhe se për rrjedhojë vendoset nga Kodi Penal , nën mbrojtjen e posaçme penale të figurave të korrupsionit pasiv.

Kjo do të thotë , se në çdo rast , kur një pjesë e caktuar e veprimtarisë/pushtetit/funksionit publik ushtrohet i ndikuar nga përvetësimi i mitës ( nga ana e një funksionari publik ) , pavarësisht natyrës ekzekutive , urdhërdhënëse, përgatitore, ndihmëse,

*udhëzuese, vendimmarrëse , që ka veprimtaria publike e ushtruar, do të duhet të konsiderohet , se edhe kjo pjesë e veprimtarisë publike përfshihet , në fushën e veprimit të veprave penale të korrupsionit pasiv të parashikuara , si figura të posaçme të veprës penale në dispozita të ndryshme në Kodin Penal ( përfshire e dhe nenin 260 të këtij kodi ) ; Nga ana subjektive , vepra penale e parashikuar , nga neni 260 i Kodit Penal, kryhet vetëm me dashje direkte ;*

**18/3).** Vlersuar keto parime , lidhur me rastin konkret , nuk provohet se kam përfituar përfitim të parregullt apo të padrejtë nga Samir Mane ...;

**18/4).** Asnje organ publik ( ILDKPKI etj. ) nuk ka konstatuar me çdo formë e mënyrë ligjore materiale e procedurale ( nga çdo zyrtar publik ; ose nga institucione publike , nga çdo palë e interesuar, që preken nga veprimet eventuale ; çdo person që ka një interes në përgjithësi ; nga regjistrat publikë ose privatë, të mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi ; të dhënat nga media; të dhënat ose ankesat nga publiku; çdo burim tjetër i ligjshëm ) , nuk ka patur e siguruar informacione dhe nuk ka patur informacione , për konflikt eventuale interesi dhe as nuk jam njoftuar , se unë jam në konflikte interesi me ndonjë subjekt tregtar që do të përfitonte eventualisht sipas ligjit nr.; Asnje organ publik ( ILDKPKI etj. ) , nuk ka regjistruar emrin tim se kam konflikt interesi me ndonjë subjekt tregtar ;

**18/5).** Unë nuk kam ushtruar detyrë tjetër në periudhën/legjislaturën përkatëse shtator 2013 - shtator 2017 , përveçse deputet dhe Kryetar Kuvendi ; Provohet se unë nuk kisha asnjë lloj kompetence të drejtpërdrejtë apo indirekte në procesin ligjvënës , përveç votës si deputet ;

Sipas Kushtetutes , kisha vetem 1 vote dhe nuk provohet te kem ndikuar apo premtuar , tek deputet te tjere , per te votuar , ne dobi te interesave te ndonjë shtetasi apo subjekti tregtar privat ; nuk kam ushtruar pushtet publik ( të dhënë nga Kushtetuta dhe ligji , për funksionin tim , si deputet e kryetar Kuvendi ) , ne dobi te ndonjë personi ; Nenshkrimi i cdo ligji , nuk perben , parimisht , akt individual , por vetem nenshkruhej prej meje ( per tja derguar Presidentit , per dekretim dhe per ta derguar , per botim , ne Fletoren zyrtare ) ;

Ligji i miratuar “ per minierat “nuk ka krijuar pasoja juridike /financiare për asnje subjekt individualisht të përcaktuar; Për qëllimet e ligjit te zbatueshem nr. 9367/2005 provohet qartazi , se vota ime nuk perbente çastin e fundit te procesit ligjvenes ( gjatë të cilit u vendos miratimi i ligjit perkates ) , nuk kam kryer asnje veprim paraprak vendimmarres ( të cilat do te ishin thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për procesin ligjvenes te miratimit te ligjit perkates ) ; veprimtaria/detyra ime nuk ka qene thelbësore dhe përcaktuese , për miratimin e ketij ligji ; pjesmarrja ime , qëndrimi im në kete proces ligjvenes , per kete ligj , nuk ka qene përcaktues dhe ndikues , ne permbajtjen e tij dhe miratimin e ligjit.

Ligji perkates “ per minierat “ eshte akoma ne fuqi ; Nese paska patur korrupsion ( konstatuar , nga SPAK , ne vitin 2024 e vijim) , atehere , pse nuk eshte ndermarre deri tani , nisma , per ndryshimin e ketij ligji , qe u miratua 12 vite me pare dhe duke u cilesuar ( nga Kryeminsitri Rama ) , ne séance plenare/zyrtare , si ndryshim epokal ?

Keto prova te prokurorit nuk evidentojnë asgjekundi poziten time konkrete te bashkepunimit e përgjegjësini apo format e bashkëpunimit tim , me të pandehuren tjetër Monika Kryemadhi dhe cilindo tjetër ( shih përcaktimet/parimet ne vendimin Unifikues penal nr. 1/2002 te Gjykates se Larte ).

Nuk provohet qartë , plotësimi i anës subjektive të veprës penale , sipas neneve 260 e 25 te K.Penal, bazueshmëria e saj dhe bashkepunimi eventual ( lidhur me rrjedhën e fakteve dhe lidhjen e veprimeve apo mosveprimeve objektive te mia );

Nuk provohet , qe une te kem koherence llogjike veprimesh apo mosveprimesh , me te pandehuren tjetër Monika dhe nuk kam dijeni per cdo lloj komunikimi te saj dhe per asnje episod te akuzes ;

Provohet, se veprimet apo mosveprimet e mia , nuk jane koordinuar ( ne menyre te heshtur apo me veprime konkludente ) apo te jene ne përputhshmëri , me ndonje nga veprimet e perbashketa apo te pavarur , te te pandehures tjetër , per te kërkuar ose marre , drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo lloj përfitimi të parregullt apo një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, për të kryer ose mos kryer një veprim , që lidhet me detyrën a funksionin tim publik . Nuk është arritur të provohet përfshirja ime ( bashkëpunimi ) ne cdo lloj roli , ne kryerjen e saj eventuale .

Nuk provohet qe une te kem vepruar , ne asnje rast , me ndërgjegjen e vullnetin , për të kryer veprën penale sipas neneve 260 e 25 te K.Penal dhe nuk provohet ndërgjegja e vullneti im per te parashikuar apo lejuar kryerjen e vepres penale personalisht apo ne bashkepunim .

Pra, provat e prokurorit janë prova kontradiktore , nuk përmbajnë/nuk krijojnë një bazë reale , objektive , llogjike dhe ekzistente procedurale të besueshme dhe të vërteta të dhënash , faktesh e provash apo mjeti kërkimi i provës dhe nuk janë , në nivelin e provës ( sipas kuptimit të nenëve 149 e vijues të K. Pr. Penale ) .

Fakti, sipas nenëve 260 e 25 të K.Penal nuk ekziston , nuk provohet se ekziston , nuk provohet që është kryer , prej meje dhe as në bashkëpunim ; Pra çdo dyshim të vlerohet , nga gjykata, në favorin tim procedural ( shih nenin 4/1 të K.Pr.Penale );

Për rrjedhojë pretendoj , se ( nën standardin provues të fajësisë penale të kërkuar nga neni 4/1 i K.Pr.Penale ) rezulton qartazi , se provat e akuzës janë të pamjaftueshme , nuk janë të lidhura në mënyrë logjike , objektive dhe të arsyeshme procedurale , për të vërtetuar përfshirjen time personale apo në bashkëpunim , në kryerjen e ndonjë veprë penale , bazuar në rrethana fakti objektive, të çmuara në harmoni, dhe në përputhje me nenin 152 të K.Pr.Penale , në standardin e kërkuar edhe nga jurisprudenca relevante e GJEDNJ ; provat e akuzës janë të pamjaftueshme , nuk janë të lidhura në mënyrë logjike dhe të arsyeshme procedurale , për të vërtetuar fajësinë time ; nuk kam konsumuar elementet subjektive dhe objektive të parashikuara në nenet 260 e 25 të Kodit Penal (për çdo lloj episodi), elemente këto të nevojshme dhe të domosdoshme për të konfiguruar faktikisht dhe juridikisht veprën penale të “ Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë ” dhe kërkoj pafajësi , për këtë/keto episod .

**18/6).** Vlerësuar parimet e sipercituara , ne lidhje me rastin e deshmitarit Kastriot Ismailaj pretendoj , se provat e paraqitura nga prokurori, në raport me faktet penale, nuk evidentojne/analizojne elementët dhe format e kontributit tim , në kryerjen e veprës penale sipas nenit 260 te Kodit penal .

Nuk provojne , se si mund te ndikoj une ne dobi te deshmitarit Kastriot Ismailaj , ne periudhe perkatese kohore nga dt. 22 / 6 / 2009 e vijim , kohe ne te cilen , une isha vetem deputet ne opozite dhe ( per rrjedhoje ) nuk mund te kisha kurrsesi ndikim ne administraten shtetere/publike , qe kryesohej nga nje formacion kundërshtar politik ; Gjithashtu ky ndikim nuk ka ndodhur as faktikisht ;

Nuk u provua qe une te kem vepruar , ne asnje rast , me ndërgjegjen e vullnetin , për të kryer veprën penale , sipas nenit 260 te K.Penal dhe nuk provohet ndërgjegja e vullneti im per te parashikuar apo lejuar kryerjen e vepres penale personalisht .

Pra, provat e prokurorit jane prova të pamjaftueshme e kontradiktore , nuk permbajne/nuk krijojne një bazë reale , objektive dhe ekzistente procedurale te besueshme dhe te vertete të dhënash , faktesh dhe provash apo mjeti kerkimi prove dhe nuk jane , në nivelin e provës ( sipas kuptimit te neneve 149 e vijues te K. Pr. Penale ) .

Nuk provohet qartë , plotësimi i anës subjektive të veprës penale , sipas nenit 260 te K.Penal, bazueshmëria e saj ( lidhur me rrjedhën logjike dhe objektive te fakteve/rrethanave dhe lidhjen e veprimeve apo mosveprimeve objektive te mia );

Fakti, sipas nenit 260 të Kodit Penal nuk ekziston dhe nuk është kryer , prej meje ; Pra cdo dyshim të vlersohet nga gjykata në favorin tim procedural ( shih nenin 4/1 të K.Pr.penale );

Për rrjedhojë, pretendoj se ( nën standardin provues të fajësisë penale të kërkuar nga neni 4/1 i K.Pr.Penale ) rezulton qartazi , se provat e akuzës janë të pamjaftueshme , nuk janë të lidhura në mënyrë logjike , objektive dhe të arsyeshme procedurale , për të vërtetuar perfshirjen time në kryerjen e ndonjë veprë penale , bazuar në rrethana fakti objektive, të çmuara në harmoni, dhe në përputhje me nenin 152 të K.Pr.Penale , në standardin e kërkuar edhe nga jurisprudenca relevante e GJEDNJ ; Provat e akuzës janë të pamjaftueshme , nuk janë të lidhura në mënyrë logjike dhe të arsyeshme procedurale , për të vërtetuar fajësinë time ; Nuk kam konsumuar elementet subjektivë dhe objektivë të parashikuar në nenin 260 të Kodit Penal, për episodin , lidhur me deshmitarin Kastriot Ismailaj , elemente këto të nevojshëm dhe të domosdoshëm , për të konfiguruar faktikisht dhe juridikisht veprën penale të “ Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë ” dhe kerkoj pafajsi , për kete episod.

### **19). Pretendime lidhur me kontratën e lobimit politik GSIS – ish Partia e LSI :**

Sipas ligjit në fuqi nr. 8580/2000 provohet , se KQZ nuk ka vepruar , lidhur me kete kontrate lobimi ; Pra, presumohet fakti se kontrata e lobimit ka qene e rregullt , sipas parimeve kontraktore të njohura ndërkombetare dhe neneve 79 , 422 , 659 e vijues , 690 e vijues të Kodit Civil në fuqi , sic janë *barazia e palëve dhe barazia e vullnetëve ; Liria e vullnetit / autonomia e vullnetit (liria e kontratës) ; kontrata ka fuqinë e ligjit dhe duhen*

respektuar ; mirëbesimi ; sanksioni pasuror (përgjegjësia civile) ; siguria juridike dhe legaliteti/ligjshmeria ;Parimi i proporcionalitetit ; korrektesa ; paanësia ; kërkesat e arsyes ; bashkëpunimi midis palëve ; detyrimi për të arritur një rezultat ose për të bërë përpjekje maksimale ; mbrojtja nga negociatat në keqbesim ; parimi i vullnetit të lirë dhe lëvizja e lirë e ideve politike perparimtare;

...një individ që vepron me mirëbesim ka , në parim, të drejtë të mbështetet në deklaratat/aktet e bëra nga zyrtarët e shtetit ose zyrtarët publikë , që duket se kanë autoritetin për ta bërë këtë, dhe të supozojë , se të gjitha rregullat dhe procedurat e brendshme janë respektuar , përveç nëse rezulton qartë , nga dokumentet e qasshme publikisht ( përfshirë legjislacionin primar ose sekondar ) , ose një individ ishte ndryshe i vetëdijshtëm ( ose duhej të kishte qenë i vetëdijshtëm ) , se një zyrtar i caktuar nuk kishte autoritetin , për të vepruar me kete cilesi / për te perfaqsuar ligjërisht shtetin . Nuk duhet të jetë përgjegjësi e një individi të sigurojë , që autoritetet shtetërore , po i përmbahen rregullave dhe procedurave të tyre të brendshme , të cilat janë të paqasshme , për publikun dhe që janë projektuar kryesisht, për të siguruar llogaridhënie dhe efikasitet , brenda një autoriteti shtetëror. Një shtet ( autoritetet e të cilit , nuk kanë respektuar rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme ) , nuk duhet të lejohet të përfitojë , nga gabimi i tyre dhe të shmangë detyrimet e tyre. **Pra , rreziku i çdo gabimi të bërë nga autoritetet shtetërore , duhet të mbartet nga shteti ; gabimet nuk duhet të korrigjohen , në kurriz të individit të prekur , veçanërisht kur nuk është në lojë , asnjë interes tjetër privat , në konflikt ( shih vendimin e GJEDNJ per ceshtjen Lelas kundër Kroacisë , nr. 55555/08 , dt. 20 maj 2010 , § 74 ).**

...vendosja dhe respektimi i rregullave ( nëpërmjet të cilave palët sigurojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje civile ) , ka një rëndësi të veçantë, pasi kufizon diskrecionin, siguron barazinë e armëve, shmang arbitraritetin, siguron zgjidhjen efektive të çështjes si dhe garanton sigurinë juridike ( shih vendimin e GJEDNJ per ceshtjen Zubac kundër Kroacisë (Dh.M.), nr. 40160/12, datë 05.04.2018, §§§ 90, 95, 96).

...parimi i “ **qeverisjes së mirë** ” kërkon , që kur një çështje me interes të përgjithshëm është në lojë , është përgjegjësi e autoriteteve publike të veprojnë në kohë të përshtatshme, në mënyrë të duhur dhe me qëndrueshmërinë më të madhe ( shih vendimin e GJEDNJ per ceshtjet : Beyeler kundër Italisë [GC], nr. 33202/96 , vendim i vitit 2000 , § 120 ; Megadat.com S.r.l. kundër Moldavisë, nr. 21151/04, § 72 , dt. 8 prill 2008 ).

**Pretendoj , se deri tani , asnjë gjykatë , ne Shqiperi dhe ne SHBA , nuk ka gjetur, që transaksionet e ish- Partise LSI , ishin fiktive dhe as nuk është ngritur ndonjë padi ( në lidhje me to ) dhe nuk eshte bere ndonje lloj paralajmerimi , per parandalimin e cdo lloj veprimi vijues/vazhdues te parregullt eventual ;**

**Çështja e GJEDNJ "Yukos kundër Rusisë" (2014)**

**Qasja e GjEDNj:**

**Neni 7: Gjykata gjeti se disa nga akuzat për ... bazoheshin në interpretime të reja të ligjit që nuk ishin të parashikueshme në kohën e kryerjes së kontratave , duke shkelur parimin e mosdënimit pa liq ;**

Pra , referuar parimit te “ **qeverisjes së mirë** ” , referuar dispozitave te Kodit Civil , referuar ligjit nr. 8580/2000 “ Për partitë politike “ dhe referuar jurisprudences relevante te GJEDNJ ; Perderisa KQZ dhe autoritetet e SHBA nuk provohet , se kane vepruar në kohë të përshtatshme , në mënyrë të duhur dhe me qëndrueshmërinë më të madhe , nese kjo kontrate lobimi do te ishte lidhur eventualisht ne menyre fiktive apo per shkaqe mashtrimi te cdo lloji apo per qellime kriminale ; perderisa nuk eshte provuar keqbesimi midis paleve kontraktore lobuese GSIS- ish- partia e LSI , kjo kontrate nuk eshte anuluar apo shfuqizuar me vendim gjyqësore ( ne Shqiperi dhe SHBA , nisur nga gjendja e akteve aktuale ) ;Por perkundrazi ka sjelle pasoja/eshte ekzekutuar pretendoj , se , deri ne kete faze dhe nga kjo kontrate lobimi , nuk mund te kete pergjegjesi civile dhe as pergjegjesi penale , pikerisht per faktin/shkakun se fakti objekt akuze , nuk perben veper penale ; Kualifikimi penal i kontratave civile duhet të jetë i bazuar në ligj të qartë dhe të shoqërohet , me procedura të drejta.

Kualifikimi penal i kontratave civile çon , në shkelje të të drejtave sipas KEDNj , kur ligji/interpretimi i ligjit , aplikohet në mënyrë retroaktive.

Çështja e sipercituar Yukos tregon rrezikun e abuzimit të pushtetit shtetëror , përmes kualifikimit penal te kontratave civile.

Kualifikimi penal i kontratave civile ( për shkelje eventuale te detyrimeve kontraktore ) dhe fakti veprimi/ndjekja ime penale u bazua mjaftueshem , në një interpretim retroaktiv dhe te paqarte të ligjit , per partite politike dhe dispozitave te Kodit Civil dhe/ose i Kodit Penal ( i cili nuk ishte i parashikueshëm , sipas

nenit 7 te KEDNJ , për mua , në kohën e lidhjes së kontrates se lobimit dt. 03 / 02 / 2016 cenon edhe parimin e mosdënimit pa ligj.

Per keto shkaqe e rrethana kerkoj pafajsi , per faktet qe lidhen me kete kontrate lobimi ; Po keshtu ( referuar statutit te ish-partise LSI , per vitet 2016 e 2017 , kompetencat/detyrat dhe pergjegjesite e Kryetarit ( ushtruar prej meje ) , perjashtojne parimisht cdo lloj pergjegjesie te tij , per cdo lloj aktiviteti /shpenzimi financiar .

## **20). Lidhur me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare ( shkurtimisht pasqyrohet AKEP ) :**

Parimisht AKEP- i është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji i zbatueshem për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Roli, funksionet dhe kompetencat institucionale si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar përcaktohen në legjislacionin material për komunikimet elektronike dhe shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

AKEP është person juridik, publik, jobuxhetor, i cili drejtohet nga Këshilli Drejtues , që është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë.

**Kryetari i Këshillit Drejtues të AKEP zgjidhet me propozim të Këshillit të Ministrave , me miratim nga Kuvendi i**

## **Republikës si dhe shkarkohet po me propozim të Këshillit të Ministrave dhe me votë nga ana e Kuvendit.**

**20/1).** Në lidhje me qëndrimin/vazhdimin në detyrë të të pandehurit tjetër Piro Xhixho parashtroj , se ai u propozua dhe u emerua , në vitin 2009 në krye të AKEP.

Nuk mund të pretendohet , për asnjë lloj forme/menyrë të ndikimi të paligjshëm , prej meje , sepse qëndrimi në detyrë i Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP , është parimisht , në kompetencë e Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit .

Emerimi /qendrimi në detyrë të pandehurit Piro Xhixho, nuk ka ardhur , për shkak të vullnetit tim .

Struktura e AKEP është miratuar , me vendim të Kuvendit ( jo vetëm , nga vota ime ) ; Anëtarët e Bordit të AKEP , janë emeruar nga Kuvendi ( jo vetëm , nga vota ime ) ; I theksoj këto fakte , sepse vendimmarrja ( për qëndrimin /vazhdimin e tij në detyrë apo lirimin e tij nga detyra ) , çdo lloj vendimmarrje tjetër ( që kishte lidhje me të pandehurin Piro dhe për aktivitetin/detyrën e tij publik ) , nuk lidhet me funksionin tim ;

Vota ime nuk përbente çastin e fundit të procesit vendimmarrës , gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit/eve , që kishte lidhje me të pandehurin Piro ( për qëndrimin /vazhdimin e tij në detyrë apo lirimin e tij nga detyra ) ; Vota ime nuk ishte e rëndësishme , edhe për ato çaste paraprake të vendimmarrjes, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit/eve , që kishte lidhje me të pandehurin Piro ( për qëndrimin /vazhdimin e tij në detyrë apo lirimin e tij nga detyra ) ; unë nuk kisha kompetencë thelbësore

, përcaktuese , ndikimi dhe qëndrimi për vendimmarrjen , që kishte lidhje me të pandehurin Piro Xhixho ( për qëndrimin /vazhdimin e tij në detyrë apo lirimin e tij nga detyra ). Emerimi /qendrimi në detyrë i të pandehurit Piro Xhixho, nuk ka ardhur ,për shkak të votes time .

**20/2).** Une ( gjate kryerjes te detyrave te mia publike ) kam patur vetëm marrëdhënie institucionale me të pandehurin Piro Xhixho.

Une nuk kam patur asnjë lloj komunikimi , me të pandehurin Piro Xhixho , për asnjë lloj interesi privat ;

Nuk ka asnjë prove ( direkte apo indirekte ) , që une të kem vepruar ( me vullnetin e plote dhe me ndergjegje ) , personalisht apo në bashkepunim me të pandehurin Piro Xhixho , për të kryer ndonjë veprë penale dhe nuk provohet koha e bashkepunimit eventual ;

Nuk kam kryer asnjë veprim personalisht apo në bashkepunim , që lidhet me funksionin tim të lartë shtetëror dhe nuk ka lidhje direkte apo indirekte me marrjen e përfitimeve të parregullta , prej meje ( personalisht apo në bashkepunim ) , nga shtetasi Adrian Shtaku ;

Edhe për këto shkaqe/arsye në përfundim pretendoj , se nuk provohet ( nga ana objektive dhe ana subjektive ) , se qëndrimi / vazhdimi , në detyrë , i të pandehurit Piro Xhixho dhe veprimet apo mosveprimet e tij zyrtare , kishin lidhje direkte apo indirekte me marrjen e përfitimeve të parregullta , prej meje , nga shtetasi Adrian Shtaku apo cilitdo shtetasi apo subjekti ;

**21). Pretendime lidhur me ekspertimin financiar ( kryer ne hetimet paraprake ) :**

Ligji nr. 9049/2003 ( i ndryshuar ) , nuk parashikon , që metodologjia e përlllogaritjes te te ardhurave , shpenzimeve jetike/bazike familjare , investimeve , ti referohet INSTAT .

As ILDKPKI nuk më ka njoftuar , orientuar apo këshilluar ( për të qenë unë i ndërgjegjesuar qartësisht ) faktin , se referimi/përlllogaritja e shpenzimeve jetike/bazike , do të bazohet në të dhënat e INSTAT;

Sipas nenit 21 të ligjit të kohës nr. 9049/2003 , parashikohej ( ndër të tjera ) “ ... *Deklaruesit , përpara deklarimit , duhet t'i jepen të gjitha këshillimet e nevojshme , për plotësimin e deklaratës...* “ ; Ky detyrim i ILDKPKI përbën prezumim faktik dhe ligjor ;

**21/1).** Meqenëse ne periudhen kohore te viteve 2003 -2023 , objekt ekspertimi ishin në fuqi , ligje të ndryshme financiare , tatimore , kontabile , ekonomike , ligje organike për statistikën , atëhere ( për kryerjen e një procedure të drejtë vlersimi financiar ) , edhe Prokuroria duhet të shqyrtonte çështjen e vlersimit tim , në ligjin organik ne fuqi “ Për statistikën “ , në metodologjinë ( përfshirë legjislacionin financiar , tatimor , kontabel , ekonomik , vlerat e referencës , kursin e kembimit , standardet dhe formulën e përdorur në arritjen e konkluzioneve financiare ) , që kanë qenë në fuqi ( në vitet 2003 - 2023 ) , referuar parimit , që *rregullimi/norma përkatëse ( që do zbatohet ) , sjell/sillte pasoja , të çdo lloji , për zbatim , pas hyrjes tij në fuqi* ; **Pra pretendoj , se nuk mund të sjellë pasoja një rregull/metodologji i/e caktuar , që nuk njihej , nuk zbatohet , nuk është botuar dhe as nuk më është vënë në**

**dijeni/këshilluar apo orientuar , në periudhën kohore të viteve 2003 - 2023** , nga ILDKPKI ( sepse këto rregullime dhe metodologji u perdoren vetem nga Prokurori , per efekt te ketij ekspertimi , ne ceshtjen objekt hetimi ) . **Ne kete drejtim pretendoj , se une rezultoj me diferenca eventuale te vlerave monetare (ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 ) , vetem nga metodologjia e ekspertimit dhe analizes financiare te aplikuar/kryer nga ekspertja dhe sipas detyres , qe i kishte caktuar prokurori , ekspertes te punesuar prej tij ;**

**21/2).** Gjithashtu Prokurori ka urdheruar kryerjen e ekspertimit financiar , referuar llogaritjes te te ardhurave , shpenzimeve dhe investimeve te mia , vetem per periudhen kohore te viteve 2003 - 2023 ;

Prokurori nuk ka arsyetuar faktin , se cilat jane shkaqet/arsyet , faktet e rrethanat relevante dhe ligji i zbatueshem , te ketij kufizimi kohor llogaritjeje , per te cilat nuk llogariten te ardhurat e mia ( nga paga , shperblimet , dietat etj. ) , ne periudhen kohore te viteve 1992 - 2002 , sepse kam qene deputet ( ne Kuvendin e Shqiperise ) , kam qene Kryeminister ( vitet 1999 - 2002 ) , zv. Kryeminister ( vitet 1998 – 1999 , 2002 ) , Minister i Jashtem ( viti 2002 ) , sekretar Shteti ne Ministrin e Jashtme ( viti 1998 ) , me pagat më te larta dhe te ardhura tjera ( qe lidhen me pagen ) ;

Ne periudhen kohore te viteve 1995 – 2002 kam bere deklarime per pasurine , sipas ligjit te zbatueshem nr.7903, datë 8.3.1995 “ Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik ” ; Prokurori nuk ka hetuar e provuar , se deri ne vitin 2002 , nuk kam patur kursime , nga

paga , shperblimet , dietat dhe te ardhurat e tjera ( per shkak te detyrave te mia publike te sipercituara ) ; Pra , duke patur nje vlere te caktuar kursimesh me dt. 31 / 12 / 2002 pretendoj , se kjo vlere monetare kursimesh , eshte mbartur natyrshem , edhe ne vitin 2003 ( viti , kur fillon llogaritja e te ardhurave, kryer nga ekspertja , sipas detyres se prokurorit ) ; Gjithashtu une kam perfituar dieta , edhe nga Partia Socialiste , ne periudhen kohore te viteve 1992 – 1997 , sepse isha ne detyren e Nenkryetarit te kesaj Partie , per mardheniet nderkombetare ; Edhe per kete fakt te periudhe kohore ( te viteve 1992 – 1997 ) , prokurori nuk ka hetuar e provuar , mungesen e te ardhurave apo kursimeve te mia ; Per keto shkaqe/arsye e rrethana pretendoj , se moskryerja e analizes financiare , per te ardhurat e mia , ne periudhen kohore te viteve 1992 – 2002 dhe mosperfshirja , ne analizen financiare te kesaj periudhe , te te ardhurave ( paga dhe te ardhurat per shkak te saj ) dhe e kursimeve te kesaj periudhe kohore , perben mosveprim arbitrar , i paarsyeshem , joproportional dhe keto mosveprime ndikojne direkt , ne analizen time financiare te periudhes kohore te viteve 2003 – 2023 , objekt ekspertimi ( ku bazohet prokurori dhe ekspertja ) ;

**21/3).** Sipas nenit 34/2 te ligjit nr. 9049/2003 parashikohet , se *...Deklaratat e interesave private janë dokumente zyrtare...* ; Prokurori nuk ka marre informacion , ne ILDKPKI , se ne cfare metodologjie financiare , eshte bazuar ajo ( ILDKPKI ) , ne shqyrtimin /vlersimin , nxjerrjen e konkluzioneve **pozitive** te deklarimeve te mia pasurore ( per te ardhurat , shpenzimet dhe investimet e mia ) , ne periudhen kohore te viteve 2003 - 2023 ; **Duke qene se deklarimet e mia periodike ( te administruara , prej ILDKPKI , ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 ) jane akte zyrtare** të verifikuara/kontrolluara , nga personi që ushtron veprimtari publike/nepunes i ILDKPKI ( brenda

kufijve të kompetencës tij ) , në formën e caktuar zyrtare ( pra , përbëjnë provë të plotë për veprimet e kryera , prej këtyre nepunesve ) **dhe deri tani nuk është provuar e kundërta apo pavertësia/fallsiteti tyre** pretendoj , se prokurori nuk ka provuar , sqaruar dhe argumentuar mjaftueshem shkaqet /arsyet , per te cilat ato deklarimet e mia periodike vjetore te pasurise , ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 , nuk kane fuqi provuese , per konkluzionet e tyre financiare per te ardhurat , shpenzimet dhe investimet ;

**21/4).** Per menyren e llogaritjes te te ardhurave / dietave , nga viti 1992 e vijim nuk ka patur asnje verejtje , nga ILDKPKI , as jam keshilluar , nga ILDKPKI , as nuk kam patur denime/sanksione administrative nga ILDKPKI , por vetem Prokuroria , ka qendrim tjetër , duke kufizuar padrejtesisht periudhen e vlersimit tim financiar ; Kjo menyre deklarimi , nuk ka lidhje me rritjen artificiale te te ardhurave te mia , por me pasivitetin eventual te ILDKPKI , per te me orientuar apo keshilluar per faktin, se kush quhet e ardhur dhe nese duhen perlllogaritur edhe dieta , si e ardhur ;

**21/5).** Ne kundërshtim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertës ( shih pg.1/a , fq.14 ) pretendoj , se burim te ardhurash , per mua ( ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 ) , ka qene edhe paga dhe ardhurat e tjera , per shkak te saj ( sic jane dieta etj. ) te perfituara ne Ministrine e Jashtme , në Ministrine e Ekonomise , Energjitikes e Tregtise dhe Keshilli i Larte i Drejtesise ( kjo e fundit , per shkak te detyres time , si President i Republikës ; paga ne ish- Keshillin e Larte te Drejtesise , perfitohej , nga buxheti ketij Keshilli ) ; Pra , pretendoj , se ekspertja nuk i eshte referuar te dhenave financiare dhe ketij dokumentacioni , qe administrohet , ne ILDKPKI ; Gjithashtu

ekspertja nuk sqaron , se si ka vepruar , per dokumentacionin bankar , te periudhes kohore , pas dt. 30 / 9 / 2022 ; Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar , se per cfare shkakut mundon informacioni bankar perkates , pas dt. 30 / 9 / 2022 ( shih dhe fq. 65 ) ; Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar , per mua/emrimitim , se cfare lloj perfitimesh perfshinte trajtimi financiar , si deputet ( ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 ) ;

**21/6).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar faktin , se cfare perfshin e ardhura , nga paga , e deklaruar prej meje , sipas deklarimeve periodike te viteve 2003 – 2005 , 2007 , 2012 ( shih faqen 15 te ekspertimit ) ; Ndersa per deklarimin tim periodik vjetor , per vitin 2006 ( shkurtimisht pasqyrohet DPV ) rezulton , se ekspertja ka perfshire edhe informacion , per vitin 2005 ; Nuk kuptohet qarte , nese eshte lapsus , apo eshte pjese e arsyesimit te DPV-s time te vitit 2006 ; Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar ( fq. 17 ) , se per cilat vite ( ne periudhen kohore 2005 – 2021) kam më shume deklarime , sesa kreditime , ne llogari dhe ne cilat vite (te periudhes kohore 2005 – 2021 ) rezulton e kunderta ;

**21/7).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar faktin , **se ne cilin ligj dhe akt nenligjor bazohet fakti** , qe nuk llogaritet dieta , si e ardhur , per mua , per vitet 2017 - 2020 , terhequr ne Presidency , perderisa provohet , se eshte deklaruar , prej meje , ne ILDKPKI (Shih fq. 17 ) ; Nuk ka sqaruar , **se ne cilin ligj dhe akt nenligjor** bazohet fakti , qe dieta ime ( si deputet dhe per detyra tjera publike ) , llogaritet edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ( shih fq. 21 ) , kur ajo duhet te perllogaritet ose si e ardhur ose si shpenzim ; Provohet qartazi ( shih fq. 21 , tabela perkatese , me te dhenat e mia ) , se llogaritja e te ardhurave , nga ekspertja , fillon nga viti 2005 , kur provohet , se une (

edhe per efekt te periudhes kohore te viteve 2003 – 2023 , objekt ekspertimi ) , kam qene deputet , ne vitet 2003 , 2004 ( pra , ekspertja nuk ka perfshire , ne kete tabele/analize , edhe te dhenat e mia financiare , per vitet 2004 e 2005 ) ; Pretendoj , se keto fakte bazohen , nga Prokurori , në interpretime/vlersime të reja retroaktive financiare , që nuk ishin të parashikueshme mjaftueshem , prej meje , në vitet 2017 – 2020 ;

**21/8).** Referuar arsyetimit/konkluzionet e ekspertes ( shih pg.5.1.3 , fq. 33 per kontraten e shitjes dt. 26 / 02/2016 ) pretendoj , se ekspertja nuk ka percaktuar , se ne llogari te kujt eshte bere kreditimi i cmimit ( ne llogarine time ? apo ne llogarine e te pandehures Monika Kryemadhi? );

**21/9).** Ne kundersiztim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertes ( shih fq.34 dhe tabela/pasqyrat perkatese ) pretendoj , se ekspertja nuk sqaron mjaftueshem , se cilave kurse kembimi i referohet ajo ( kursit te kembimit ditor ? mujor ? apo kursit mesatar vjetor ? , per vlerat e transaksioneve perkatese , ne monedhen “ euro “ ) ; Ekspertja nuk sqaron faktin , per te cilen , ne tabelen footnote 9 te kesaj faqeje , i referohet kursit te kembimi te dt. 31/12/ te cdo viti , kur provohet , se per cdo transaksion , eshte paguar tatimi perkates ; Pra , edhe kursi i kembimit duhet ti referohet dites , kur eshte paguar tatimi , per cdo transaksion apo dites te pageses se cmimit te transaksionit ; Ekspertja nuk i ka bashkalidhur ekspertimit , ekstraktin tabelar perkates referues te Bankes te Shqiperise , per te provuar ditin , se kur ajo i ka aksesuar te dhenat elektronike /informacionin referues te kursit te kembimit ;

**21/10).** Ne kundersiztim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertes (Shih fq.45) pretendoj , se ekspertja nuk sqaron

shkakun , per te cilat ajo nuk i referohet ( per periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 , objekt ekspertimi ) ligjeve organike te zbatueshme nr. 7687/1993 e nr. 9180/2004 “ Për statistikat zyrtare “ , por i referohet informacionit nga faqja elektronike e INSTAT ( shih edhe footnote 11 te kesaj faqeje ) ; Ekspertja nuk sqaron shkaku, se pse ajo i referohet , per llogaritjet financiare ( lidhur me koston time te jeteses ) metodes se Njesisë Ekonomike Familjare ( shkurtimisht NJEF ) dhe pse nuk i referohet metodave tjera ( sic eshte Anketa e Buxhetit të Familjes etj. ) ; Ne kundërshtim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertës ( shih fq.46 ) pretendoj , se ekspertja nuk sqaron shkaku, se si ka vepruar dhe ku referohet , per vitet 2003 - 2006 , 2008 , 2010 – 2013 , meqenese mungojne te dhenat e NJEF ( pra , sipas saj , ekzistojne te dhena , vetem per vitet 2007 , 2009 , 2014 - 2023 ) ; Prokurori nuk ka kerkuar informacion shtese , nga INSTAT , per shkaku e mungeses te te dhenave perkatese , per vitet 2003 - 2006 , 2008 , 2010 - 2013 dhe ku bazohet INSTAT , per keto vite ;

**21/11).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq.46 ) , se per cilen periudhe kohore femijet mi kane qene per studime jashte vendit.

**21/12).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 46 ) , se cila eshte periudha konkrete 10 mujore dhe periudha konkrete 2 mujore te viteve perkatese 2014 , 2015 , qe ajo ka llogaritur shpenzimet , sipas NJEF , me 4 dhe 5 persona;

**21/13).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 46 ) , se cila eshte periudha konkrete 10 mujore dhe periudha konkrete 2 mujore te viteve perkatese 2016 – 2018 , qe ajo ka llogaritur shpenzimet , sipas NJEF , me 3 dhe 5 persona;

**21/14).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 47 ) , se cila eshte periudha konkrete 10 mujore dhe periudha konkrete 2 mujore e viteve perkatese 2018 , 2019 , qe ajo ka llogaritur shpenzimet , sipas NJEF , me 3 dhe 5 persona ; Nuk kuptohet , se pse eshte llogaritur nga ekspertja perseri viti 2018 , megjithese ishte analizuar , edhe më lart;

**21/15).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 47 ) , se cila eshte periudha konkrete 10 mujore dhe periudha konkrete 2 mujore e viteve perkatese 2021 - 2023 , qe ajo ka llogaritur shpenzimet , sipas NJEF , me 2 dhe 5 persona ;

**21/16).** Ne kundërshtim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertës ( shih tabelen e periudhes kohore te viteve 2003 – 2023 , fq.47 ) pretendoj , se ekspertja nuk sqaron , se si kane rezultuar , seicila prej vlerave totale te shpenzimeve per konsum , te kesaj periudhe kohore ; Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 47 ) , se si rezultoi vlera totale monetare e shpenzimeve , per konsum 18.029.860 leke ;

**21/17).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 50 , pg. 2.2 ; fq.51 , pg. b.1 ) se ciles DPV perkatese i referohet , per burimin e te ardhurave, lidhur me apartamentin , ne rrugen “ Vaso Pasha “ Tirane ;

**21/18).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 53 ) , se cili dokumentacion /informacion mungon , per pasqyrimin e likuidimit te vleres se automjetit perkates ;

**21/19).** Ne kundërshtim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertës ( shih po fq.53 ) pretendoj , se ekspertja e ka perlllogaritur gabim diferencen e vleres monetare 20.000 euro (

lidhur me kontraten e huase perkatese ) , nga veprimi midis vlerave monetare eventuale 34.000 euro -140.000 euro, kur ky veprim i thjeshte matematikor , nuk jep kurrsesi dhe objektivisht diferencen me vlere 20.000 euro;

**21/20).** Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 54 , 58 ) , se cili dokumentacion/informacion konkret i mungon ( ose mungon ne dosje ) , per te llogaritur shpenzimet e cdo udhetimi dhe akomodimi ; Ne kundërshtim me arsyetimin/konkluzionet e ekspertës ( shih po fq.54 ) pretendoj , se ekspertja nuk sqaron , **se cilit ligj apo akt nenligjor te zbatueshem ne fuqi** , i referohet per konkluzionet vijuese “ *ne mungese te informacionit lidhur me cmimin faktik te biletës se udhetimit ... eshte marrë bazë llogaritje nje minimum shpenzime vajtje- ardhje vlera monetare 150 euro , per udhëtimet me linje ajrore/detare dhe 50 euro , per udhëtimet me mjete transporti ; .... ne mungese te informacionit , lidhur me shpenzime faktike akomodimi , per cdo dite qëndrimi , eshte llogaritur shpenzim 50 euro “ ; Ekspertja nuk sqaron ( shih fq. 54 ) , nese kjo “ vlere shpenzimi faktike akomodimi , per cdo dite qëndrimi eshte llogaritur shpenzim 50 euro “ , eshte si per mua , ashtu edhe per femijet e mi ? ( kur dihet , se ne periudhat kohore perkatese , keta femije kane qene minoren ) ; Parimisht parashikohet , se *eksperti mund të autorizohet të marrë pjesë , edhe në pyetjen e palëve ; ....eksperti kërkon të dhëna nga i pandehuri ....( neni 184 i K. Pr. Penale ) ;* Por provohet , se prokurori dhe ekspertja , nuk e kane shfrytëzuar kete parashikim ligjor , per hetimin dhe sqarimin e rrethanave te sipercituara te ceshtjes ;*

**21/21).** Prokurori dhe ekspertja , nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 54 ) , se **ne cilin ligj dhe akt nenligjor** bazohet , per mua ( lidhur me periudhen kohore te viteve 2003 – 2010 )

, qe dieta , per udhëtimet e mia ( per shkak te detyres time publike ) llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ; Pretendoj , se keto fakte bazohen , nga Prokurori , në interpretime/vlerësime të reja retroactive/prapavepruese financiare , që nuk ishin të parashikueshme mjaftueshem , prej meje , në vitet 2003 – 2010 ;

**21/22).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 54 ) , se cilit kurs kembimi i eshte referuar , per nxjerrjen e vleres perkatese ekuivalente , ne “ leke “ , per shpenzimet e mia te udhëtitimit personal/familjar , me vlere totale 19.500 euro , ne periudhen kohore te viteve Tetor 2010 - 2023 ;

**21/23).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktet ( shih fq. 54 dhe tabelen e saj ) , per cdo vit ( te periudhes kohore te viteve 2010 – 2023 ) , secilin udhëtim më vete , per te sqaruar konkretisht te dhenat financiare ; Pretendoj , se ( referuar footnote 14 te kesaj faqeje ) , keto shpenzime udhëtimi do rezultonin më të sakta , nese do te ishte marre informacion , edhe ne institucione tjera publike ( vec Kuvendit ) , ku une kam ushtruar detyren gjate viteve 2010 – 2022 ; konkretisht pretendoj , se duhet te ishte marre informacioni perkates financiar , edhe ne Kryeministri , Ministrine e Jashtme ( per periudhen kohore te viteve 2009 e 2010 ) , ne Ministrine e Ekonomise , Tregtise dhe Energjitikes ( per periudhen kohore te viteve 2010 e 2011 ) ;

**21/24).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 57 ) , se cilit kurs kembimi i eshte referuar , per nxjerrjen e vleres perkatese ekuivalente , ne “ leke “ , per shpenzimet totale te udhëtitimit , me vlere 199.750 euro ( ku perfshihet , edhe vlere e udhëtimeve te mia ) ;

**21/25).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 59 ) kur arsyeton , si vijon ( lidhur me shërbime mjeksore “ ...Në vitin 2013 shtetasit Ilir Metaj , ....kanë marrë shërbime mjeksore në klinikën Konfratërnitat , në total në shumën 17,429 Euro, nga të cilat pagesë më kartë krediti është vetëm për shumën 500 Euro , diferenca në shumën 16,929 konsiderohet të jetë kryer "cash" ; Në vitet 2013 , 2014, 2015 , 2017, 2019 dhe 2023 , shtetasit Ilir Metaj... kane marrë shërbime dhe trajtime në klinikën në Lixha Lanserhof , në total shuma 98,677 Euro. Pagesat për këto shërbime rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet sistemit bankar/ karta visa në shumën 50,065 Euro dhe diferenca në shumën 48,612 Euro konsiderohet të jetë kryer “cash” ; Pra , une pretendoj , se konkluzioni vijues “... diferenca në shumën ... konsiderohet të jetë kryer "cash" “ perbejne konkluzione arbitrare dhe te paarsyeshme , perderisa nuk provohet me dokumenta , kjo lloj/menyre pagese “ cash “ dhe ndodh , qe eventualisht kjo vlere , nuk eshte paguar ;

**21/26).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 60 ) , se ciles DPV i referohet konkretisht ( DPV-s time ? apo DPV-s te te pandehures Monika ? ) ; nuk sqarohet mjaftueshem , se ciles vlere totale , ne monedhen “ euro “ , i referohet ekuivalenca me vler 20.003.488 leke , per shpenzimet mjekesore ; nuk sqarohet mjaftueshem , se cilit kurs kembimi i eshte referuar , per nxjerrjen e vleres perkatese ekuivalente 20.003.488 leke, per shpenzimet mjekesore ( dhe nese perfshihet ose jo , tek kjo vlere totale , edhe vlera e shpenzimeve te mia ) ;

**21/27).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 65 ) , se ne cilen bankë , eshte llogaria , ne

emrin tim , me nr. 821162 , në shumën 224,729 Lek ? ciles date i perket gjendja e kesaj vlere monetare ?

**21/28).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 72 ) , kur arsytohet si vijon “ *Per të përcaktuar raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, është e nevojshme dhe analiza e veprimeve me llogaritë bankare gjendje në fund të çdo periudhe ...*” ; Pra , une pretendoj , se per të përcaktuar raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve , është e nevojshme , jo vetem analiza e veprimeve me llogaritë bankare , por edhe analiza e gjendjes te likuiditeteve cash dhe e kursimeve perkatese , per çdo periudhe/viti kalendarik ;

**21/29).** Prokurori dhe ekspertja nuk ka sqaruar mjaftueshem faktin ( shih fq. 218 ) , kur arsyeton “ *Sa më sipër lidhur me shpenzimet e kryera për vajzën / shtetasen Monika Kryemadhi dhe familjen e saj në shumën 84,809,122 Lekë, rezulton se shtetasja Fatime Kryemadhi ka qënë në kushtet e disponimit të ardhurave burimeve financiare për të pajustificuara me dokumentacion ligjor , lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave per shumen 52,327,227 Lekë shumë e cila do të rivlerësohet në analizën financiare , për shtetasit Ilir Metaj dhe Monika Kryemadhi , si mungesë burimesh financiare nga shtetasja Fatime Kryemadhi “ ; Pra , une pretendoj , se deklarimi im ne ILDKPKI , sipas ligjit nr. 9049/2003 eshte deklarim personal , per cdo periudhe kohore , me nenshkrimin tim personal dhe me pergjegjesi personale ; Une nuk kam dijeni , per veprimet financiare apo shpenzimet e kryera , midis te pandehurave Monika Kryemadhi dhe Fatime Kryemadhi , ne cdo periudhe kohore ; Nuk kam asnje lloj pergjegjesie , per deklarimet e te pandehures Monika Kryemadhi , ne ILDKPKI ; Asnje lloj veprimi financiar i kryer midis te pandehurave Monika Kryemadhi dhe Fatime Kryemadhi , nuk*

ndikon tek deklarinimet e mia dhe as tek pjesa e pasurise time ; Per rrjedhoj pretendoj , se konkluzionet e sipercituara te ekspertes ( pra , edhe interpretimi i prokurorit , referuar ekspertes ) , jane konkluzione arbitrare , te paarsyeshme , jo proporcionale dhe jo objektive ;

**21/30).** Te metat dhe paqartesite e sipercituara , kane ndikim/pasoje thelbesore , te mjaftueshme ,direkt /indirekt , ne analizen time financiare **te cdo viti** ( te periudhes kohore te viteve 2003 - 2023 ) , kane ndikim/pasoje thelbesor te mjaftueshme , direkt /indirekt , **ne analizen time te pergjitheshme financiare te kesaj periudhe kohore** ( referuar konkluzioneve , sipas paragrafeve/faqeve tjere te ekspertimit );

**21/31).** Ju sqaroj , se ne cdo rast shpenzimet e mia te udhetimit zyrtar ( ne periudhen kohore te viteve 1992 – 2022 ) , jane mbuluar nga institucionet nderkombetare pritese , ku isha i ftuar, duke perfituar fizikisht , ne vlere te plote dietën perkatese ( dhe kjo vlere monetare diete , eshte deklaruar prej meje , ne organet kompetente te deklarimit te pasurise , sipas viteve , qe kam perfituar );

**21/32).** Ligji nr. 7585 dt.14.7.1992 “ Për tatimin mbi të ardhurat personale “ ( ndryshuar me ligjin nr.7628/1992 ) nuk ndalon shprehimisht dieten te konsiderohet e ardhur ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Ligji nr. 7786 dt. 27.01.1994 “ Për tatimin mbi të ardhurat personale “ ; Neni 14 i ketij ligji parashikon : *Quhen shkelje të ligjit: ... 2. Mosevidentimi i të ardhurave personale ( provohet se une i kam deklaruar keto te ardhura , perfshire edhe dieten ) ;*

Edhe ky ligj , nuk e ndalon deklarinimin ( si e ardhur ) , per dieten ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Ligji nr. 8438/1998 e vijim /ligjin ne fuqi “ Per tatimin mbi te ardhurat personale “ parashikon ;

Neni 4 **Burimi i të ardhurave** / ( ndryshuar me ligjin nr. 9716/2007, ) parashikon :

*Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, **pa u kufizuar vetëm në to**, do të perfshijnë të ardhurat si vijon:*

a) **Të ardhurat nga marrëdhënia e punës** së ushtruar në Republikën e Shqipërisë;

...

i) **të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen.**

Pra , edhe ky ligj , nuk e ndalon deklarinimin ( si e ardhur ) per dieten ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Nuk eshte aplikuar asnje lloj sanksioni administrativ ( nga organet tatimore ) , ndaj meje , ne zbatim te ligjeve ne fuqi , per tatimin mbi te ardhurat , as sipas ligjit organik te zbatueshem , per procedurat tatimore , as ( nga ILDKPKI ) ,sipas ligjit nr. 9049/2003 ;

Ligji ri nr. 29/2023 “ Për tatimin mbi të ardhurat “ , nuk ka fuqi prapavepruese dhe nuk zbatohet , ndaj meje , sepse ne vitin 2022 ka mbaruar mandati im si president ;

Ligji nr.7903 , datë 8.3.1995 “ Për deklarinimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik ‘ ( ligji ne fuqi , deri ne vitin 2003 ,sepse hyri ne fuqi ligji ri nr. 9049/2003 ) ;

Neni 1 parashikon : ..., deputetët e Kuvendit Popullor, ..., kur këta persona kanë ose kanë pasur funksione të tilla që nga 1 janari 1991, brenda tre muajve nga shpallja e këtij ligji, duhet të deklarojnë për vete dhe familjen e tyre: 1. Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, si dhe burimin e tyre. 2. Aksionet dhe letrat me vlerë në zotërim të tyre. 3. Shumat në të holla ose sende me vlerë mbi 1 milionë lekë dhe pasuri të luajtshme të regjistruara në administratën shtetërore, si dhe burimin e tyre. 4. Funksionet që kanë ose kanë pasur në shoqëritë tregtare dhe pjesa e kapitalit të tyre në to. 5. **Dëshmi zyrtare të të ardhurave që i janë nënshtruar tatimit mbi të ardhurat personale të vitit të fundit, që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji.**

Neni 8 parashikon : Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji nga persona të tjerë me përjashtim të atyre të përmendur në nenin 7, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen: ....; Kur shkelja përbën vepër penale, bëhet kallëzim në organet e prokurorisë.

Edhe ky ligj , nuk e ndalon deklarinimin ( si e ardhur ) , per dieten ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ( sipas ketij ligji , nuk jam sanksionuar , asnjehere ne rruge administrative ) ;

Ligji ne fuqi nr. 9049/2003 “ Per deklarinimin e pasurive “ :

Neni 4 (shfuqizuar fjalë me ligjin nr. 9367/2005 ; zëvendësuar fjalë , shtuar shkronja dhe paragraf me ligjin nr. 85/2012 ; ndryshuar me ligjin nr. 45/2014 ) parashikon : ..*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI , brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:*

....  
**e) të ardhurat personale për vitin , nga paga** ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale...;....

Neni 40 ( shfuqizime me ligjin nr. 9367/2005; shtuar me ligjin nr. 85/2012 ) parashikon : 1. *Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas kufijve të përcaktuar më poshtë:....; 2. Të drejtën për vendosjen e masave administrative për rastet e shkeljeve të mësipërme e ka Inspektori i Përgjithshëm.*

Edhe ky ligj , nuk e ndalon deklarinimin ( si e ardhur ) per dieten ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ; edhe sipas ketij ligji , nuk jam sanksionuar ne rruge administrative ) ;

Kodi Punes / Neni saj 4 ( shtuar paragraf me ligjin nr.9125/2003 ) parashikon :*Përrjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi: punësimi i personave që rregullohet me ligj të veçantë. Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës ;*

Neni 117 Zbritjet nga paga ( ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 8085/1996) :

1. Punëdhënësi zbrit nga paga e punëmarrësit **tatimin mbi të ardhurat** dhe kontributin e sigurimeve shoqërore shëndetësore të parashikuara me ligj, me akte nënligjore, me kontrata kolektive ose me kontrata individuale...

Ligji nr. 7503, datë 27.7.1991 “ Për statusin e deputetit të Kuvendit Popullor ”, nuk e ndalon deklarinimin ( si e ardhur ) , per dieten ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Ligji nr. 8550/1999 “ Statusi i deputetit “ parashikon :

Neni 13 ( ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 153/2013) parashikon :

1. Në klasifikim **paga** e deputetit vjen menjëherë pas pagës së ministrit, paga e Kryetarit të Kuvendit menjëherë pas pagës së Presidentit të Republikës dhe ajo e zëvendëskryetarëve barazohet me zëvendëskryeministrin.

2. **Paga e deputetit përbëhet nga paga** për pjesëmarrjen e tij në seancë, në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare. Gjithashtu, ai gëzon të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrje në komisione, si drejtues i Komisionit apo si drejtues i grupit parlamentar.

....

4. **Raportet e pagës, masës së dietës**, të shpërblimit, si dhe norma për transportin që përfiton deputeti, kryetari i komisionit, nënkomisionit dhe kryetari i grupit parlamentar përcaktohen me vendim të Kuvendit.

....

Neni 14 ( ndryshuar me ligjin nr. 8988/2002; shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 10160/2009 ) parashikon :

1. .... Modalitetet e përfitimit të dietave rregullohen me vendim të Kuvendit.

2. **Dieta** e Kryetarit, zëvendëskryetarëve dhe deputetëve do të jetë në masën 4 për qind të pagës mujore të tyre.

3. Deputeti që shkon me shërbim jashtë shtetit nga Kuvendi përfiton **dietë ditore**, sipas akteve të miratuara nga Kuvendi. Në rastet kur ai caktohet të marrë pjesë në delegacionet qeveritare ose të institucioneve të tjera , **shpenzimet mbulojnë nga institucioni që e ka ftuar**, duke përfituar **dietën** sipas akteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Pra , keto ligje “ Per statusin e deputetit “ e njihnin dieten , si te ardhur dhe une kam bere deklarimet perkatese ; dieta nuk llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Sipas ligjit nr.10296/2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin “ , nenet 4/2 , 9 , 13 , 14 parashikojne :

" Përgjegjshmëria menaxheriale " **është detyrimi i menaxherëve të njësive** , që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar , të ligjshmërisë e të transparencës në administrim , si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare , bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera "Mashtim", ky term ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në Kodin Penal

**" Parregullsi " është moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo i rregulloreve të tjera** , që e ka origjinën te veprimet a mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për fondet publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat , shpenzimet/të dalat, fondet e kthyer mbapsht, aktivet apo detyrimet financiare.

Pra , referuar ketij ligji , ligjeve organike per deklarimin e pasurise , ligjeve te zbatueshme dhe relevante tatimore , financiare , kontabile , une kam vlesuar , se saktësia dhe plotësia e deklarimit tim , ne ILDKPKI , për dieten dhe te ardhurat e tjera nga paga matet , vetëm përmes deklarimeve të sakta ; Asnje institucion publik qendror nuk ka konstatuar parregullsi , apo moszbatimin e ligjit prej meje ose zbatimin e gabuar te ligjeve/akteve nenligjore , prej meje per llogaritjen dhe deklarimin prej meje te te ardhurave ( paga , dieta etj. ) , shpenzimeve te cdo lloji dhe investimeve te mia , ne vitet 1992-2023 ; Asnje organ publik qendror financiar , nuk ka orientuar ( ne vitet 1992 - 2023 ) , që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme , në të ardhmen , të mos konsiderojë , si të ardhura të subjekteve deklarues , vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale ku ata kanë qenë pjesëmarrës ...;

**21/33).** Përveç ligjit nr.8438/1998 duhet te kihet parasysh situata faktike , që përcakton përftimin e tyre/dietave ; Në këtë kontekst pretendoj , se ishte e rëndësishme , që të specifikohet natyra e aktivitetit për të cilin dieta akordohet, vendi i zhvillimit ,

programi i vizitës nëse do kemi një të tillë , që do të thotë minimalisht une ( kur kam perfituar dieten perkatese ) eshte dokumentuar , natyra e këtyre dietave , në mënyrë që të kryhej një kualifikim dhe kategorizim i saktë , për trajtimin e tyre ;

Prokuroria nuk ka marre/patur informacion , në këtë drejtim, prandaj konsiderimi i tyre/dietes *a priori* , edhe si e ardhur , edhe si shpenzime , ka renduar padrejtesisht poziten time , pa nje proces te rregullt ligjor , ne menyre jo objektive , jo proporcionale dhe ne kundërshtim me parimin e ligjshmerise ( pjese te ciles , eshte siguria juridike e lidhur me parashikueshmerine ) ;

Parimi i ligjshmerise parashikon , se *organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën ( neni 4 e vijues ) , me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ , përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor ;* Prokurori , nuk i referohet asnjë ligji te zbatueshem , qe nuk llogariten / nuk perfshihen , ne analizen time financiare , te ardhurat e mia dhe/ose kursimet e mia , per periudhen kohore te viteve 1992 – 2002 ; Referuar ketij parimi pretendoj , se Prokurori dhe ekspertja , nuk i referohet asnjë ligji te zbatueshem ( per periudhen kohore te viteve 2003 - 2023 , objekt ekspertimi ) , per te konsideruar/vleresuar dieten , edhe si e ardhur ( nga paga ime , per shkak te detyres publike ) , edhe si shpenzim ; Prokurori dhe ekspertja nuk kane paraqitur asnjë fakt e rrethane objektive, sipas te cilave krahasuar , me konkluzionet pozitive te ILDKPKI ( qe e kane konsideruar dieten

, si “ te ardhur “ , per periudhen kohore te viteve 2003 - 2023 dhe e kane perfshire ne analizen time financiare ) e justifikojne nje qendrim/ një përfundim të ndryshëm ( duke e konsideruar dieten , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ) . Konkluzione/perfundime/interpretime te tilla , nga prokurori ( pa iu referuar asnje dispozite ligjore dhe dukshëm janë kontradiktore , arbitrare dhe te paarsyeshme ) , nuk janë ligjshme , për qëllimet e vlersimit tim financiar , per efekt te kesaj ceshtje penale.

Pretendoj , se per asnje shkak , fakt e rrethane objektive , une nuk mund të kisha parashikuar ( ne periudhen kohore te viteve 2003-2023 ) , këto interpretime te ekspertes dhe Prokurorit . Mungesa e qëndrueshmërisë , në veprimet e Prokurorit , gjatë viteve 2024 e 2025 , eshte ne kundërshtim parimin e “ qeverisjes së mirë ” , i cili kërkon , që “ *autoritetet publike të vepronin në kohën e duhur , në mënyrë të përshtatshme dhe me qëndrueshmërinë më të lartë* “ . Ne përfundim pretendoj , se ne periudhen kohore te viteve 2003 – 2023 , legjislacioni fiinaciar përkatës dhe zbatimi i tij , nuk kishte qenë i parashikueshëm , prej meje , lidhur me interpretimin e prokurorit , ne vitet 2024 e 2025 ; Prandaj , kerkoj qe gjykata te mos i marre parasysht keto intepretime te prokurorit , lidhur konsiderimin , prej tij , te dietës , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ( shih qasjen sipas vendimit te GJEDNJ , per çështjen Komuniteti Hebre i Selanikut kundër Greqisë , aplikimi nr. 13959/20 , vendimi dt. 06 / 5 / 2025 ) ;

**21/34).** Pretendoj , se mungon një logjikë ekonomike e besueshme , e arsyeshme dhe objektive ( referuar akteve ligjore e nenligjore ne fuqi ) , që deklarimi i dietes prej meje , ne ILDKPKI , ne menyre konsistente , të interpretohet , si shmangie e qëllimshme e ligjit , dhe/ose te interpretohet , si një mekanizëm

, për rritjen artificiale të të ardhurave të mia dhe/ose si një përpjekje për të paraqitur ndryshe situatën time faktike financiare /bazen time provuese financiare .Perkundrazi pretendoj , se deklarimi i dietes , perben element transparence , perben deklarime me vërtetësi , per faktet / rrethanat situatën faktike dhe situatën juridike , në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet konkrete ; Nuk ekziston asnjë rrethanë objektive , që të çojë eventualisht në një përfundim të kundërt ;

Ky element transparence bie ndesh me hipotezën e keqbesimit , dashjes apo qellimit kriminal ; Pasaktësitë/paqartësitë eventuale , në deklaratat periodike të periudhës kohore të viteve , nëse dieta është ose jo e ardhur e ligjshme , nuk lidhen me vullnetin tim , por me mosveprimet/pergjegjësitë e organeve shtetërore/publike qendrore dhe nuk mund të shoqërohen kurrsesi me masa penale ,sepse ligjet tatimore relevante për tatimin mbi të ardhurat dhe ligjet për deklarimin e pasurisë caktojnë në eventualitet sanksione disiplinore ; në të kundërt ( pra, duke i vlersuar veprimet apo mosveprimet , si vepra penale , siç pretendon prokurori ) perben vlersim joproporcional , i paarsyeshëm dhe arbitrar ) , cenon parimin e ligjshmerisë , objektivitetin , diskrecionin , parimin e qeverisjes së mirë .

Une nuk isha dhe jam në kushtet e keqbesimit ( pra , nuk kisha dijeni , se dieta nuk konsiderohet e ardhur , në periudhën kohore të viteve 1992 - 2022 ) ; Asnjë organ publik nuk më njoftoi se dieta nuk quhet e ardhur ; Asnjë ligj nuk e perkufizon , se dieta nuk është e ardhur apo se dieta llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ; Cdo lloj interpretimi/konkluzioni i ri , nuk ishte mjaftueshëm i parashikueshëm , prej meje , nuk ka fuqi prapavepruese ) ; Me këtë fakt të deklaruar , prej meje ( dieta , si e ardhur me burime financiare të ligjshme ) , janë pajtuar edhe

organet shtetërore/publike financiare ( ILDKPKI , Tatime dhe Kontroll i Lartë i Shtetit ) .

**21/35).** Parimisht diskrecioni ushtrohet ligjërisht , kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme: a) është i parashikuar me ligj ; b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit; c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ; .... ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

Parimi i proporcionalitetit parashikon : Çdo veprim i organit publik , i cili ( për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve ) , mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Veprimi publik është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

a) i nevojshëm për të arritur **qëllimin e përcaktuar me ligj** dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës ;

b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe

c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë ;

Parimi i drejtësisë dhe i paaanësisë ( e lidhur me nenin 1 të K. Pr. Penale ) parashikon : **Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi**

**publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.**

Parimi i objektivitetit parashikon : *Gjatë ushtrimit të veprimtarisë publike të çdo lloji , organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën përkatëse .*

**21/36). Referuar këtyre parimeve publike pretendoj , se ekzistenca e një shumëllojshmërie qasjesh nga ILDKPKI apo organet tatimore , apo nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo nga prokurori krijon pasiguri juridike të papajtueshme me të drejtën themelore , për të mos u trajtuar me dy standrate ( lidhur me parashikueshmerine ) , cenon parimin e diskrecionit , parimin e ligjshmerise dhe cenon parimin e objektivitetit ; Cenimi i sigurise juridike ( me dashje dhe ne menyre te qendrushme ) , behet per qellime te paligjshme dhe diskriminuese ( shkaqe politike ) ;**

Prandaj , në zbatim të parimeve të objektivitetit , të proporcionalitetit dhe mungesës së masave administrative , ndaj meje ( lidhur me menaxhimin e të ardhurave/dietave apo deklarimin e të ardhurave /dietave ) nga organet tatimore apo ILDKPKI , apo Kontrolli i Lartë i Shtetit , nuk mund të pretendohet , se kam vepruar me keqbesim/dashje ;

Pra , pretendoj , se nuk ka patur indicje ( me asnjë ligj apo nga vendimet e ILDKPKI apo nga organet Tatimore , apo nga organe tjera ndër vite ) , që dieta , nuk konsiderohet e ardhur , apo dieta llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim ;

Edhe kur Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka kontrolluar Kuvendin , Kryeministrinë , apo Ministrinë dhe nuk kanë vlerësuar , se diçka nuk është e ardhur apo se diçka llogaritet , edhe si e ardhur , edhe si shpenzim;

**21/37).** Pra , vetëm Prokurori dhe ekspertja ka qendrim/vlerësim tjetër , **per dieten** ; Prokurori nuk ka ekskluzivitetin e interpretimit të ligjit ; Interpretimi perfundimtar është interpretimi i Gjykatës Kushtetuese ; Por ky qendrim i Prokurorit , nuk ka efekt prapaveprues ( sepse ndryshe cenon parimin e sigurisë juridike ) , cenon parimin e qeverisjes së mirë , cenon parimin e proporcionalitetit , cenon nën 18 Kushtetutes ( lidhur me barazinë ) , cenon parimin e diskrecionit dhe nuk tregon kurrësi dashje/ qellim , diçka ( me vullnet e ndërgjegje ) direkt apo indirekt , prej meje , për kryerje të ndonjë kundërvajtje administrative dhe/ose veprave penale ;

Për më tepër , dietat janë deklaruar prej meje , prej vitit 1992 e vijim , pa u bërë Ministër e Kryeministër ; Pretendoj , se ka qendrim konstant , për vlerësimin financiar , nga ILDKPKI dhe ( duke mos u keshilluar , nga ILDKPKI ) , unë nuk mund të mbaja qendrim tjetër , në asnjë periudhë tjetër eventuale deklaruese ; Pretendoj , se këto fakte bazohen , nga Prokurori , në interpretime/vlerësime të reja retroaktive financiare , që nuk ishin të parashikueshme mjaftueshëm , prej meje në vitet 1992 – 2022 ; .....Se ndërmjet dy ose më shumë parimeve të rëndësishme ( **si ai i sigurisë juridike dhe procesi i rregullt ligjor** ) , **ky i fundit do të prevalojë** ( shih qasjen , sipas vendimit njësoj penal nr. 2/2022 , pg. 67 ) .

**21/38).** Parimisht pretendoj , se *Eksperti nuk është organ i ndjekjes penale që të nxjerrë përfundime lidhur me mekanizmin e*

ngjarjes, por e ndihmon këtë të fundit me përfundimet e tij shkencore të cilat, të marra e të analizuara në tërësi me provat e tjera, e çojnë prokurorin , në përfundimet përkatëse për rastin objekt shqyrtimi. Akti i ekspertimit është një provë shkencore që e merr vlerën dhe fuqinë provuese vetëm pasi gjykatat e çmojnë atë. ( shih vendimin penal nr.00-2024-1151(148), datë 27.06.2024 te Kolegji Penal i Gjykeses se Larte ; shih vendimin penal nr. 203 , datë 09.12.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ; shih edhe vendimin penal nr. 00 - 2024 - 158 ( 11 ) dt. 18.01.2024 te Kolegji Penal i Gjykeses se Larte ) ; se mendimet e ekspertit përbëjnë vetëm një këshillë për gjykatat, të cilat nuk janë aspak të detyruara që t'i pranojnë a priori , përveçse kur i bindin. Nëse ato nuk pranojnë mendimin e ekspertit , duhet të paraqesin argumente bindëse, por kjo nuk do të thotë , se gjykatat duhet të pajtohen gjithmonë me konkluzionet e ekspertëve ( shih vendimin nr. 45/2012 i Gjykatës Kushtetuese ) ; se e drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet nga neni 6/1 KEDNJ kërkon , që palët ndërgjyqëse të kenë një mjet gjyqësor efektiv që mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre ( shih vendimi i GJEDNJ per ceshtjet : Beles etj. kundër Republikës Çeke prg. 49 ; Nait Liman kundër Zvicrës , pg. 112 ) ; *kerkesa per thirrjen e ekspertit ( per te sqaruar/shpjeguar te metat dhe paqartesite) eshte e rëndësishme , thelbesore , e rendesishme për objektin e akuzës dhe per pafajsine time , sepse dëmton , në mënyrë të përgjithshme procesin e rregullt ligjor ( shih qasjen sipas vendimit te GJEDNJ , per ceshtjen Abdullayev k. Azerbajxhanit, datë 07.03.2019, §§ 59; 60) ; **Mënyra se si eksperti i ka ushtruar detyrat dhe mënyra** , se si gjyqtari e ka vlerësuar opinionin e tij , janë faktorë me rëndësi , që duhen marrë parasysh , në vlerësimin , nëse është respektuar parimi i barazisë së armëve ( shih vendimin e GJEDNJ , per ceshtjen Devinar k. Sllovenisë , vendimi dt. 22 maj 2018 , § 47 ; shih vendimin perfundimtar nr. 38/2021 të Gjykatës*

Kushtetuese , pg. 62 ) ;GJEDNJ vlerson , nese ekspertimi/konkluzionet e ekspertimit , kanë qenë vendimtare , për pjesën perkatese te vendimmarrjes së Gjykatës apo vendimi gjyqesor eshte mbeshtetur / bazuar , në vlerësim në tërësi të provave tjera ( shih vendimin nr. 238/2023 te Gjykates Kushtetuese / Kolegji / Moskalim , pg. 26 ) .

**21/39).** Referuar parashtrimeve te sipercituara dhe ligjeve te zbatueshme relevante te sipercituara pretendoj , se ekspertimi financiar ( kryer ne hetimet paraprake ) është me të meta thelbesore , i paqartë ; **Ketij ekspertimi i mungojne argumentat bindese , i mungojne referencat ligjore per metodologjine financiare te zbatueshme ; ekspertet i ka munguar i dokumentacioni i plote , per te nxjerre konkluzione te plota , shteruese , ezauruese dhe objektive ;** Perfundimet e nxjerra nga kjo eksperte , nuk i sherbejne gjykates , qe ajo ti shqyrtojë , në kontekstin e të gjitha rrethanave të tjera të çështjes , duke analizuar dhe veprimet e mia dhe deklarimet e mia , ne ILDKPKI ; Ne kete gjendje , qe paraqitet ky ekspertim pretendoj , se shtohen **paqartësite dhe pasiguria objektive e fakteve/rrethanave objekt ekspertimi , nga sqarimi objektiv e shkencor i të cilave , varet vendimi i gjykatës ;** Ne kete gjendje qe paraqitet ky ekspertim pretendoj , se nuk e mbështet gjykatën me njohuritë ngushtësisht ekonomiko - shkencore , qe paraqiten ne ceshtjen objekt gjykimi , gjykata nuk mund te perfeksionojë njohuritë e saj , në fushen e specializuar financiare , kontabile , tatimore dhe ekonomike ( në mënyrë , që të vlerësojë dhe të rindërtojë faktet historike të çështjes , si dhe të ketë një kontroll të plotë mbi elementët e faktit dhe të provave të paraqitura nga palët , në proces apo te marra , prej saj ) ;

Në çdo rast bëhet fjalë , për njohuri , që dalin përtej kulturës së përgjithshme të çdo gjyqtari ( jo vetëm të atij , që e gjykon çështjen me juridiksion fillestar , por edhe të gjyqtarit kontrollues dhe rishikues ) .

Kjo do të thotë parimisht , se edhe nëse gjykata ndodh të ketë njohuri të veçanta shtesë , në një fushë të specializuar të teknikës , nuk mund të shmangë në mënyrë apriori ekspertimin , pasi gjykata kontrolluese nuk mund të vlerësojë dot drejtësinë e konkluzioneve të gjykatës më të ulët , nëse nuk i zotëron dot këto njohuri.

Prandaj për zbatimin efektiv të parimeve të kontradiktoritetit , mbrojtjes time efektive/efikase , te drejtes time , për tu degjuar realisht , hetimit/sqarimit të plote dhe të gjithanshem të fakteve/rrethanave ceshtjes :

( i ). Kërkoj sqarime/shpjegime plotësuese , nga ekspertja ( që ka kryer këte ekspertim financiar ) dhe një vlerësim faktik të kesaj prove indirekte ; Gjykata të vlerësoje elementët procedural faktik të nevojës dhe dobisë **të thirrjes të kesaj eksperteje** ( shih nenet 179 e vijues , 363 të K.Pr.Penale ) , **për te sqaruar/shpjeguar te metat dhe paqartësite** , në drejtimet e sipercituara , prej meje dhe t'ju pergjigjet pyetjeve të tjera eventuale ( për çfarë do të rezultoj , nga sqarimet/shpjegimet e saj eventuale ) ; Duke dhene sqarime/shpjegime ( për keto te meta e paqartësi dhe pasi tju pergjigjet , edhe pyetjeve tjera ) , kerkoj që ekspertja të kryej plotësimin e ekspertimit të saj , duke integruar sqarimet /shpjegimet , referencat ligjore dhe konkluzionet e reja eventuale ;

(ii). **ose** ( duke vlerësuar elementët procedural te nevojës dhe dobisë per ceshtjen ) kerkoj , qe gjykata **të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri** financiar , duke thirrur ekspertë të tjerë ose grup ekspertesh , sepse kërkimet dhe vlerësimet financiare , ekonomike , kontabile , ne kete procedim , jane shumë komplekse ( shih nenet 179/1,3 e 366 te K.Pr.Penale ) ;

( iii). Kerkoj te kryhet ekspertim , **lidhur me analizen financiare te te ardhurave , shpenzimeve dhe investimeve te mia , per periudhen kohore perkatese te viteve 1992 ( kur u zgjodha deputet ) – dt. 31 / 12 / 2002** , ne drejtim të sqarimit te faktit , nese kisha mundesi financiare , ne periudhen kohore te viteve 1992 e vijim , per te patur/krijuar kursime monetare , deri më dt. 31 / 12 / 2002 ; nese po , pretendoj , se ky kursim monetar duhet te integrohet , edhe ne analizen time financiare te vitit 2003 ( viti kur fillon kryerja e analizes financiare , prej Prokurorit dhe ekspertes ) ;

(iv). Nese Gjykata nuk e pranon kerkesen time thelbesore dhe te rendesishme “ per thirrjen e ekspertes “ ose per kryerje ekspertimi te ri ( referuar kerkesave te mia , per te sqaruar/shpjeguar te metat e paqartesite dhe per hetimin e plote te rrethanave ceshtjes ) pretendoj , se rëndohet padrejtësisht pozita ime procedurale , në cenim flagrant dhe haptazi te parimit të kontradiktoritetit dhe te se drejtes time , per tu dëgjuar sic duhet dhe realisht ( si nje nga elementet e procesit te rregullt ligjor ) ;

**22).** Pavec kerkeses time , qe paraqita verbalisht dhe me shkrim ( per llogari te seances te kaluar dt. 24 / 6 / 2026 ) , kerkoj qe Gjykata **të kërkojë informacion/të dhëna tjera** , nga

Inspektoriat i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit përsa vijon:

( i ). Nese per deklaruesin ILIR Rexhep METAJ , a keni konstatuar ndonjëherë mosdeklarim apo fshehje të ardhurash ? nëse po , a e keni paralajmëruar/këshilluar / njoftuar/pyetur/hetuar/gjobitur , kete deklarues ?

( ii). A keni zhvilluar ndonjë hetim administrativ , për deklaruesin ILIR Rexhep METAJ , për burimin e pasurisë/ve dhe të të ardhurave të tij ? Nëse po , çfarë rezultatesh keni nxjerrë ? a e keni gjobitur , per shkelje eventuale ?

**23). Pretendime lidhur me akuzen , sipas nenit 287/2 te Kodit Penal “ Pastrimi produkteve “ :**

Pretendoj , se parimisht dhe në referim të nenit 287 të Kodit Penal , kur bëhet fjalë për pastrim të produkteve të veprës penale nënkuptohet pasuri që dihet se është, apo është produkt i veprës penale ( siç parashikon vetë dispozita në mënyrë të shprehur ). Për të pasur veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal , duhet që une të kem dijeni ( me ndergjegjen dhe vullnetin tim ) , që prona perkatese e përfituar është produkt i një vepre penale ; Midis produktit të veprës penale ( *vepra penale mëmë* ) dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti ( *vepra penale bijë* ) duhet të ekzistojë gjithmonë një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme . Pra, nëse nuk kemi të konsumuar , nga ana objektive një vepër penale “ mëmë “ , nuk mund të behet fjale për pastrim të produktit të saj, pasi produkti sipas nenit 287 të Kodit Penal , duhet të rrjedhë si rezultat i një fakti i cili parashikohet nga ligji si vepër penale.

Prandaj, në çdo rast duhet që midis veprimeve të autorit të veprës penale që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës, pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore. Duke qenë se vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal është vepër penale aksesore , është e detyrueshme , që provohet jo vetëm ekzistenca e një vepre kryesore apo “ mëmë ” , por edhe dashja direkte në kryerjen e kësaj vepre penale, në kuptimin që , autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës, pastrimin e produktit të veprës penale , pra , ai/autori ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik i ardhur nga vepra penale “ mëmë “ , përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal . Kjo vepër penale , si kusht të ekzistencës së saj kërkon vërtetimin e kryerjes së një vepre penale kryesore , që ka shërbyer si burim i krijimit të pasurisë , që përfaqëson produktin e veprës penale apo të veprimtarisë kriminale.

Nga ana subjektive , kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës, pastrimin e produktit të veprës penale , pra ai ka dijeni , se pasuria apo avantazhi ekonomik i ardhur nga vepra penale mëmë , përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara , në nenin 287 të Kodit Penal .

Sipas përkufizimeve të dhëna respektivisht m në nenin 1/e të Konventes së Këshillit të Evropës “Për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, të miratuar në Strasburg më datë 08.11.1990, e të ratifikuar nga Kuvendi , me

ligjin nr. 8646/2000, si dhe po në nenin 1/e të Konventës së Këshillit të Evropës “ Për pastrimin , kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” ( të ratifikuar nga Kuvendi , me ligjin nr. 9646/2006 ) , në mënyrë të shprehur përcaktohet , se “ ...vepër penale kryesore ” do konsiderohet çdo vepër penale në vijim të së cilës janë krijuar produkte dhe që mund të bëhen objekt i një veprë penale, sipas nenit 6 të Konventës së parë apo nenit 9 të Konventës së dytë “ ; Referuar dispozitave të dy Konventave , vepra penale kryesore ( prej së cilës burojnë produktet apo pasuritë kriminale ) është e mëvetësishme/e pavarur , nga vepra penale e pastrimit të këtyre produkteve kriminale dhe subjekti i kryerjes së veprës penale kryesore mund të jetë njëherazi edhe subjekti i kryerjes së veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale , por ky i fundit , jo detyrimisht duhet të jetë autori i veprës penale kryesore.

Ajo , që duhet evidentuar është fakti se, midis produktit të veprës penale (vepra penale “ mëmë ” ) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale “ bijë ” ) , duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme .

Pra , nëse nuk kemi të konsumuar nga ana objektive një vepër penale “ mëmë ” , nuk mund të flitet , për pastrim të produktit të saj, pasi produkti , sipas nenit 287 të Kodit Penal , duhet të rrjedhë , si rezultat i një fakti, i cili parashikohet nga ligji si vepër penale.

Prandaj , në çdo rast duhet , që midis veprimeve të autorit të veprës penale ( që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës , pastrimi i

produktit të veprës penale ), duhet të ekzistojë lidhje shkakësore ( element i anes objektive ) .

Ne perputhje me keto parime pretendoj , se cdo veprim eshte paqyruar , dokumentuar , deklaruar e kryer , ne organet publike apo tek persona qe ushtrojne veprime publike ( noteri ) dhe eshte pasqyruar ne llogarite bankare ;

Nese eventualisht ka gabime apo parregullsi , nuk provohet se une kam bashkepunuar me institucionet publike apo bankare apo me noterët , per shkeljen e ligjeve apo akteve nenligjore ; nuk provohet se une kam ndikuar ne cdo forme /menyre , per shkeljen e ligjeve apo aktet nenligjore , lidhur me perfitimin e cdo lloj prone/pasurie ;

Une nuk kam dijeni , per ndonje fakt , rrethane se cdo prone/pasuri e cdo lloji , te jete perfituar , prej meje , ne kundershtrim me ligjet e zbatueshme ;

Une nuk kam dijeni , se cdo prone/pasuri e imja e cdo lloji është eventualisht produkt i një veprimtarie të paligjshme te cdo lloj forme . Vetem fakti , se kam ushtruar detyra te larta publike , nuk eshte shkak inkriminimi dhe nuk është i mjaftueshëm , për të konkluduar , se në rastin konkret është konsumuar vepra penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal . Kjo vepër penale ( për tu provuar ) kërkon domosdoshmërisht vërtetimin e veprës penale “ mëmë ” , që ka shërbyer , si burim i të ardhurave të paligjshme , produkt i saj, vepër që në çështjen objekt gjykimi , nuk provohet; Nuk vërtetohet kryerja e ndonjë vepre penale , prej meje , që të ketë shërbyer eventualisht , si burim i pasurisë eventuale të paligjshme. Para fillimit te ketij procedimi penal dhe deri ne kete faze , une figuroj i pa denuar.

Në këto kushte pretendoj, se nuk plotësohen elementet objektive dhe subjektive të veprës penale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Për sa më sipër (në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar se nuk vërtetohet kryerja e ndonjë vepre penale, prej meje, që të ketë shërbyer, si burim i pasurisë eventuale të paligjshme) pretendoj, se nuk plotësohen elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 287/2 i Kodit Penal.

**Secila provë apo mjet kërkimi prove (që unë kërktoj të merren dhe të administrohen, nga Gjykata) provojnë (në vlerësimin e tyre të arsyeshëm dhe në tërësi) pafajësinë time, për çdo akuzë, objekt hetimi dhe gjykimi.**

Bashkëlidhur, keni nje kopje të këtij akti (për t'ja njoftuar Prokurorit).

**Për kërkuesin/Të pandehurin Z. ILIR REXHEP METAJ**

**Av. Bujar MUSTA**